

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6795
31 dhjetor 2022 dhe
1, 2 e 3 janar 2023



**Kosova hyn në vitin e
tretë të padrejtësisë
ndaj strategëve të lirisë**

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

NGA VITI I RËNIES DREJT NGRIRJES SË ÇËSHTJES SË KOSOVËS

Në numrin festiv të gazetës "Epoka e re" mund të lexoni shkrime nga politika, ekonomia, siguria, shëndetësia, kultura dhe sporti. Mund të informohuni më shumë për ngjarjet më të rëndësishme që kanë ndodhur gjatë vitit 2022 në Kosovë dhe në botë. Ishte një vit i liderëve të UÇK-së përballë Gjykatës Speciale. Gjithashtu, mund të lexoni për dështimin e politikës së jashtme, e cila nuk ka siguruar asnjë njohje të re në 2022-n, pastaj për punën njëvjeçare të Kuvendit të Kosovës... etj.



**Libri i vetëm i
intelektualëve
që thotë diçka
për UÇK-në**

Vështrim për librin "USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS, vlerë kombëtare", i lexuar në promovimin e tij më 16 dhjetor 2022 në Prishtinë.



Muhamet MAVRAJ

**"EPOKA E RE" TË GJITHË QYTETARËVE
UA URON VITIN E RI 2023!**

KNAUF INSULATION
Mob: 049/335-221
049/335-224
049/334-224
Është koha ta kërcejmë energjinë!
www.knaufinsulation.com/al

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhep isht
Tetov*
Tel: +389 44 487 300; +389 44
+389 44 487 73
Fax: +389 44 487
Mob: +377 44 501 2
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERNATIONAL VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DIBA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666



Ngjarjet që e karakterizuan Kosovën më 2022

EPOKA E RE

Përgatiti: **Lirim GECI**

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Tensionet në veri, dialogu me Serbinë dhe Gjykata Speciale kanë qenë ngjarjet kryesore që e kanë karakterizuar Kosovën në vitin 2022. Po ashtu, greva pesëjavëshe në arsim ka qenë një nga ngjarjet kryesore që e ka karakterizuar Kosovën në vitin që po e lëmë pas.

Shtrenjtohet rryma 100 për qind

8 SHKURT - Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE) ka aprovuar tarifat e energjisë elektrike për vitin 2022. Sipas vendimit, bllok-tarifa do të zbatohet për konsumatorët që harxhojnë mbi 800 kWh. Për këta konsumatorë rritja e çmimit të rrymës do të jetë rreth 100 për qind. Fillimisht ZRrE-ja kishte propozuar që bllok-tarifa të aplikohet nga 600 kilovatë në orë por, pas shqyrtimit të komenteve të shumë institucioneve, ZRrE-ja ka ndryshuar propozimin e saj. Vendimi i fundit i ZRrE-së për shtrenjtimin e energjisë është marrë në vijë me propozimin e Lëvizjes Vetëvendosje dhe Ministrisë së Ekonomisë që kishin dorëzuar në këtë institucion. Në

ZRrE komente kanë dorëzuar edhe shumë institucione shtetërore dhe organizata të ndryshme nga shoqëria civile, por komentet e tyre nuk janë marrë parasysh nga ZRrE-ja. Tarifat e reja do të hyjnë në fuqi më 9 shkurt 2022 dhe do të aplikohen deri më 31 mars 2023.

Dështon të miratohet Projektkodi Civil

16 MARS - Deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk ia kanë dhënë dritën e gjelbër Projektkodit Civil në seancën e së mërkurës. Në momentin e votimit në sallë ishin të pranishëm 77 deputetë, prej të cilëve 16 nuk e kanë shfrytëzuar të drejtën e votës. Nga 61 deputetë sa kanë votuar, 29 ishin kundër, 28 për dhe 4 abstenime. Projektkodi Civil është kundërshtuar nga një pjesë e madhe e deputetëve për shkak të nenit i cili mendohet se çon drejt martesave të së njëjtës gjini. Kushtetuta e Republikës së Kosovës parashikon se “në bazë të pëlqimit të lirë, çdokush gëzon të drejtën të martohet dhe të drejtën që të krijojë familje në pajtim me ligjin”. Por një gjë të tillë nuk e lejon Kodi Civil aktual, pasi aty specifikohet se “martesa është bashkësi e regjistruar ligjërisht

ndërmjet dy bashkëshortëve të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku si burrë e grua”.

Rama viziton Thaçin në Hagë: Çmallje e nevojshme, ai është në top formë

10 MAJ - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka vizituar të martën në Hagë ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi. Pas vizitës, Rama ka thënë se Thaçi është në formë të mirë. Rama ka thënë se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) nuk mund të futet në korniza të reja dhe se për pastërtinë e saj janë të bindur të gjithë. Ai ka theksuar se gjykimi në Hagë për Thaçin dhe ish-krejtë e tjerë të UÇK-së ishte “rrugë e pashmangshme”. “Çmallje e nevojshme. Presidenti Thaçi gjendet në top formë, i bindur mbase edhe më shumë sesa kur e kam takuar para se të vinte këtu, që ishte një rrugë e pashmangshme për të provuar katërçipërisht para drejtësisë pastërtinë e plotë të luftës çlirimtare dhe natyrisht edhe pastërtinë e idealit të luftëtarëve të UÇK-së. Nuk ka shumë për të thënë. Të gjithë jemi të bindur se

lufta çlirimtare e Kosovës nuk mund të rishkruhet dhe as nuk mund kursesi të futet në korniza të tjera, sepse ajo është tanimë e futur në kornizën e artë të heroizmit, sakrificave, gjakut të dhënë dhe, natyrisht, të gjitha përpjekjeve që kanë vijuar më tej në Kosovën e lirë, demokratike dhe sovranë”, ka thënë Rama.

Kosova aplikon për anëtarësim në Këshillin e Evropës

12 MAJ - Kosova ka aplikuar për anëtarësim në Këshillin e Evropës. Aplikimin në selinë e Këshillit të Evropës, në Strasburg, e ka bërë ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Kosovës, Donika Gërvalla. Këshilli i Evropës është një organizatë ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit në Evropë, me seli në Strasburg të Francës. Këshilli mbron lirinë e shprehjes dhe të medieve, barazinë dhe minoritetet në vendet anëtare.

Gucati dhe Haradinaj dënohen me nga katër vjet e gjysmë burgim

18 MAJ - Dhomat e Specializuara i shpallën fajtorë Hysni Gucatin dhe

Nasim Haradinajn për pengim të administrimit të drejtësisë, duke i dënuar me nga katër vjet e gjysmë burgim dhe me një gjobë prej 100 eurosh. Gucati dhe Haradinaj u shpallën të pafajshëm për akuzën e hakmarrjes. Ekipet mbrojtëse të Nasim Haradinajt dhe Hysni Gucatit konfirmuan për gazetarët se do ta apelojnë aktgjykimin dënues për dy të akuzuarit, shqiptuar më 18 maj nga Dhomat e Specializuara në Hagë. Lënda e Gucatit dhe Haradinaj është duke u shqyrtuar nga Apeli, derisa ata janë duke qëndruar në paraburgim.

LV-ja me ndihmën e Listës Serbe e kalon Projektligjin për Pagën Minimale, përjashtohen veteranët e UÇK-së

14 QERSHOR - Me 68 vota për, asnjë kundër dhe gjashtë abstenime, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar të martën në parim Projektligjin për Pagën Minimale. Projektligji parasheh ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e përfitimit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore. Ky



projektlig është kundërshtuar nga veteranët e UÇK-së për shkak të mospërfshirjes së tyre në rritjen e pagës minimale. OVLUÇK-ja më 16 qershor ka mbajtur protestë, duke e quajtur Kuvendin institucion të turpit. Veteranët e UÇK-së kanë kërkuar që të jenë pjesë e ligjit që rregullon pagën minimale në Kosovë. Deri më tani ky projektlig nuk është miratuar në lexim të dytë.

Konjufca viziton liderët e UÇK-së në Hagë

17 QERSHOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka vizituar liderët e UÇK-së të cilët janë duke u mbajtur në paraburgim në Hagë që nga nëntori i vitit 2020. Pas kësaj vizite, Konjufca ka thënë se ata janë të pakënaqur në lidhje me procesin gjyqësor. "Vizitova Thaçin, Veselin, Krasniqin, Selimin dhe, po ashtu, Gucatin, Haradinajn dhe Shalën. Siç e dini për Salih Mustafën është një proces më i ndërlkuar. Ai ka qenë në një izolim deri para një muaji. Të gjithë që i pashë janë shumë mirë me shëndet, kanë vullnet dhe janë të qëndrueshëm. Shqetësimi i tyre është që po pretendohej për disa shkelje që po bëhen edhe nëpër procedura, për të cilat nuk ka asnjë mekanizëm të ankesës", ka thënë Konjufca.

Mbahet mbledhja e dy qeverive, nënshkruhen 19 marrëveshje të reja

20 QERSHOR - Qeveria e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë në mbledhjen e 8 të përbashkët në Prishtinë kanë nënshkruar gjithsej 19 marrëveshje të reja. Marrëveshjet përfshijnë një gamë të gjerë të fushave në infrastrukturë, arsim, rend, energji, treg i përbashkët ekonomik, turizëm, mbrojtje e të tjera. Një prej marrëveshjeve më të rëndësishme është ajo e hekurudhës Durrës - Prishtinë. Kjo hekurudhë do ta lidhë Kosovën me korridoret që kalojnë pranë saj.

Pa e ndryshuar asnjë presje, qeveria Kurti finalizoi marrëveshjen e Thaçit dhe të Mustafës për energjinë

21 QERSHOR - Kosova dhe Serbia kanë arritur të martën marrëveshje për energjinë. Për arritjen e kësaj marrëveshjeje ka njoftuar edhe kryenegociatori i Kosovës në dialogun me Serbinë, Besnik Bislimi. "Kjo mundëson faturimin e energjisë elektrike në katër komunitet veriore të Kosovës, sipas ligjeve dhe sistemit rregullativ të Kosovës", ka shkruar Bislimi në llogarinë e vet në "Twitter" pas takimit ndërmjet palëve nga Kosova dhe Serbia në kuadër të dialogut të lehtësuar nga Bashkimi Evropian. Arritjen e kësaj marrëveshjeje kryeministri Albin Kurti e ka quajtur lajm të mirë dhe ka thënë se është rezultat i punës së qeverisë që ai udhëheq. Ai ka thënë se së shpejti do të fillojë faturimi i rrymës për komunitet në veri. Pavarësisht prej kësaj, deri më tani nuk ka filluar faturimi i rrymës për komunitet në veri.

Bajram Begaj zgjedhet president i Shqipërisë

4 QERSHOR - Bajram Begaj është zgjedhur president i Shqipërisë me 78 vota të deputetëve të Kuvendit. Në votimin e tij në Kuvend kanë marrë pjesë 83 deputetë, prej të cilëve katër ishin kundër dhe një ka abstenuar. Pjesa më e madhe e opozitës nga Partia Demokratike ka bojkotuar seancën. Kandidatura e Begajt është mbështetur nga Partia Socialiste dhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i cili e ka propozuar për president pas dështimit për të zgjedhur president konsensual me Partinë Demokratike në opozitë. Begaj ka dhënë betimin si president i Shqipërisë më 25 korrik.

Rafuna zgjedhet kryetar i OEK-ut

14 KORRIK - Lulzim Rafuna është zgjedhur kryetar i Odës Ekonomike



të Kosovës (OEK). Në garë për të parin e këtij institucioni ishin edhe Erëza Vela, pronare e kompanisë "MIG Sh. P. K." dhe pronari i kompanisë "Sharr Travel", Ruzhdi Kurtishaj. OEK-u deri në zgjedhjen e Rafunës është drejtuar nga Berat Rukqiqi. Në të kaluarën Lulzim Rafuna ka qenë për një kohë të shkurtër edhe ministër në detyrë i Financave si dhe këshilltar i ish-ministrit të Financave, Bedri Hamza.

Kuvendi i Shqipërisë miraton rezolutën për raportin e Dick Martyt

21 KORRIK - Kuvendi i Shqipërisë ka votuar unanimisht, me 125 vota të deputetëve, rezolutën me të cilën synon t'i hedhë poshtë akuzat për trafikimin e organeve të qenieve njerëzore gjatë luftës në Kosovë, pretendime që burojnë nga një raport i Këshillit të Evropës. Kryeministri i Shqipërisë, njëherësh kryetar i Partisë Socialiste e cila ka hartuar këtë projekt-rezolutë, Edi Rama, ka thënë se përmes miratimit të saj synohet kthimi i dinjitetit të popullit shqiptar dhe luftëtarëve të UÇK-së. Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë kërkon t'i shpallë të pabazuara pretendimet për trafikim të organeve dhe kërkon nga

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ta rishikojë rezolutën që aprovon raportin e senatorit zviceran, Dick Marty dhe akuzat e ngritura, të cilat i vlerëson "të paargumentuara, të paprovuara dhe të pabazuara në prova e fakte".

Osmani dhe Kurti takohen me Blinkenin

27 KORRIK - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti janë pritur në Departamentin Amerikan të Shtetit (DASH) nga sekretari i Shtetit, Antony Blinken, me të cilin kanë biseduar edhe për raportet ndërshtetërore dhe dialogun me Serbinë. Në këtë takim ata kanë deklaruar se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të përfundojë me marrëveshje, e cila në qendër ka njohjen reciproke. Osmani dhe Kurti, pasi e kanë vlerësuar lart takimin me Blinkenin, kanë thënë se raportet e Kosovës me ShBA-në janë ekzistenciale.

Grevë në arsim

25 GUSHT - Mësimdhënësit, edukatorët në kopshtet publike, punëtorët e administratës publike, shërbyesit civilë në institucionet lokale dhe qendrore të Kosovës kanë hyrë në grevë. Nga qeveria kanë thënë se nuk është koha për

grevë. Ndërsa kërkesa kryesore e sindikatave të këtyre punëtorëve, drejtuar Qeverisë së Kosovës, është ndarja e 100 eurove për punëtorët derisa të hyjë në fuqi Projektligji për Paga, ku një kërkesë e tillë nuk është plotësuar. Pas pesë javësh në mes të kritikave dhe kërcënimeve, Këshilli Grevist i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, më 1 tetor ka njoftuar se e ka pezulluar grevën deri në janar të vitit 2023, por më 28 dhjetor SBASHK-u ka kërkuar që mos të ketë grevë për shkak të miratimit të Ligjit për Paga.

Doarsa Kica-Xhelili i bashkohet LDK-së

8 SHTATOR - Deputetja e Doarsa Kica-Xhelili i është bashkuar Lidhjes Demokratike të Kosovës. Kjo është prej rasteve të rralla që një deputet i partisë në pushtet kalon në opozitë. Deputeten që ishte pjesë e grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje nga radhët e Listës Guxo e ka paraqitur kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku.

Ish-presidentët dhe ish-kryeministrat shqiptarë vizitojnë liderët e UÇK-së

29 SHTATOR - Tre ish-presidentët e Shqipërisë, Alfred Moisiu, Rexhep Meidani dhe Bamir Topi, së bashku



me ish-kryeministrin Pandeli Majko, kanë vizituar liderët e UÇK-së. Në këtë vizitë ata janë shoqëruar nga ish-presidenti i Kosovës, Behgjet Pacolli. Pas takimit ata kanë thënë se liderët e UÇK-së po qëndrojnë të fortë moralisht dhe krenarë për luftën e drejtë të UÇK-së. Sipas tyre, prokuroria po kërkon diçka që nuk ekziston meqë UÇK-ja nuk ka pasur të bëjë me terrorizëm.

Shkon Latifi, vjen Vitia

6 TETOR - Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë. Kirurgu i cili u kthye nga ShBA-ja që ta drejtojë shëndetësinë e Kosovës, pas dhjetë muajsh në këtë detyrë, ia paraqiti dorëheqjen kryeministrit Albin Kurti.

“Me zhgënjim të thellë dhe keqardhje, pas shumë reflektimesh për disa muajt e fundit, po ju informoj se në mënyrë efektive ju ofroj dorëheqjen time nga posti i ministrit të Shëndetësisë së Republikës së Kosovës, që nga sot me datën 6 tetor 2022”, ka shkruar Latifi në letrën e dorëheqjes. Në vend të Latifit, më 26 dhjetor Kurti ka emëruar Arben Vitinë, i cili kishte dhënë dorëheqje në vitin 2021 për të garuar për kryetar të Prishtinës, garë të cilën e kishte humbur.

Rama në Këshillin e Evropës kërkon t'i rrëzojnë fantazitë ndaj krerëve të UÇK-së

12 TETOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i është drejtuar Këshillit

të Evropës për ta kërkuar rishikimin e raportit të Dick Martyt dhe për t'i shpallur të pabaza akuzat e tij për trafikim të organeve njerëzore gjatë luftës çlirimtare në Kosovë. Gjatë fjalës së tij, Rama i ka hedhur poshtë të gjitha pretendimet e raportit duke i analizuar të gjitha pikat e tij. Ai ka thënë se ky raport është një fantazi e pastër e fabrikuar në Kremlin dhe i sjell në Këshillin e Evropës. “Ju bëj thirrje t'i rrëzoni akuzat kundër Kosovës. Ju bëj thirrje ta pranoni kërkesën e Shqipërisë që ta rrëzoni një rezolutë që degradon luftëtarët e Ushtrisë heroike Çlirimtare të Kosovës”, ka thënë Rama.

Shkarkohet rektori i UP-së Naser Sahiti

21 TETOR - Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” ka shkarkuar Naser Sahitin nga pozita e rektorit të këtij universiteti. Kryesuesi i Këshillit Drejtues i UP-së, Altin Sahiti, ka bërë me dije se ushtruese e detyrës e rektorit është emëruar Luljeta Plakolli-Kasumi. Ndërsa më 21 nëntor Qerim Qerimi është emëruar rektor i UP-së

Serbët largohen nga institucionet e Kosovës

5 NËNTOR - Lista Serbe ka vendosur që të largohet nga institucionet qendrore të Republikës së Kosovës si dhe nga komunat në veri të vendit. Pas vendimit të marrë në një takim me dyer të mbyllura në Zveçan, dorëheqje kanë dhënë edhe pjesëtarët serbë të Policisë së

Kosovës, ata të gjyqësorit dhe prokurorisë në veri. Largimi nga institucionet ka ndodhur pas vendimit të autoriteteve të Kosovës për suspendimin e drejtorit të Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Nenad Gjuriq, i cili ka refuzuar ta zbatojë vendimin e Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e makinave që kanë targa të lëshuara nga Serbia në RKS - Republika e Kosovës.

Dy liderët e opozitës shkonjnë për vizitë zyrtare në ShBA

13 DHE 15 NËNTOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi dhe ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, kanë qëndruar për vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). Gjatë qëndrimit në ShBA ata kanë zhvilluar takime me përfaqësuesit e institucioneve kryesore amerikane. Krasniqi dhe Abdixhiku kanë theksuar se Kosova edhe sot ka nevojë për mbështetjen e ShBA-së si mike dhe partnere strategjike e vendit tonë. Derisa Krasniqi dhe Abdixhiku kanë vizituar ShBA-në, disa prej ministrave të Kurtit u janë shtyrë vizitat për shkak të çështjes së targave.

Osmani i shpall dhe i shtyn zgjedhjet në katër komunat veriore

14 NËNTOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka caktuar 18

dhjetorin datë të mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetarë të komunave në veri. Katër komunat e banuara me shumicë serbe - Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan - janë pa kryetarë qysh nga 5 nëntori. Kryetarët, të nacionalitetit serb, dhanë dorëheqje në shenjë kundërshtimi ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për ta nisur procesin për reregjistrimin e makinave me targa të paligjshme serbe. Ndërsa pas tensioneve në veri dhe kërkesës së ndërkombëtarëve, Osmani më 10 dhjetor ka vendosur për shtyrjen e këtyre zgjedhjeve.

Kurti ua ul pagat prokurorëve dhe gjyqtarëve, reagojnë opozita dhe shoqëria civile

23 NËNTOR - Qeveria e Kosovës ka shfuqizuar vendimin e ish-qeverisë Haradinaj për rritjen e pagave për prokurorët dhe gjyqtarët në vitin 2017. Kryeministri Albin Kurti ka thënë se pagat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve kthehen në lartësinë e rregullimit juridik të mëparshëm para datës së hyrjes në fuqi të vendimit për ngritjen e pagave të kabinetit qeveritar, rrjedhimisht edhe këtyre institucioneve të drejtësisë. Kundër këtij shfuqizimi kanë reaguuar opozita dhe shoqëria civile. Organet e drejtësisë, për shkak të këtij vendimi, e kanë ndërprerë bashkëpunimin me qeverinë. Ndërsa më 2 dhjetor Gjykata Themelore në Prishtinë ka

vendosur ta pezullojë ekzekutimin e vendimit të Qeverisë së Kosovës për uljen e pagave të prokurorëve dhe gjyqtarëve.

Kosova dhe Serbia arrijnë marrëveshje për targa

23 NËNTOR - Kryediplomati evropian Josep Borell ka bërë me dije se Kosova dhe Serbia, nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian (BE), kanë arritur marrëveshje për targa ilegale serbe. Borelli ka thënë se Kosova do t'u japë fund veprimeve të mëtejme të lidhura me reregjistrimin e makinave, derisa Serbia nuk do të lëshojë më targa të makinave me emra të qyteteve të Kosovës. Kjo marrëveshje ishte arritur pas kërkesës që ShBA-ja ia kishte bërë Kurtit më 22 nëntor për ta shtyrë për 48 orë zbatimin e fazës së dytë të vendimit për reregjistrimin e makinave me targa ilegale serbe në RKS - Republika e Kosovës - për t'u dhënë mundësi bisedimeve të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

110-vjetori i pavarësisë bën bashkë në Tiranë Kuvendin e Kosovës dhe të Shqipërisë

27 NËNTOR - Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë janë mbledhur në Tiranë për nder të 110-vjetorit të Pavarësisë Shqipërisë, në mbledhjen e parë të përbashkët midis dy parlamenteve,





duke shënuar kështu nivelin më të lartë të bashkëpunimit në historinë e parlamentarizmit të të dyja shteteve.

Bashkëkryesuesit e kësaj mbledhjeje, kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca dhe kryetarja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Lindita Nikolla, në fjalimet e tyre përshëndetëse theksuan rëndësinë e kësaj mbledhjeje të përbashkët, si gurthemel të një tradite të re të bashkëpunimit ndërparlamentar.

Lëvizja pa viza për qytetarët e Kosovës, më së largu më 1 janar 2024

30 NËNTOR - Ambasadorët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian janë pajtuar për t'i dhënë mandat Këshillit Evropian që të negociojë për procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën me Parlamentin Evropian. Sipas vendimit, lëvizja pa viza për qytetarët e Kosovës do të jetë e mundur kur të hyjë në fuqi sistemi evropian i udhëtimit, ETIAS, dhe data për këtë është 1 nëntori i vitit 2023. Por, në rast se do të ketë vonesa për këtë sistem, liberalizimi i vizave për Kosovën do të hyjë në fuqi jo më vonë se më 1 janar të vitit 2024.

Tirana, nikoqire e samitit të liderëve të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor

6 DHJETOR - Në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë, është mbajtur

Samiti i Bashkimit Evropian (BE) dhe Ballkanit Perëndimor. Në këtë samit kanë marrë pjesë përfaqësuesit kryesorë të Evropës dhe Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë kancelarin e Gjermanisë dhe presidentin e Francës, Emmanuel Macron. Në Samitin e Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor ka marrë pjesë edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani. Krahas krizës energjetike, në këtë samit është firmosur marrëveshja për heqjen e tarifave "Roaming". Po në këtë samit janë zotuar 1 miliard euro për Ballkanin Perëndimor.

Dy herë brenda vitit veriu barrikadohet nga serbët

10 DHJETOR - Tensionet në veriu të Kosovës janë ngritur që nga nëntori nga 5 nëntori, kur serbët janë larguar nga institucionet e Kosovës. Por, tensionet kanë kulmuar me vendosjen e barrikadave më 10 dhjetor nga disa serbë lokalë, në shtetë pakënaqësie me arrestimin e një ish-polici serb të Kosovës.

Dejan Pantiq dyshohet se ka organizuar sulmin e 6 dhjetorit ndaj zyrtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Më 28 dhjetor Pantiqit i është ndryshuar masa e paraburgimit me arrest shtëpiak, kur pastaj barrikadat janë larguar. Për shkak të barrikadave, rrugët që çojnë drejt pikëkalimeve kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak, që lidhin Kosovën dhe Serbinë, ishin të bllokuara. Këto dy pika kufitare që nga 10 dhjetori janë të mbyllura. Autoritetet në Kosovë

më 27 dhjetor kanë mbyllur edhe pikën kufitare të Merdarit, pasi në anën serbe të kufirit u vendosën barrikada.

Për vendosjen e barrikadave Kosova ka fajësuar "grupet kriminale" që mbështeten nga Serbia. Ndërkaq Beogradi ka shprehur përkrahjen për barrikadat dhe ka thënë se ato nuk do të hiqen derisa Prishtina ta formojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Së fundi, në veri janë regjistruar një sërë incidentesh me armë zjarri, granata dore dhe shok-bomba. Çak i sulmeve kanë qenë pjesëtarët e Policisë së Kosovës, të misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, ata të misionit të BE-së për Sundim të Ligjit, EULEX, dhe gazetarët.

Veriu i Kosovës është barrikaduar edhe më 31 korrik për shkak të targave dhe dokumenteve serbe.

Kosova nënshkruan aplikimin për anëtarësim në BE

14 DHJETOR - Krerët shtetërorë të Kosovës kanë nënshkruar aplikimin për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Aplikimi është nënshkruar nga presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca dhe kryeministri Albin Kurti. Nënshkrimi i këtij dokumenti është vlerësuar historik nga drejtuesit e shtetit. Ndërsa kryeministri Kurti më 15 dhjetor këtë dokument e ka dorëzuar në Pragë të Çekisë, shtetin që

aktualisht kryeson presidencën e bllokut evropian.

Miratohet buxheti i Kosovës për vitin 2023

15 DHJETOR - Kuvendi i Kosovës ka miratuar në lexim të dytë buxhetin 2023 në vlerë prej 3.21 miliardë eurosh. Ligji mbi ndarjet buxhetore ka kaluar në lexim të dytë me mbështetjen e 65 deputetëve. Në votimin e këtij Ligji kanë marrë pjesë 65 deputetë. Më 17 nëntor deputetët e Kuvendit e kishin miratuar në parim buxhetin për vitin 2023. Buxheti për vitin 2023 do të jetë 3 miliardë e 212 milionë euro.

Gjykata Speciale e dënon me 26 vjet burgim komandant "Calin"

16 DHJETOR - Ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Salih Mustafa, është dënuar të premtën nga Gjykata Speciale, me seli në Hagë, me 26 vjet burgim për vrasje të paligjshme, ndalim arbitrar dhe torturë. Ndaj këtij vendimi të Speciales ka pasur reagime të shumta në Kosovë, duke e vlerësuar dënim të padrejtë dhe të pabazë. Përfaqësues të OVLUÇK-së kanë theksuar se Gjykata Speciale bazohet në dëshmitarë të fshehur nga populli e dënon në emër të popullit. Sipas tyre, lufta e UÇK-së ishte e drejtë, e pashmangshme dhe e domosdoshme.

Kuvendi miraton Projektligjin për Paga dhe atë për Zyrtarët Publikë

22 DHJETOR - Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar në lexim të dytë Projektligjin për Paga në sektorin publik si dhe Projektligjin për Zyrtarët Publikë. Në të dyja votimet e projektligjeve, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka abstenuar. Ndërkaq partitë opozitare nuk e kanë mbështetur Projektligjin për Paga dhe as Projektligjin për Zyrtarët Publikë. Përfaqësuesit e opozitës kanë theksuar se këto dy projektligje t'i dërgojnë në Kushtetuese.

Ish-deputeti Frashër Krasniqi dhe të tjerët liro-hen nga akuza për terror-izëm

27 DHJETOR - Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur aktgjykim liruës ndaj të akuzuarve Frashër Krasniqi, Adea Batusha, Egzon Haliti dhe Atdhe Arifi, lidhur me akuzën për terrorizëm. Në këtë proces gjyqësor, i cili ishte kthyer në rigjykim, Krasniqi, Batusha, Haliti dhe Arifi, akuzoheshin se janë përgjegjës për sulmin në Kuvendin e Kosovës në gushtin e vitit 2016, që është kualifikuar si vepër terroriste. Sipas aktgjykimit, Frashër Krasniqi, Adea Batusha, Egzon Haliti dhe Atdhe Arifi lirohen nga aktakuza, pasi nuk është vërtetuar se kanë kryer veprën penale që u vihej në barrë.



Kosova hyn në vitin e tretë të padrejtësisë ndaj strategëve të lirisë

Procesi gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së në Hagë pritet të nisë në fillim të vitit 2023. Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi janë duke u mbajtur në paraburgim në Hagë që nga viti 2020. Edhe gjatë vitit 2022 avokatët kanë kërkuar nga Gjykata Speciale që liderët e UÇK-së të mbrohen në liri, por këto kërkesa nuk janë marrë parasysh. Gjatë seancave parapërgatitore avokatët mbrojtës kanë hedhur akuza në drejtim të ZPS-së për fsheje të dokumenteve shfajësuese dhe bashkëpunim me Serbinë dhe shërbimet sekrete të këtij shteti. Gjatë vitit 2022 Specilaja ka dënuar Hysni Gucatin, Nasim Haradinajn dhe Salih Mustafën

EPOKA ERE

Lirim GECI

PRISHINË, DHJETOR/JANAR - Gjykata Speciale në Hagë, në të cilën janë duke u mbajtur strategët e lirisë së Kosovës që nga nëntori i vitit 2020, është shndërruar në vend pelegrinazhi. Gjatë vitit 2022, liderët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, janë vizituar nga personalitete të shquara të jetës publike shqiptare. Krahas vizitave, në vitin 2022 janë zhvilluar disa seanca parapërgatitore për fillimin e gjykimit të liderëve të UÇK-së, i cili pritet të nisë në fillim të vitit 2023 dhe janë shpallur dy aktgjykime. Drejtuesit e OVLUÇK-së, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj, janë

dënuar nga shkalla e parë e Speciales me nga 4 vjet e gjysmë burgim, ndërsa ish-komandanti i UÇK-së, Salih Mustafa, i njohur si "Cali", është dënuar me 26 vjet burgim, po ashtu nga shkalla e parë e kësaj gjykate. Këto dënime janë vlerësuar të ndikuara politikisht dhe me argumente serbe. Më 24 dhjetor në Prishtinë është protestuar kundër dënimit të "Calit".

Kjo protestë është organizuar nga PSD-ja e Dardan Molliqajit. Në këtë protestë është kërkuar nga Kuvendi i Kosovës që ta ndryshojë Ligjin për Gjykatën Speciale. Gjykimi ndaj Pjetër Shalës, i njohur si komandant "Ujku", nuk ka filluar ende. Kujtojmë se edhe gjatë vitit 2022 avokatët mbrojtës kanë kërkuar disa herë që liderët e UÇK-

së të mbrohen në liri, duke ofruar edhe garanci, por nuk janë marrë parasysh nga Gjykata Speciale. Po ashtu, gjatë konferencave për ecurinë e çështjes, avokatët mbrojtës kanë akuzuar Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) se është duke u shërbyer me dokumente serbe dhe fshehur provat shfajësuese ndaj liderëve të UÇK-së.

ZPS-ja ka fshehur provat shfajësuese për liderët e UÇK-së

Në konferencën e dhjetë për ecurinë e çështjes të mbajtur më 4 shkurt, avokatët e liderëve të UÇK-së kanë akuzuar Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) se ka fshehur provat shfajësuese për klientët e tyre. Ata kanë thënë se në këtë mënyrë ZPS-ja ka shkelur të drejtat e Hashim Thaçit, të Kadri Veselit, të Jakup Krasniqit dhe të Rexhep Selimit. Para trupit gjyqësor, Gregory Keohe, avokat i Hashim Thaçit, ka përmendur një deklaratë të cilën e ka dhënë ish-ambasadori i OSB-së në Kosovë, Dan Everts, e cila është shfajësuese për Thaçin dhe të tjerët. Po ashtu, ai ka thënë se as deklaratën e ish-kryeministrit Bujar Bukoshit nuk e ka dorëzuar ZPS-ja. Ndërsa avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka kërkuar të dijë nga prokuroria se edhe sa materiale

shfajësuesi ka, mirëpo prokurorja Claire Lawson nuk ka treguar se edhe sa materiale të tilla ka.

ZPS-ja akuzohet se po dëshiron ta përjashtojë mbrojtjen për intervistimin e dëshmitarëve

Në seancën e 22 shkurtit është diskutuar në lidhje me intervistimin e dëshmitarëve në rastin e Thaçit dhe të tjerëve. Avokati i Thaçit, Gregory Keohe, ka thënë se mbrojtjes duhet t'i lejohet qasje pa kufizime për intervistimin e dëshmitarëve. Ai ka thënë se në situatën aktuale dhe me masat mbrojtëse të propozuara nga prokuroria, nuk ka barazi në mes të palëve në procedurë. Ndërsa avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka hedhur akuza të ashpra ndaj Prokurorisë së Speciales në lidhje me protokollin e propozuar nga ajo për kontaktet me dëshmitarët. Emmersoni ka thënë se pretendimet e Prokurorisë për ndërhyrje të mundshme të mbrojtjes të dëshmitarëve janë qesharake dhe fyese. Avokati i Veselit ka thënë se Prokuroria ka orkestruar takim me ambasadorët evropianë për çështjen e të akuzuarve dhe, sipas tij, kjo është diçka shokuese. Sipas tij, këto janë zhvillime të tmerrshme. Ndërsa në seancën e 20 marsit avokati i

Hashim Thaçit, Gregory Kehoe, ka thënë se gjatë punës së tij 30-vjeçare nuk ka parë qaq shumë redaktime në dokumente. Ai ka rrëfyer vështirësitë me të cilat po ballafaqohet mbrojtja për shkak të redaktimeve në dokumentet e aktakuzës. Sipas tij, kjo e ka vështirësuar punën e mbrojtjes që të kuptojë se çfarë prokuroria po tenton të vërtetojë.

Mbrojtja e liderëve të UÇK-së: Prokuroria po shërbehet me materiale të UDB-së

Mbrojtja e liderëve të UÇK-së në seancën e 24 marsit ka fajësuar Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) në Hagë për fsheje të dokumenteve shfajësuese. Avokati i Hashim Thaçit, Gregory Keohe, e ka akuzuar ZPS-në se ka marrë shumë informacione dhe dokumente nga Shërbimi Inteligent i Serbisë (UDB-a). Sipas avokatit Keohe, me mijëra materiale shfajësuese janë duke u fshehur nga ZPS-ja edhe 16 muaj pas burgosjes së liderëve të UÇK-së. Avokati i Thaçit, Gregory Keohe, ka thënë se deri më tani mbrojtja ka kërkuar mbi 1 000 dokumente të ndryshme. Sipas tij, ndonëse ishte premtuar se ato do t'i dorëzohen mbrojtjes, deri më sot kjo nuk ka ndodhur. Kurse mbrojtja e Kadri Veselit gjatë



Avokati i Thaçit për Specialen: Procesi është bizar, i prishur dhe i ndotur

Avokati i ekipit të mbrojtjes të Thaçit, Luka Misetiq, më 21 tetor e ka quajtur aspak të arsyeshëm krijimin e Gjykatës Speciale në Hagë. Misetiq në "Prime Time" në "Kanal10" ka deklaruar se, sipas tij, është një perceptim i qartë që nuk ka pasur nevojë të krijohet një gjykatë e cila do t'i gjykojë vetëm shqiptarët. Misetiq, duke folur për krijimin e Speciales, ka thënë se i gjithë procesi është bizar dhe i ndotur për faktin se gjykata u krijua nën pretendimet se UÇK-ja ka bërë trafikim organesh.

konferencës mbi ecurinë e çështjes ndaj krerëve të UÇK-së ka fajësuar Zyren e Prokurorit të Specializuar (ZPS) se nuk i ka nxjerrë provat shfajësuese. Avokati i Veselit, Ben Emmerson, ka thënë se të gjitha provat që gjenden në domenin publik konfirmojnë manipulimet e provave nga autoritetet serbe. Ai ka shtuar se këto prova janë të rrejshme, të cilat përfshijnë torturën dhe shantazhin, dhe të njëjtat nuk janë dhënë nga ZPS-ja, apo nuk i ka përfshirë në materialet shfajësuese

Drejtimesit e UÇK-së deklarohen të pafajshëm, kërkojnë fillimin e gjykimit

Më 11 maj liderët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, janë deklaruar të pafajshëm për disa aktakuza të reja që janë paraqitur më 29 prill pranë Dhomave të Specializuara në



Hagë. Thaçi ka thënë se nuk e ka kuptuar aktakuzën pasi, sipas tij, materialet kanë qenë shumë të redaktuara. Ai është deklaruar i pafajshëm. Edhe Veseli është deklaruar i pafajshëm, duke kërkuar që procesi gjyqësor të fillojë sa më shpejt për ta shprehur pafajësinë para qytetarëve të Kosovës. Të pafajshëm janë deklaruar edhe Krasniqi e Selimi, të cilët, gjithashtu, kanë kërkuar të përshpejtohet procesi gjyqësor

ZPS-ja fshehu dokumentet shfajësuese të CIA-s dhe DASH-it

Avokati amerikan Gregory Kehoe, i cili mbron ish-presidentin Hashim Thaçi, në një seancë gjatë shkurtit të këtij viti, më 1 qershor ishte parë në kulmin e frustrimit, pasi kishte zbuluar se Prokuroria e Gjykatës Speciale kishte mbajtur të fshehta disa prova shfajësuese për të akuzuarit, mes të cilave edhe ajo e dhënë nga ish-diplomatit i lartë i OSBE-së, Dan Everts. Evertsi, që ka shërbyer në Kosovë menjëherë pas luftës, mes të tjerash, i kishte thënë prokurorisë se veprimtaritë kriminale, pas qershorit të vitit 1999, janë kryer nga individë që kërkonin një rast për përfitime personale, e nuk ishin pjesë e një fushate të organizuar nga udhëheqja shqiptare. Prokuroria është akuzuar se ka mbajtur të fshehtë një letër të Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH), të datës 4 maj 1999, në të

cilën është thënë se nuk kishte strukturë politike ose komandë dhe kontroll efikas të UÇK-së. I fshehur ishte mbajtur edhe një raport i CIA-s, i janarit të vitit 2000, në të cilin thuhej se UÇK-ja nuk kishte kryer akte terroriste kundër caqeve civile. Në një dokumentar në emisionin "Opinion" të Blendi Fevziut, i titulluar "Devijimi special", është zbuluar saktë se çfarë shkruhej në këto letra/dokumente. Fshehja e provave shfajësuese është konsideruar me pasoja të rënda dhe shkelje të të drejtave të njeriut, ndërsa mbrojtja ka kërkuar në procesin e shpalosjes së materialeve dhe dëshmimeve të instalohet një mbikëqyrje e pavarur.

Mbrojtja e liderëve të UÇK-së kërkon nga prokuroria dorëzimin e materialeve shfajësuese

Në konferencën e 13-të për ecurinë e çështjes në rastin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit e Rexhep Selimit, të mbajtur më 13 korrik, mbrojtja dhe prokuroria kanë vazhduar të merkurën diskutimin rreth nxjerrjes së materialeve. Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi këtë konferencë e kanë përcjellë përmes videolidhjes. Mbrojtja ka kërkuar që prokuroria t'ia vë në dispozicion menjëherë dokumentet të cilat lidhen me materialet shfajësuese dhe, sipas saj, ZPS-ja ka materiale të tilla, por nuk i dorëzon ato. Avokati i ish-presidentit Hashim Thaçi,

Gregory Kehoe, ka thënë se prokuroria duhet t'i dorëzojë materialet shfajësuese menjëherë dhe jo t'i kërkohet të bëjë një gjë të tillë duke shtuar se ky është detyrim për ZPS-në. Për këtë ka folur edhe mbrojtja e Jakup Krasniqit, Aydan Elis, i cili ka thënë se nxjerrja e materialeve shfajësuese nuk duhet të shtyhet më. ZPS-ja e ka kundërshtuar caktimin e një afati për nxjerrje të tilla, duke thënë se kufizimi i prokurorisë në këtë aspekt nuk është në interes të askujt. Ben Emmerson, avokat i Veselit, ka deklaruar se kanë përpara afatin e dorëzimit të dosjeve paraprake dhe kanë ndër mend të mbetet afat i pandryshuar.

Mbrojtja: ZPS-ja në Hagë po bashkëpunon me Beogradin sikur Kosova të jetë pjesë e Serbisë

Katër avokatët e drejtuesve të UÇK-së më 21 gusht kanë shfaqur dilema serioze në bashkëpunimin që e ka Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) me Beogradin zyrtar. Mbrojtja e Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit është bërë bashkë, duke kërkuar nga ZPS-ja t'i tregojë cilat materiale i ka marrë nga Serbia. Madje avokatët e liderëve të UÇK-së kanë pretenduar se ZPS-ja në Hagë është duke bashkëpunuar me Beogradin zyrtar, nën parimin se Kosova është pjesë e Serbisë. Në një përgjigje ndaj ZPS-së që e kanë dërguar te gjyqtari,

avokatët e katër udhëheqësve të UÇK-së kanë vlerësuar se kjo e cenon rëndë procesin ndaj klientëve të tyre. Ata kanë bërë me dije se janë mbi 1 300 materiale të cilave nuk u dihet vendi i origjinës. Ndërsa më 9 shtator, avokati i Thaçit ka kërkuar nga Gjykata Speciale t'i refuzojë dokumentet që Zyra e Prokurorit të Specializuar i merr nga Serbia, ndërsa ka theksuar se e kjo e fundit ka qenë historikisht e përfshirë në fabrikimin e dëshmimeve dhe dëshmitarëve. Në një intervistë për "Kosovapress", avokati Kehoe ka thënë se aktakuza është kundër UÇK-së dhe prokuroria po përpiqet ta dokumentojë atë si një organizatë sekrete.

Gjykimi i liderëve të UÇK-së pritet të nisë në fillim të vitit 2023

Kryetarja e Gjykatës Speciale, Ekaterina Trendafilova, më 21 shtator ka mbajtur në Hagë një konferencë online për medie, në të cilën ka folur në mënyrë kronologjike për ecurinë e proceseve gjyqësore kundër përfaqësuesve të UÇK-së të cilët janë duke u mbajtur në paraburgim nga viti 2020. Kjo konferencë ishte paraparë të mbahej në Gjilan, mirëpo është anuluar pasi ishte paralajmëruar një protestë kundër vizitës së saj nga ana e Partisë Socialdemokrate (PSD), e cila ishte e mbështetur edhe nga disa degë të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Duke folur për rastin e liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimit, kryetarja Trendafilova ka bërë me dije se më së largu deri në fillimin e vitit 2023 pritet të fillojë shqyrtimi kryesor në rastin e katër drejtuesve të UÇK-së.

Mbrojtja e Thaçit zbulon identitetin e tetë dëshmitarëve ndërkombëtarë

Më 4 nëntor ekipi mbrojtës i ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, përmes një mocioni të dërguar gjykatësit të procedurës paraprake, ka treguar se janë tetë dëshmitarë ndërkombëtarë që planifikon të ftojë në gjykimin pranë Dhomave të Specializuara në Hagë. Mbrojtja ka kërkuar që dëshmitë e këtyre dëshmitarëve të mund të "ruhen" para se të nisë gjykimi. Në listën e paraqitur të dëshmitarëve përfshihen: Wesley Clark, William Walker, Bernard Kouchner, Daan, W. Everts, Michael Durkee, Jock Covey dhe Steve Bennett. Të tetë dëshmitarët janë në moshë të shtyrë, nga 77 deri në 88 vjeç dhe kanë sëmundje të ndryshme dhe për mbrojtjen është ideale që t'i thërrasë këta dëshmitarë. Mbrojtja e Thaçit ka thënë se ka humbur dy dëshmitarë potencialë: ish-sekretaren amerikane të Shtetit, Madeleine Albright, që vdiq në moshën 84-vjeçare, dhe ish-diplomatit amerikan, që vdiq më 2010 në moshën 69-vjeçare, Richard Holbrooke.





Çfarë thonë Kurti, Krasniqi, Abdixhiku e Haradinaj për vitin që lamë pas



Albin Kurti: 2022-a ishte vit i rritjes së ekonomisë, ligjshmërisë dhe demokracisë

“Si qeveri ende nuk jemi në mes të mandatit, në gjysmë të mandatit, por progresi si dhe sfidat janë evidente. Viti 2022 ishte vit i krizave të shumëfishta, por në Republikën e Kosovës ishte vit i rritjes së ekonomisë, ligjshmërisë dhe demokracisë brenda vendit tonë si dhe i imazhit të Kosovës jashtë në botë. Në këtë vit që po e lëmë pas, për çështjen e drejtësisë opozita nuk na e ka dhënë ndonjë ide, kurse për atë të ekonomisë e kanë veç një ide: heqjen e TVSh-së. I falënderojmë. Tash viti 2023 duhet të jetë vit i vetingut për drejtësi dhe i zhvillimit edhe më të madh në ekonomi. Puna jonë,

informimi juaj, mirëqenia qytetarëve”.

Memli Krasniqi: Vit i dështimit në energji, ekonomi, arsim, diplomaci dhe shëndetësi

“Viti 2022 për Kosovën ka qenë vit i dështimit në energji, ekonomi, arsim, diplomaci dhe shëndetësi. Vit i stagnimit ekonomik përbrenda dhe inflacionit rekord; Vit i pasigurisë sociale për qytetarë dhe i ikjes së të rinjve; Një vit i dështuar politik për shtetin dhe izolimit nga jashtë. Nuk është as e lehtë dhe as dëshirë e jona, që vitin 2022 të mos mund ta mbajmë mend për gjëra të mira, por, fatkeqësisht, kjo është “Kronikë e një dështimi të paralajmëruar” nga unë dhe PDK



qysh me 22 mars të vitit 2021, kur ishte emëruar Qeveria Kurti II. Kabineti i dobët dhe planprogrami i varfër i kësaj qeverie, por edhe përvoja me Qeverinë Kurti I, na kishin treguar qysh në fillim se çka na pret. Gjatë këtij viti, Kjo Qeveri ka prodhuar gjithçka, përveç program zhvillimor e mbështetës për shtetin dhe qytetarët”.

Lumir Abdixhiku: Viti 2022 ishte i rëndë për vendin tonë

“Viti 2022, ndonëse i rëndë për vendin tonë dhe perspektivën e domosdoshme për qytetarët tanë, ishte vit i angazhimit të jashtëzakonshëm të burrave e grave të shtëpisë sonë politike. Sot Kosova po përballlet me kriza të njëpasnjëshme. Rëndesa

ekonomike, e rritjes së çmimeve, e kaosit energjetik, e rrënimit shëndetësor e arsimor, e polarizimeve të skajshme me sektorin privat, me media, me mësues, mjek e me gjithë spektrin politik është bërë krejtësisht e zakonshme; siç është bërë e zakonshme dhe përplasja me aleatët tanë. E udhëhequr nga populistët që s’zgjedhin mjete për pushtet, e toksikuar nga diskursi politik e polarizues në vend, Kosova nuk po arrin as të hedhë hapat e mëdhenj zhvillues në vend, e as të ndërtojë ura bashkëpunimi të brendshme, edhe më pak ura komunikimi me aleatët tanë tradicional. Potenciali ynë ekonomik, arsimor, shëndetësor, ligjor, social e ndërkombëtar është peng i tekeve populiste që gjejnë fajtorë për mosveprimin e vet”.

Ramush Haradinaj: 2022-a, vit sfidues

“Fatkeqësisht, gjatë mandatit të kësaj qeverie, roli i saj në zhvillimin ekonomik nuk është ndier mjaftueshëm. Kriza ekonomike dhe arroganca e tyre ndaj nevojave të këtij sektori ka ndikuar që ky vit të jetë një vit sfidues për ekonominë e vendit, në veçanti për sektorin privat. Qeveria jonë ka dështuar të tregojë rezultate të kënaqshme. Ka dështuar në tema madhore që janë jetike për vendin. Në aspektin e sigurisë ka neglizhuar këshillat e aleatëve tanë, ShBA-së në veçanti, duke i bërë dëm të madh vendit. Shpresoj se viti që po vjen të jetë një vit më dinamik dhe më frytdhënës për ekonominë e vendit dhe shpresojnë për mirësimin e mirëqenies së qytetarëve”.

(Përgatiti: Faton DËRMAKU)



Vazhdoi dështimi i politikës së jashtme edhe në vitin 2022, asnjë njohje

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Gjatë vitit 2022 Kosova nuk ka pasur asnjë njohje të re. 2022-ta shënon vitin e dytë që Kosova nuk ka pranuar asnjë njohje të re. Kjo nuk po vlerësohet mirë as nga njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe as nga përfaqësuesit e opozitës të cilët thonë se kjo ka ardhur si shkak që diplomacia e Kosovës nuk ka qenë aktive në lobim dhe në bërjen e politikës së jashtme. Ministria e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, gjatë raportimit të fundit për vitin 2022 në Komisionin për Punë të Jashtme dhe Diasporë, ka thënë se nuk kanë asnjë njohje të re në tavolinë, por ka pohuar se ka lëvizje të shumta me shtete të ndryshme me të cilat nuk ka pasur asnjë lloj bashkëpunimi me republikën e Kosovës duke mos përmendur emra. "Sa iu përket njohjeve të reja, natyrisht që në aspektin teknik nuk kemi asnjë njohje të re në tavolinë, por kemi lëvizje të shumta me shtete të ndryshme me të cilat nuk ka pasur asnjë lloj bashkëpunimi me Republikën e Kosovës. Ka pasur një fushatë nga ana e Serbisë për çnjohje, por nuk kemi asnjë informacion që kjo fushatë të ketë pasur sukses në ndonjërin

nga shtetet të cilat janë adresuar nga Serbia", ka theksuar ajo. Ndërkaq presidentja e vendit, Vjosa Osmani, gjatë fjalimit të saj në Konferencën e gjashtë të Ambasadorëve të Republikës së Kosovës, ka arsyetuar mungesën e njohjeve të reja, duke ia lënë fajin Serbisë. "Serbia vazhdoi veprimet aktive kundër pozitës sonë ndërkombëtare nëpërmjet kampanjës korruptive të bllokimit të njohjeve të reja dhe anëtarësimeve në organizata ndërkombëtare. Këto veprime të Serbisë i kemi luftuar në bashkëpunimin me shtetet aleate dhe kemi ndërmarrë hapa konkretë drejt krijimit të kanaleve të komunikimit me shtete jonjohëse dhe këtë vit, siç e dini, kemi paraqitur edhe kërkesën për anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe, po ashtu, aplikimin për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Megjithatë, si politikë e jashtme duhet t'i shumëfishojmë edhe më tutje përpjekjet tona të përbashkëta për ta ndaluar ndikimin e Serbisë te shtetet e tjera, sidomos duke e shfrytëzuar partneritetin tonë të afërt me shtetet mike që kemi në secilin kontinent", ka thënë Osmani. Profetori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka thënë se Ministria e Punëve të Jashtme do të duhej të ishte më aktive në politikën e jashtme. Sipas

tij, Kosova do të duhej të kishte prioritet njohjen nga pesë vendet anëtare të BE-së. "Tani procesi është më i vështirë, pasi bëhet fjalë për shtete që kanë varësi nga shtetet që janë kundërshtarë të pavarësisë së Kosovës. Kemi pasur lobim kundër njohjeve nga diplomacia serbe dhe kjo ka ndikuar në pengim të njohjeve të reja. Ka pasur hapësirë të bëhet edhe më shumë, sidomos nga Ministria e Punëve të Jashtme, që ta ketë më aktiv lobimin, të angazhojë kompani lobuese", ka thënë Gashi. Profetori Valon Murati ka thënë se politika e jashtme e shteteve të vogla si Kosova duhet të jetë shumë e kujdesshme, e balancuar, e fokusuar dhe e koordinuar me ata që i konsideron aleatë strategjikë. Ai thotë se kjo qeveri është konfuzë sa i përket politikës së jashtme. "Përshtypja ime është që politika e jashtme e kësaj qeverie është konfuzë dhe pa ndonjë busull të qartë. Ka një tension me aleatët kryesorë, sidomos me ShBA-në dhe BE-në, që lidhet kryesisht me qasjen rreth dialogut, dhe ka një izolim të pakuptueshëm në raport me shtetin shqiptar dhe mungesë të dukshme e koordinim të politikës së jashtme në kohën e ngritjes së peshës së Shqipërisë në marrëdhëniet ndërkombëtare", ka thënë Murati.

Avni Spahiu, i cili ka shërbyer ambasador i Kosovës në Shtetet e Bashkuara dhe në Turqi, thotë se MPJD duhet të aktivizohet dhe të sigurojë njohje të reja për Kosovën, që do ta fuqizonin subjektivitetin e saj ndërkombëtar. "Në të kaluarën Ministria e Jashtme ka pasur një program konkret se si t'u qasemi kërkesave për njohje të vendit, por mendoj se ka një stagnim në angazhimin e duhur të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Për fat të keq, po shihet një neglizhencë", ka pohuar Spahiu. Sipas tij, fokusi duhet të jetë në pesë vendet e Bashkimit Evropian që nuk e njohin ende Kosovën. Lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se Kosova gjatë vitit 2022 ka mbetur pa politikë të jashtme reale. "Në sinkron me presidenten, kryeministrin dhe ministrin përkatës, shteti ynë ka abstenuar nga politika e jashtme, duke e humbur shansin për t'i shfrytëzuar rrethanat e krijuara në fillim të vitit, për ta avancuar agjendën tonë shtetërore. I kemi bërë thirrje me kohë qeverisë për anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe Partneritet me NATO-n. Për të parën ka pasur iniciativë të vonuar, e cila sot s'dihet se ku është, ndërsa për të dytën as edhe iniciativë. Aplikimi

për anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe Bashkimin Evropian, ekskluzivisht, ka qenë dhe do të dëshmohej i tillë, vetëm sa për sy e faqe dhe pa asnjë koordinim me partnerët tanë ndërkombëtarë. Në anën tjetër, gjatë këtij viti kur bota po rirreshtohet në vlera e parime, Kosovës nuk i ka ardhur asnjë njohje e re. As anëtarësim në organizata ndërkombëtare, asnjë avancim në marrëdhënie bilaterale", ka thënë Krasniqi. Edhe kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se një pushtet i paafët brenda është i paafët edhe jashtë. Sipas tij, ka dy vjet që Kosova nuk ka marrë as edhe një njohje, nuk ka bërë as edhe një anëtarësim, nuk ka bërë as edhe një shenjë të vetme në avancimin e çështjes së Kosovës nëpër botë. "Mbi të gjitha, sot Kosova është bërë temë e deklarimeve zhgënjyese nga aleatët tanë që na qëndruan në përpjekjen tonë kolektive edhe për liri, edhe për pavarësi, edhe për demokraci. Kjo nuk është Kosova që e kemi menduar ndonjëherë", ka thënë Abdixhiku. Që nga shpallja e pavarësisë 117 shtete e kanë njohur Kosovën shtet të pavarur. Izraeli është vendi i fundit që ka njohur pavarësinë e Kosovës dy vjet më parë pas marrëveshjes në mes të Kosovës e Serbisë në Uashington.





FSK-ja, institucioni më i besueshëm nga qytetarët në vitin 2022

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) është renditur institucioni më i besueshëm jo vetëm në sektorin e sigurisë, por edhe në krahasim me institucionet në kuadër të sektorëve të tjerë në vitin 2022.

Raporti i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), me temën "Perceptimet publike për besimin, korrupsionin dhe integritetin e institucioneve publike në Kosovë" për vitin 2022, ka theksuar se 83 për qind e të anketuarve kanë shprehur besim

apo besim të plotë në FSK-në. Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, i ka ftuar qytetarët të kontribuojnë në Fondin e Sigurisë për ushtrinë. Ai ka thënë se nevojitet mbështetja qytetare për ta konsoliduar Forcën e Sigurisë së Kosovës në nivelin e ushtrive anëtare të NATO-s. "Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës nuk janë duke u trajnuar thjesht për lavdi. Atyre nuk u intereson sa medalje fitojnë, apo sa herë i shohin emrat e tyre në televizion apo në portale. Ata janë atje, në

kazermë, në terren, çdo minutë të çdo dite duke u angazhuar për atë që besojnë. Trajtohen e ushtrijnë që niveli i tyre i përgatitjes të jetë i lartë, aq sa dhe vullneti i tyre për ruajtjen e paqes dhe garantimin e sigurisë për familjet e tyre dhe kombin në përgjithësi. Ne të gjithë duhet të jemi shumë krenarë për ta. Por të jesh krenar nuk mjafton. Duhet të kujtojmë se ata kanë nevojë për mbështetjen tonë", ka thënë Mehaj.

Ministri i Mbrojtjes ka pohuar se Qeveria e Republikës së Kosovës

përgjatë një viti ka investuar më shumë se çdoherë tjetër në avancimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës. "Ushtarakët tanë në vazhdimësi janë duke u pajisur me armatimet më moderne ushtarake, ndërsa oficerët e rinj po shkollohen në akademitë më të njohura botërore", ka deklaruar Mehaj.

Mehaj ka theksuar se mërgata, pronarët e bizneseve dhe qytetarët e thjeshtë të këtij vendi, shtresa e mesme e shoqërisë për nga të ardhurat, por e lartë nga atdhedashuria, gjithmonë ka qenë

mbështetja më e madhe për çfarëdo lëvizje në mbrojtje të atdheut. "Sot, gjersa kemi ushtrinë dhe Republikën, na duhet mbështetja juaj për ta konsoliduar Forcën e Sigurisë së Kosovës në nivelin e ushtrive anëtare të NATO-s, kështu vlerat demokratike të shtetit tonë mbrohen dhe jeta e çdo qytetari është e sigurt. Prandaj, ju ftoj të kontribuoni në Fondin e Sigurisë për interesat shtetërore, për forcën që do ta mbroj atdheun, do ta siguroj jetën tuaj dhe të ardhmen e fëmijëve", ka thënë ministri Mehaj.



Për një vit Kuvendi mbajti mbi 100 seanca parlamentare

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Kuvendi i Kosovës ka përmbyllur vitin 2022 me mbi 100 seanca të mbajtura, duke arritur të miratojë 111 projektligje, apo 69 % të projektligjeve të cilat i janë sjellë për shqyrtim.

Ndërsa 50 projektligje ende ndodhen në procedurë të shqyrtimit. Një ndër faktorët kryesorë që ka ndikuar në këtë performancë është shumica e konsoliduar parlamentare, e cila ka mundësuar numrat për kalimin e projektligjeve. Në aspektin përmbajtësor pjesa më e madhe e projektligjeve të miratuara i përkasin sektorit të bujqësisë dhe atij drejtësisë.

2022-a vlerësohet vit i kapitalizmit të iniciativave ligjore që ishin në pritje për t'u miratuar tash e shumë vjet. Pas një dekade kjo legjislaturë përfundimisht miratoi Rregulloren e re të Punës. Gjithsesi, efekti i saj nuk ishte i vërejtshëm në kuptim të planifikimit të punimeve të Kuvendit. Organizimi i punës së Kuvendit nuk u bë sipas një planifikimi të mirëfilltë e sistematik, gjë që rezultoi në stërngrkimin e seancave me numër të madh të projektligjeve, mospërfundimin e



seancave dhe mbajtjen e disa seancave brenda një dite. Po këtë vit u miratua edhe Projektligji për Financimin e Subjekteve Politike, që ishte në pritje të miratimit që nga viti 2018, i cili avancoi transparencën dhe llogaridhënien financiare të subjekteve politike.

Në mungesë të vendosjes së sanksioneve për mospjesëmarrje të deputetëve në seanca apo në proces të votimit, situatat ku deputetët munguan në seanca dhe votim kanë qenë shumë të shpeshta. Gjatë këtij viti janë evidentuar mbi 1 700 mungesa të deputetëve vetëm në seancat plenare dhe kjo ka bërë që seancat në disa raste të dështojnë në

mungesë të kuorumit. Numri i lartë i mungesave vjen edhe si rezultat i bojkotimit të punimeve të Kuvendit nga ana e deputetëve të Listës Serbe. Bojkotimi i punës së Kuvendit nga komunitetet joshumicë, përveç mungesave si të tilla, ka rezultuar edhe me paralizim të disa iniciativave tejet të rëndësishme ligjore për të cilat nevojiten votat e komuniteteve joshumicë. Në anën tjetër, përpos mungesave të deputetëve në seanca, në shumë raste aty munguan edhe anëtarët e kabinetit qeveritar.

Me një numër të madh të projektligjeve dhe temave të tjera në diskutim, debatet parlamentare

nuk munguan, por që ato shpesh ishin jocijësores dhe jashtë temës. Në përgjithësi subjekti politik në pushtet nuk ishte shumë i hapur për t'i reflektuar propozimet dhe amendamentet e opozitës lidhur me përmbajtjen e projektligjeve. Kjo rezultoi në disa raste me polarizime politike dhe mospjesëmarrje të opozitës në shqyrtimin e iniciativave ligjore. Madje, për pasojë, disa nga projektligjet e miratuara u sfiduan edhe paralajmërohen të sfidohen në Gjykatën Kushtetuese.

Administrimi i seancave është parë si një element pozitiv. Kryetari i Kuvendit ka luajtur një rol balancues në mes kërkesave të pozitës dhe opozitës, duke amortizuar kështu përplasjet në mes tyre. Përmirësime ka pasur edhe sa i përket gjuhës dhe sjelljeve parlamentare të deputetëve. Sidoqoftë, Kuvendi ka vijuar me problemin e mostransparencës sa iu përket votimeve meqë votimi ka vazhduar të bëhet me ngritje të dorës e jo përmes sistemit elektronik.

Në aspektin mbikëqyrës, Kuvendi vazhdon të ketë performancë të ulët. Në komisionet parlamentare vazhdon të ekzistojë një disproporcion i theksuar ndërmjet punës në shqyrtimin e ligjeve dhe

monitorimit të zbatimit të ligjeve, sidomos në aspekt të shqyrtimit të mirëfilltë të raporteve të performancës së agjencive të pavarura. Komisioni për Buxhet, Komisioni për Ekonomi dhe Komisioni për Legjislacion janë komisionet më të angazhuara përgjatë këtij viti, ndërsa përgjatë tërë vitit janë mbajtur 300 mbledhje të komisioneve.

Kuvendi gjatë këtij viti mori një rol të rëndësishëm në procesin e reformës në sektorin e drejtësisë, konkretisht në adresimin e procesit të vetingut në drejtësi dhe themelimit të Byrosë për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Për vetingun në fund të këtij viti u formua një Komision Ad-Hoc parlamentar, i cili do t'i shqyrtojë amendamentet kushtetuese dhe Projektligjin për vetingun. Këtu duhet vlerësuar pozitivisht vullneti politik i përbashkët mes pozitës dhe opozitës për të trajtuar këtë proces në mënyrë konsensuale. Ndërsa sa i përket Byrosë, me iniciativë të kryetarit të Kuvendit, projektligji është dërguar dy herë për opinion në Komisionin e Venecias. Fatkeqësisht, ky proces nuk është shoqëruar nga e njëjta frymë konsensuale sikur në rastin e vetingut.



Kosova po braktiset nga të rinjtë

- Vetëm vitin e kaluar nga Kosova u larguan mbi 42 mijë qytetarë

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Vit pas viti është duke u rritur numri i të rinjve që kanë synim të largohen nga Kosova pasi nuk shohin një të ardhme në vendin e tyre. Ikjet nga Kosova kanë vazhduar edhe në vitin e kaluar, por edhe në vitin 2022 edhe pse për këtë vit ende nuk ka ndonjë statistikë. Fjalimet për rritjen e pashembullt ekonomike nga pushtetarët e sotëm nuk e kanë ka zvogëluar dëshirën për largim. "Kosova është vend që ofron shumë pak mundësi për të rinjtë" - është fjalia përbashkuese e shumë të rinjve, që janë larguar ose janë në procedurë të jetuar e punuar në një vend tjetër nga ky që jetojnë. Se Kosova është duke u tkurrur demografikisht e ka pranuar publikisht edhe kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca në një tryezë të mbajtur më 15 nëntor, në të cilën është diskutuar perspektiva demografike e Kosovës. Ai është shprehur i shqetësuar me evoluimin negativ të të dhënave demografike të Kosovës.

Konjufca ka shpërfaqur shifra të frikshme të braktisjes së Kosovës nga banorët e vet, duke treguar se që prej vitit 1981 kur është bërë regjistrimi i popullatës e deri më sot, Kosova ka 400 mijë banorë më pak. "Të gjithë jemi të brengosur që ta zëmë në vitin kur kam lindur unë dhe sot, Kosova i ka 400 mijë banorë më pak. Kurse ne jemi vendi me natalitetin më të madh në Evropë. Kjo na tregon se çfarë ka ndodhur në të vërtetë. Kjo duhet të jetë në fokus të

mobilizimit të të gjitha institucioneve tona për të bërë një plan nacional dhe gjithëpërfshirës ashtu, pra po flas për vitin 1981 kur është bërë regjistrimi i fundit e kur Kosova ka pasur përafërsisht 2 milionë banorë dhe sot në vlerësime të përafërta thuhet të jetë diku 1.6 milion apo 1.7", ka theksuar Konjufca.

Konjufca ka thënë se po flet me këtë shqetësim, meqë s'duhet të vijë viti 2060 e të thuhet që trendi ka vazhduar dhe që Kosova ka rënë në 1.2 milionë banorë. Ai ka thënë se një gjë e tillë s'duhet të ndodhë.

Kosova po tkurret numerikisht dhe po mbetet gjithnjë e më më pak banorë. Ikja masovike e kosovarëve, ç'është e vërteta ka filluar shumë vite përpara, por zyrtarët e Kosovës, sikur e kanë neglizhuar këtë çështje duke e heshtur në të shumtën e rasteve, ose duke anashkaluar goxha lehtësisht fokusin e përqendrimin karshi problemit të rëndë dhe tashmë i bërë tronditës dhe me pasoja të shumanshme. Shifrat e mëhershme të bëra publike nga mediet për braktisjen e vendit nga pjesa më vitale e popullsisë dhe për tendencat e kosovarëve për të ikur një orë e më parë nga vendi dhe parashikimet se Kosova shumë shpejtë do të mbetet pa punëtorë të nevojshëm dhe të domosdoshëm në shumë veprimtari dhe lëmi të zhvillimit ekonomik, thjesht dukeshin të pabesueshme.

Siç është raportuar në medie disa herë, ka goxha do kohë dhe muaj

se të rinjtë janë duke u joshur në mënyrat më të ndryshme nga punëdhënësit jashtë vendit, agjencitë përkatëse dhe sekserët e angazhuar nga pronarë të pafund të kompanive e ndërmarrjeve nga këto shtete. Po ashtu kanë ardhur premtime legale dhe jo edhe aq legale, gjithnjë e më shumë për vende të mundshme të punës, për pagat shumëfish më të leverdishme se këto këtu në Kosovën e varfër, për kushtet e tjera komode dhe tërheqëse për kosovarët që me vjet kanë pritur për një vend pune, për një pagë dhe ca kushte modeste dinjitoze pune. Këto shtete kanë nevojë të madhe për punëtorë dhe për shumë profile, dhe si rrjedhojë, kriteret për përzgjedhjen e tyre, janë zbutur, madje edhe si të tilla, po përfillen dosido, sa për të thënë. Prandaj, shifrat për të ikur nga Kosova, siç e ka potencuar sot kreu i Kuvendit të Kosovës, duhet pranuar, po bëhen gjithnjë e më tronditëse dhe emigrimi vazhdon të mbetet njëri nga faktorët që ndikon më së shumti në tkurrjen e popullsisë së Kosovës.

Sipas Agjencisë së Statistikave (ASK) nga Kosova në vitin 2021 janë larguar mbi 42 mijë qytetarë. Kjo i bie, një qytet i tërë mesatar ka braktisur Kosovën vjet. "Emigrimi ndërkombëtar - numri i emigrantëve kosovarë gjatë vitit 2021 është vlerësuar të jetë gjithsej 42 mijë e 728 banorë përfshirë emigrantët legalë dhe ata ilegalë. Shtimi natyror në Kosovë në vitin 2021 ishte 14,391 banorë ndërsa migrimi neto 38,606 banorë.

Popullsia e Kosovës gjatë vitit 2021 u zvogëluar për 24,215 banorë", ka njoftuar ASK-ja në qershor të vitit 2022.

Këto shifra të ikanakëve potencial nga Kosova, gjithsesi nuk janë të vetmet, ka edhe më shumë numra të atyre që kanë ikur dhe duan të ikin, edhe ilegalisht, edhe nëpërmjet garancioneve që ua dërgojnë të afërmit gjithandej nga këto vende dhe të atyre që kanë viza të mëhershme dhe që vetëm përkohësisht janë kthyer në vendlindje. Statistikat zyrtare nuk përfshijnë të gjithë numrin e kosovarëve që braktisin vendin e tyre. Sepse, për shumë prej tyre, as që dihet se kanë ikur jashtë vendit. Ata ikën pa paralajmërime, ilegalisht dhe nëpër rrugë të ndryshme. Por e keqja e madhe bëhet nga braktisja e vendit nga truri, nga kosovarët e shkolluar dhe me profesione tepër të nevojshme për Kosovën e varfër. Dhe, ka kohë, mbase edhe disa vjet që "truri" i Kosovës po e braktis vendlindjen. Po lënë vendin edhe profesori, mjeku, inxhinierët, teknikët, punëtorë të shumtë të ndërtimtarisë, muratorë, latues, instalues prej më të ndryshmeve, gastronomë me diploma dhe pa to, dhe të tjerë profilesh të ndryshme. Infermierët e shumtë nga Kosova që ka vite që kanë ikur në vendet e ndryshme perëndimore në numër të madh, janë rrëfim i veçantë dhe si i tillë duhet trajtuar. Ka vite që dy universitete private në Kosovë kanë fakultete të infermierisë të licencuara dhe ato përgatisin

infermierë për tregun perëndimor të punës. Numri enorm i tyre është lehtësisht i verifikueshëm, pasi që janë të regjistruara legalisht në këto fakultete dhe për këtë domosdo duhet të ketë statistika. Por, e ardhmja sa i përket braktisjes së vendit nga "truri", pra nga kosovarët e shkolluar në vendin e tyre dhe për nevoja të këtij vendi, është edhe më e zymtë. Pleurat Sejdiu, kryetar i Odës së Mjekëve, ka thënë se brenda 5 vjetëve të ardhshme do të ndihet kriza e madhe e mjekëve. Sipas tij, vetëm në 4 vjetët e fundit Kosova ka humbur mbi 650 mjekë.

Ndërsa Sindikata e Punëtorëve Shëndetësorë të QKUK-së ka bërë me dije se në vitin 2023 në përgatitje për largim gjatë vitit 2023 janë edhe rreth 1 500 infermierë.

Duhet thënë se si punëtorët e profileve më pak të shkolluara, si ata që kanë shkollim të lartë, po e lënë Kosovën për një jetë më të mirë, më të dinjitetshme, për paga më të mira dhe për kushte pune më të favorshme.

Mbi 80 mijë të papunë janë të regjistruar në Agjencinë e Punësimit në Kosovë, por bizneset vazhdojnë tashmë të ankohen për mungesë të fuqisë punëtore. "Problemi i ikjes, sipas analizave, janë kushtet e punës dhe pagat e ulëta", kanë theksuar nga Agjencia e Punësimit të Kosovës.

Për çdo muaj në Kosovë aplikojnë mijëra persona për termine në ambasada të ndryshme, me ambasadën gjermane në Prishtinë që mbetet më e kërkuara.



“HEGJEMONËT DHE AUTOKRATËT KANË ZËNË PENG PAQEN”

Nga Dr. Edita TAHIRI,
ish-zëvendëskryeministre dhe kryenegociatore

Bota është udhëkryq! Nga një krizë në tjetrën shkoi ky vit, madje as gëzimi për shkuarjen e pandemisë globale nuk zgjati shumë. Zhvillime dramatike përshkuan pjesë të ndryshme të botës. Ngjarja më dramatike, lufta agresore e Rusisë kundër Ukrainës, që filloi në muajin shkurt solli pamje tmerruese të tragjedisë së luftërave shkatërrimtare të cilat ende nuk i kishim harruar nga luftërat e fundit në Ballkan dhe gjenocidi serb në Kosovë, Bosnjë e Hercegovinë dhe Kroaci. Kur përfunduam luftërat në rajonin tonë, me zhbërjen e ish-Jugosllavisë dhe lindjen e shteteve të reja përfshirë shtetin tone Kosovën, pak kemi besuar se aq shpejt do të shohim një luftë të re në kontinentin tonë. Ra iluzioni i paqes së përhershme, ra dhe teoria e ‘fundit të historisë’ që pra shkoi se supremacia e vlerave të demokracisë liberale dhe rënja e Bashkimit Sovjetik nuk krijon shkaqe për luftëra (siç pohonte Fukuyama), po ashtu u cenua besueshmëria se çdo 50 vjet ndodhin luftëra të mëdha/botërore. Bota nuk hyri në luftë botërore, por realisht bota është në mes luftës së Ukrainës dhe luftës së mundshme botërore. Debatit akademik ka për temë qendrore dilemën “ se a do të ketë apo nuk do të ketë luftë botërore, apo a do të ketë luftë nukleare ose më tej si të parandalohet lufta botërore?. Prej Kissingerit deri te Harvardit JOseph Nye, akademikë tjerë kanë shkruar dhe po vazhdojnë për këtë temë të rëndësishëm duke qenë se ardhmja është e paqartë dhe e pasigurt. Por çfarë ndodhi me botën pse dhe si erdhëm deri në këtë gjendje? Ku humbi rruga e botës? Ishim në një rrugë demokracie, si përfunduam në një rrugë plotë hegjemonë e autokratë. Si u braktisën vlerat e liberal demokracisë ndërsa nacionalizmi dhe populizmi dolën më agresiv duke rikthyer agjendat

hegjemoniste gjeopolitike që ishin menduar që i takonin të kaluarës.

Lufta gjeopolitike ruse në Ukrainë

Lufta agresore ruse në Ukrainë është Luftë gjeopolitike me qëllime për përfitime gjeopolitike, të ekspansionizmin rus në toka ukrainase, pas pushtimit të Krimesë dhe dy krahinave. Në fakt, Rusia asnjëherë nuk ndaloi aspiratat e saja hegjemoniste dhe asnjëherë nuk u pajtua me humbjen që pësoi me përfundimin e Luftës së ftohtë, pas rënies së ish-Bashkimit sovjetik. Jo vetëm me pretendime territoriale ndaj Ukrainës por madje deri në Ballkan dhe në kërkim të qasjes në detin Mesdhe përmes detit Adriatik. Synimet gjeopolitike të Rusisë gjatë luftës së Ukrainës nxorën në pah projekte gjeopolitike ruso-serbe të koduara me termet ‘bota ruse’ dhe ‘bota serbe’, që në thelb përkufizojnë ‘Serbinë e Madhe’ dhe ‘Rusinë e territoreve të ish-bashkimit sovjetik’. Doktrina gjeopolitike e Rusisë, ‘Euro-Asia’ e ka për qëllim të kundërvihet doktrinës gjeopolitike perëndimore të ‘Heart-Landit’. Pjesë thelbësore e së cilës është Ballkani (Evropa Juglindore), që thekson se [kush e kontrollon Evropën Juglindore e kontrollon botën. Kjo është arsyeja kryesore që Serbia shërben si “Kali i Trojës” së Rusisë në Ballkan që ka për mision të vazhdojë të përçojë ndikimin rus dhe kontrollin e Ballkanit. Për këtë arsye, analistë të njohur nuk e përjashtojnë mundësinë e zgjerimit të luftës së Ukrainës në Ballkan, për të cilën Serbia kujdeset ta mbaj tensionin lartë në rajonin tonë, sikur që ishin tensionet në veri të Kosovës për disa javë të dhjetorit. Mirëpo, një pengesë e madhe për aspiratat hegjemoniste ruse është perëndimi, SHBA dhe NATO nuk do të lejojnë realizimin e interesave gjeopolitike ruse në Ballkan, rrjedhimisht nuk do të lejojnë krijimin e “Serbisë së Madhe”.



Aktivizimi gjeopolitik i Perëndimit - zgjerimi drejt Ballkanit Perëndimor

Agjenda gjeopolitike kishte kohë që nuk zihet në gojë të politikanëve perëndimor, ndërsa BE-ja thellonte dilemat e zgjerimit drejt Ballkanit Perëndimor duke lënë atë si hapësirë të lirë për lojërat e Rusisë ku më vonë Kina hodhi hapa të saja dhe disa aktorë tjerë jo-perëndimor. Ndërkohë, Serbia e përkrahur nga Rusia dhe pothuajse e papenguar ndërhynte dhe destabilizonte shtetet në rajon, si Bosnjën, Kosovën, Malin e Zi, duke çuar para projektin e ‘Serbisë së Madhe’, me kërcënime të hapura për ta ndarë Republikën Serbe nga Bosnja dhe Hercegovina si dhe për ta ndarë pjesën veriore të Kosovës. Thirrjet e vendeve të Ballkanit perëndimor për integrimin në BE merrnin premtime verbale, pavarësisht se integrimi evropian konsiderohej si projekt paqësor në dobi të paqes në Ballkan por edhe në Evropë. Mirëpo, situata ndryshoi. Lufta e Rusisë kundër Ukrainës nxiti zgjimin gjeopolitik të perëndimit. Kishte ardhur koha që luftës gjeopolitike ruse perëndimi t’i përgjigjej me vendime gjeopolitike. zgjerimi i NATO-s dhe

BE-së drejt Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë ishte i domosdoshëm, përfshirë këtu në radhë të parë Kosovën dhe Bosnjën dhe Hercegovinën, Finlandën, Suedinë dhe Ukrainën, jo pa pengesa por që duhen përballuar, pavarësisht që Serbia refuzon NATO-n. Gjeopolitika pra zuri vendin e duhur në kokat e politikanëve evropian dhe euro-atlantik dhe në dokumenteve relevante. Angazhimi i shtuar i dyshes gjermano- franceze hapi dyert e zgjerimit të BE-së. Hapja e dyerve nuk u bë e plotë. U krijua një mekanizëm shtesë, frustrues, një dhomë pritje për anëtarësimin e vendeve aspirantë, e njohur si komuniteti politik evropian, krijesë franceze. Përkundër kësaj Zgjerimi do të jetë një forcë stimuluese për reformat evropiane të shteteve aspirantë, do të lëviz proceset drejt paqes, demokracisë, sundimin të ligjit duke i afruar me BE-në vendet aspirantë. Nga rezultatet e para janë, hapja e negociatave për anëtarësim për Shqipërinë, Maqedoninë veriore dhe së fundi statusi kandidat për Bosnjën, dhe liberalizimi i vizave për Kosovën që erdhi pas një dekade padrejtësie ndaj Kosovës dhe qytetarëve të saj. Po ashtu Kosova bëri aplikimin për anëtarësim në BE, pavarësisht sfidave që mund të dalin nga vendet mos-njohëse, ky proces ka rëndësi politike dhe gjeopolitike për Kosovën dhe vet Evropën. Por, partnerët perëndimor nuk arritën të detyrojnë Serbinë të heq dorë nga politika e sajë dualiste ‘edhe me Rusinë edhe Perëndimin, Serbia do të vazhdojë të jetë problemi dhe destabilizuesi i Ballkanit; do jetë në anën ruse dhe do marrë urdhërat e Putinit dhe në vazhdimësi do ta rrezikoj Ballkanin. BE-ja nuk është dhe nuk duhet ta toleroj ma Serbinë, duhet ta detyrojë të vendos sanksione kundër Rusisë, ose në të kundërtën të ndërpres negociatat për anëtarësimin e Serbisë në BE. Edhe ashtu BE-ja nuk e ka unitetin e plotë në politikë dhe jashtme nga vende mosnjohëse të pavarësisht së Kosovës, Derisa destruksionet e Serbisë vazhdojnë në Ballkan, ndërsa vet perëndimi ka mbetur në pozicion dualist ndaj Serbisë, herë duke e përkëdhelur dhe herë duke e ndëshkuar, nuk mund të presim politika efikase për paqen dhe sigurinë në rajonit siç ishte situata e tensionuar shpërthyes ne veri të Kosovës për gati tre javë gjatë dhjetorit. Një unitet dhe vendosmëri më e madhe nga BE-ja për zgjerim do ta bënte Ballkanin Perëndimor më stabil, kështu ringjallja e procesit të Berlinit dha rezultate, fuqizoi bashkëpunimin rajonal ndërsa nxori nga loja projektin hegjemon ruso-serb të njohur si ‘Ballkani i Hapur.’ BE por edhe NATO kanë mundësi të ngushtojnë hapësirën për tensione nacionaliste si dhe t’i ndalojnë ndërhyrjet hegjemon të Serbisë ndaj vendeve në rajon të frymëzuara dhe porositura nga Putini dhe agjenda gjeopolitike ruse.

Drejt paqes së qëndrueshme në Ballkan - plani franko-gjerman, njohja reciproke de jure dhe Traktati i Elysee-s

Një marrëveshje finale paqësore mes Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin amerikan dhe evropian duhet të arrihet sa më shpejt në mënyrë që të vendoset një paqe e qëndrueshme në Ballkan. Plani Franko-Gjerman nuk e ka njohjen reciproke mes dyja shteteve Kosovës dhe Serbisë, prandaj nuk duhet të pranohet. Një marrëveshje e pranueshme duhet të përfshijë njohjen reciproke direkte, de jure mes dyja shteteve , që përcakton fajësinë e Serbisë për luftën gjenocidale në Kosovë dhe obligimin për dëmshpërblimet për luftën ndaj Kosovës, sipas modelit të Traktatit të paqes mes Francës dhe Gjermanisë, e njohur si Traktati i Elysee-s, sipas së cilit Gjermania ka marrë përsipër fajësinë dhe dëmshpërblimet e luftës ndaj Francës. Një marrëveshje e tillë mund të sjellë një paqe të qëndrueshme në Ballkan dhe midis dyja shteteve. Kjo është e vetnja rrugë për të hapur kapitullin e paqes pas luftës dhe gjenocidit serb në Kosovë, në këtë mënyrë mbyllet kapitulli i armiqësisë mes Kosovës dhe Serbisë, madje dhe më gjerë mes shqiptarëve dhe Serbëve.

Hegjemonët dhe autokratët në rritje - paqja e zënë peng

Në planin politik, Lufta në Ukrainë është luftë kundër rendit aktual botëror, kundër perëndimit dhe kundër sistemit të liberal demokracisë. Me fjalë, tjera kjo është një luftë e Rusisë kundër perëndimit, respektivisht kundër fuqisë parësore dhe ndikimit amerikan. Ndonëse Putini e dinë se nuk mund të rikthejë Rusinë aty ku ëndërron, nuk do të ndalet së lufuari. Ndërkohë, Ballkani tashmë është një zonë e përplasjeve të sistemeve midis demokracive liberale dhe regjimeve autokratike. Putini në Rusi, Vuçiqi në Serbi janë autokratë dhe hegjemonë tipik që mbajnë njërën tjetrin mbi baza të errëta korruptive dhe kriminale. Por në zinxhirin e autokratëve është numër më i madh i liderëve në vende të ndryshme të botës, të cilët mbahen nga nacionalizmi, korrupsioni dhe hegjemonizmi. Të tillëve u interesojnë interesat e atyre të cilëve u shërbejnë, nuk pyesin për paqen as për popujt, ndërsa pa hezitim refuzojnë vlerat dhe interesat perëndimore dhe sistemet demokratike. Praktikisht, paqja është zënë peng nga të tillë. Derisa kriza në botë po rritet dhe po bëhet gjithnjë më komplekse. Bota ka nevojë për rishpikjen e një strategjie globale për zgjidhje paqësore dhe të qëndrueshme në botë . Duhet të bëhen ndryshime edhe në paradigmen ekzistuese të marrëdhënieve ndërkombëtare, duke fuqizuar idealizmin për paqen dhe prosperitetin, diplomacinë e paqes dhe lidershipin transformues që ka qëllime paqësore dhe idealiste.



NË VENDIN KU QENÇE JETOHET



Shkruan: Muharrem NITAJ

Në këtë vend, qençe do të jetohet e të gjithë do të duan me dalë prej tij por, edhe po e patët fatin me dalë, prapë qençe do të jetoni, gjithmonë e derisa të mos vendosni që vetë të udhëhiqni me veten tuaj.

Të jetosh në vendin që të ardhmen e ka të pasigurt, që bukën e ka me cikërr dhe që punën e ka të rëndë e të papaguar sa duhet, d.m.th ta jetosh Kosovën në vitin e mbrapshtë.

Kjo, në vendin ku politikanët, në masë jo të vogël, janë analfabetë e dallaveraxhi, e jo pak prej tyre hajdutë e sehirxhi, që parimet i ndërrojnë më shpesh se sa frymë

marrin, e ku të shohin në dritë të syrit e të rrejnë.

Në vendin ku presidentja është veç një grua e mire e ku kryeministri nuk është më shumë se sa një njeri i mirë, ku parlamenti është tempull I inatçinjve e ku gjysma e politikanëve punojnë veç për rrogë, e jo pak prej tyre "rrogat i kanë të vogla por të ardhurat e mëdha.

Ose ta jetosh Kosovën për një vit, është njëjtë sikur ta jetosh kohën e qoftëlargut, sepse në këtë vend edhe institucionet ku shërohet trupi e shpirti, ta fusin veremin e sëmundjen ta shesin me pare.

Kjo d.m.th ta jetosh në vendin ku

akademikët janë pleq pa mjekra, që shkruajnë fletërrufe e erë s'marrin nga shkenca, ku profesorët janë edhe plagjiatorë e ku rrogën nuk e kanë hallall. Ku studentët mësojnë e nuk studiojnë. Ku s'ka nevojë të kesh mbërri dije për një diplomë.

Ta jetosh Kosovën sot, d.m.th ta përjetosh vendin ku ambasadorët e huaj dinë më shumë se sa kryeministri, ku sa herë rrezikohet atdheu çohen peshë aradhat fashiste të rrjetëve sociale e ushtria e Facebook-ut.

Në vendin ku shumë nga tregtarët mbajnë mall të skaduar dhe kumbarinë e kanë veç me armiq,

ku shumë nga naftëtarët t'vjedhin në cilësi e në litër, ku asfalti shtrohet me hile, ku jo pak nga veteranët e vjedhin lavdinë, ku spiunët fshihen pas burgut, ku sa e sa gjyqtarë janë me parti, ku edhe jo pak besimtarë bëjnë zina e flasin në emër të Zotit.

Kjo d.m.th të jetosh në vendin nga ku të gjithë duan me dalë, e kurrkush nuk e bën as 'lavrën e minit' që Kosova të bëhet si ai vendi tjetër ku dojnë me shku.

Në këtë vend, qençe do të jetohet hala e deri sa kryeministrat të jenë me pahirë, derisa presidentja të mos jetë kukull, derisa intelektualët të mos jenë robër të rrogës së

pushtetit e politikanët të mos i kenë për gazdallarë...

Qençe do të jetohet në këtë vend, e edhe do të vdiset besa, derisa të mos kuptohet se në botën e lirë e pa pushtues, të flasësh do të thotë të jesh i lirë, të ekzistosh pa frikën e linçimit nga analfabetët me rrogë të Facebook-ut.

Në këtë vend qençe do të jetohet e të gjithë do të dojnë me dalë prej tij. por edhe po patët fat me dalë, prapë qençe do të jetoni, gjithmonë deri sa të mos vendosni vetë se kush do të udhëheqë me jetën tuaj! Vit për vit duke pritur një dever tjetër!

Gëzuar!

LIBRI I VETËM I INTELEKTUALËVE QË THOTË DIÇKA PËR UÇK-në

Vështrim për librin “USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS, vlerë kombëtare”, i lexuar në promovimin e tij më 16 dhjetor 2022 në Prishtinë



Muhamet MAVRAJ

Zonja dhe zotërinj,
Mirë se keni ardhë në këtë promovim!
Meqenëse mungojnë për arsye objektive dy referues tjerë (Bedri Islami e Shaban Sinani), do të ju marr më shumë kohë në këtë paraqitje.
Kemi para vetes një përmbledhje punimesh nga sesioni shkencor i mbajtur në Prishtinë më 7 mars 2022 dhe që e botoi Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Autorët e kumtesave janë studiues nga institucioni i lartpërmendur organizues, por edhe institucione të tjera sikundër janë Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Akademia Shqiptare e Arteve dhe e Shkencave, Universiteti i Prishtinës, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve i Shkupit, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Akademia e Sigurisë e Tiranës, Universiteti i Evropës Juglindore i Tetovës, Muzeu Historik Kombëtar, Instituti i Studimeve të Historisë Ushtarake dhe Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës. Autorët nga këto institucione mëtojnë të japin kontributet e tyre në vlerësimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në kontekstin aktual të trajtimit të luftës së saj dhe krerëve të saj nga institucionet dhe nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë. Kjo pikë e ka bërë paksa “politike” këtë nismë në krye të herës, prandaj kanë hezituuar ose kanë refuzuar të marrin pjesë në cilëndo mënyrë edhe disa nga institucionet dhe akademikët e njohur të Kosovës, qoftë si referues të sotëm, këtu, në këtë promovim para jush, apo qoftë në sesionin shkencor, por edhe qoftë si organizatorë. Nga këta “akademikë” është edhe ndonjë emër që dikur mendohej se nuk do të refuzonte, madje, ndonjëse

fillimisht pranoi, më pas u tërhoq dhe sot nuk është këtu me ne. Ia lëmë kohës dhe gjykimit vetjak të gjithsecilit këto refuzime të ndihmës simbolike në këtë kohë sfduese, kritike.
Përmbledhja e punimeve të këtij libri është heterogjene. Autorët trajtojnë shumë tema për UÇK-në dhe jo të gjithë trajtojnë ndonjë aspekt brenda punimeve të tyre për sa i përket të ashtuquajturës Gjykatë Speciale e Kosovës e shndërruar tashmë vetvetiu në sinonim të shkretërimit të vlerës së UÇK-së, karakterit të saj dhe misionit të saj. Për nga rëndësia e përfshirjes institucionale deri në prodhimin e këtij kontributi mbizotërojnë institucionet e Shqipërisë nëse e mendojmë përfshirjen e ASHA të Shqipërisë dhe jopjesëmarrjen e ASHA të Kosovës, që refuzoi. Kumtesat janë në numër më të lartë nga autorët të Shqipërisë administrative. Logjikisht, tematikat do të përfshijnë edhe rolin e Shqipërisë në krah të luftës për lirinë e Kosovës në dimensione të ndryshme. Që të gjitha kumtesat kanë rëndësinë e tyre. Rënditja në libër nuk duket sipas rëndësisë apo sipas një rendi tradicional (psh.sipas alfabetit), prandaj kumtesa e fundit në këtë libër nuk nënkupton fare rëndësinë më të paktë në krahasim me tjerat. Telegrafikisht, këta janë autorët dhe tematikat e tyre:


1. Mr. sc. Bedri ZYBERAJ, - *Ushtria Çlirimtare e Kosovës në tri kohë*, f.9;
2. Prof. dr. Paskal MILO, - *Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe Konferenca e Rambujesë*, f.23;
3. Akademik Pëllumb XHUPI, - *Rruga e nderit dhe e dinjitetit*, f.37;
4. Prof. dr. Ksenofon KRISAFI, - *Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe faktori ndërkombëtar*, f.41;
5. Prof. dr. Hysen MATOSHI, - *Ushtria Çlirimtare e Kosovës, aleate e NATO-s*, f.63,
6. Dr. Dorian KOÇI, - *Arkitektura e mundimshme e lirisë: roli udhëheqës i UÇK-së për krijimin e shtetit të Republikës së Kosovës*, f.67;
7. Prof. asoc. dr. Ardit BIDO, - *Organizimi i shtetit shqiptar për prijjen e refugjatëve nga Kosova*, f.77;
8. Prof. dr. Emin KABASHI, - *Përmasa kombëtare e luftës së UÇK-së*, f.81;
9. Prof. asoc. dr. Zaho GOLEMI, - *Drejtimi strategjik i luftës së madhe të një populli të vogël*, f.87;

10. Prof. dr. Lulëzim LAJÇI, - *Çështja e Kosovës dhe roli i diplomacisë ndërkombëtare në procesin e çlirimit të saj*, f.117;
11. Dr. Albert HITOALIAJ, - *Gjurmë të luftës së UÇK-së në arkivat amerikane*, f.133;
12. Prof. asoc. dr. Bernard ZOTAJ, - *Bazat dhe përgatitja e luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Shqipëri*, f.145;
13. Prof. asoc. dr. Marenglen KASMI, - *Ndihmesa e Ushtrisë Shqiptare në organizimin dhe përgatitjen e forcave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës*, f.153;
14. Prof. dr. Arben HOXHA, - *Ushtria Çlirimtare e Kosovës si masë e aftësive reflektive për bërje*, f.163;
15. Doc. dr. Minir ADEMI, - *Dëshmorët nga Maqedonia të rënë në luftën për çlirimin e Kosovës*, f.169;
16. Prof. dr. Sali BYTYÇI, - *Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në letërsi 191*;
17. Dr. Albulenë HALILI, - *Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe NATO-s, ndërmarrje e përbashkët çlirimtare*, f.207;
18. MA Ruzhdi PANXHA, - *Privimi i Arkivit të Kosovës nga e drejta për administrimin e dokumentacionit të Dhomat e Specializuara*, f.211;

19. Prof. dr. Adem ZEJNULLAHU, - *Ushtria Çlirimtare e Kosovës në këngët popullore*, f.217;
20. Prof. ass. dr. Skender ZHITIA, - *Organizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës*, f.223;
21. PhD (C) Miftar KURTI, - *Këmbimi i robërve të luftës mes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ushtrisë jugosllave*, f.233;
22. MA Emin SALLAHU, - *Ushtria Çlirimtare e Kosovës si domosdoshmëri e kohës*, f.249;
23. Prof. asoc. dr. Ardit BIDO, - *Fjalë përmbyllëse për sesionin shkencor*, f.255;
24. *Faksimile e Deklaratës e cila i parapriu sesionit shkencor.*

Zonja dhe zotërinj,
Edhe gjatë luftës, përveç luftës, kemi pas luftë kundër luftës, brenda dhe jashtë Kosovës, dhe luftë për luftën, brenda dhe jashtë Kosovës. Edhe pas luftës, po kështu: lufta për dhe kundër luftës çlirimtare në përmasa të ndryshme. Këto lufta kundër luftës kanë filluar si thashethënme dhe kanë përfunduar nëpër gjykata, deri në Hagë; janë konstituuar si propagandë zyrtare e ndonjë subjekti vendor qysh gjatë luftës, njëkohësisht e paralelisht nga dhe me shtetin serb, gjithmonë në

rrafshin e propagandës së zezë. Dimensioni tjetër i luftës kundër luftës është rrafshi politik i partive politike kundër luftës së UÇK-së, sipas parimit – me devizën *vetëm të vrarët në luftë janë të mirë, ndërsa të gjallët janë kriminelë të gjallë*. Për këtë devizë (metodë) janë përdorur disa personazhe dëshmorësh si pozitive, më gjysmë zëri, dhe me plot zë të gjithë të gjallët e UÇK-së si personazhe të errëta, jocivilizuese, që nuk kanë luftuar për liri, por për t’u pasuruar dhe për të vrarë shqiptarë. (Gjykimi më dënim pikërisht sot në Hagë, 16 dhjetor 2022, para dy orësh, kundër Sali Mustafës, i vjen në ndihmë kësaj lufte kundër luftës sonë për liri, tekstualisht!). Edhe Adem Jashari mbase sot do të ishte një nga figurat më të sulmuara dhe mbase-mbase në burg, nga iniciativat e po këtyre kundërshtarëve. Disa tonë artikuj gazetash dhe fjalimesh propaganduese janë prodhuar në Kosovë e në Shqipëri gjatë dhe pas luftës, dhe qindra e mijëra orë të humorit të zi anembanë rrjeteve sociale janë përhapur, parë e komentuar ashpërsisht, nga vetë shqiptarët. Për fat të keq, Kosova e tejmbushur me shërbime të



Libri “Ushtria Çlirimtare e Kosovës, vlerë kombëtare” është përmbledhje e 22 kumtesave dhe një fjale përmbyllëse që dolën nga sesioni shkencor “Ushtria Çlirimtare e Kosovës, vlerë kombëtare”, mbajtur më 7 mars 2022 në Prishtinë, organizuar nga Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë, Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Në fund të librit është bashkëlidhur një Rezolutë (Deklaratë) e tetë institucioneve shkencore e nënshkruar në vitin 2020.



huaja pas luftës dhe po kështu edhe sot, nuk ka mundur dhe nuk mundet t'i përballojë lehtë programet gjithsefarëshe që synuan dhe synojnë shkatërrimin e çdo përfytyrimi pozitiv për luftën çlirimtare të Kosovës, barazimin gradual të "krimeve" shqiptare me ato serbe, shpërlarjen e fytyrës së gjenocidit serb dhe nxitjen e njëfarë dhembshurie për bombardimin e Serbisë nga aleanca perëndimore ushtarake më 1999.

Dimensioni tjetër, tepër dëmtues, është ai i përdorimit të trupave civile e policore ndërkombëtare në përndjekje të ushtarëve të lirisë që nga dita e funksionalizimit të Administratës së OKB-së këtu (Unmik) e deri më sot në kohën e Gjykatës Speciale. Si gazetarë më ka rënë të intervistoj shpesh dëshmitarë të rrejshëm të përgatitur nga administrata e Unmikut dhe hetuesit e ish Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë, por jo edhe nga Gjykata e sotme Speciale e cila me vite para hapjes së vetë Gjykatës i ka strehuar nëpër botë.

Le të nënvizojmë këtu se asnjë pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk i është shmangur drejtësisë dhe shumica apo të gjithë, nëse kanë pasur kohë, janë dorëzuar vullnetarisht për burgosje e hetime. Ata nuk kanë ikur edhe kur e kanë ditur se do të arrestohen dhe janë përgjigjur e do të përgjigjen në çdo kohë. E njëjta ndodhi me këta të sotmit në Hagë.

Një valë e re dhe shumë agresive kundër Kosovës ka filluar në prag të shpalljes së aktgjyqimit favorizues të GJND-së për Kosovën dhe veçmas pas shpalljes publike më 22 korrik 2010. Furia ruso-serbe kundër drejtuesve të luftës çlirimtare ndoqi me forcë e vendosmëri dy binarë: atë të strukturës politike shqiptare shumë agresive kundër Ushtrisë Çlirimtare, madje më shumë sesa dikur ish partia dominuese gjatë luftës dhe, binarin tjetër, nga jashtë, - me montimin monstruoz të Raportit të D.Martit, për fat të keq nën

siglën e Këshillit të Evropës ku Kosova nuk ishte dhe nuk është anëtare, pra nuk kishte zërin e saj brenda. Këta dy binarë do të pikëtakohen në vitin 2019 dhe do të përputhen e funksionalizohen plotësisht në vitin 2020 me pasojë rikonfigurimin e skenës politike të Kosovës. Së këndejmi, Gjykata Speciale shfaqet si parti speciale, *parti politike speciale*, që ndikon madje edhe në pengimin e fluturimit për në Uashington në ditën dhe datën konkrete, kur edhe shpallet qëllimi i saj për të akuzuar Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, pa i kryer hetimet dhe pa ngritur aktin e akuzës. Më vonë në aktakuzë shpërfaqet qëllimi i vërtetë: paraqitja e UÇK-së së djeshme, pikërisht ajo UÇK që ishte aleate e NATO-s, në një "ndërmarrje të përbashkët kriminale", që nga koka e saj. Padrejtësitë ndaj anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm vazhdojnë për më shumë se dy vjet duke iu rrëzuar çdo kërkesë, çfarëdo, dhe duke iu mohuar të drejtat e tyre si palë, tashmë krejtësisht e pabarabartë përballë prokurorisë speciale, -tërsisist nën kontrollin serb, ndonëse paguhet shtrenjtë nga fondet e Bashkimit Evropian.

Një drejtues i një institucioni shkencor ka refuzuar të jetë nënshkruar a pjesëmarrës në sesion me arsyetimin se "ata vetë e kanë votuar Gjykatën...". Unë i kam vizituar krerët e UÇK-së në Hagë dhe shpresoj t'i vizitoj përsëri nëse nuk lirohen. E kam pyetur Hashim Thaçin nëse ka ndonjë mëdyshje për formimin e Gjykatës Speciale, mbas gjithë këtyre aktiviteteve të padrejta të saj ndaj tij, anëtarëve tjerë dhe ndaj popullit të Kosovës. Jo, më ka thënë, *pavarësisht çfarë na priste në jetën personale, ose duhej dhënë nderin SHBA-ve në Kosovë për formimin e Gjykatës, ose Ruisë në Këshillin e Sigurimit, ndërkohë që pasojat për Kosovën do të ishin më të rënda*.

Zonja dhe zotërinj,

Të burgosurit e sotëm në Hagë, a kanë kërkuar diçka nga Kosova? - Asgjë! Kur dhanë dorëheqjet e tyre, Thaçi kërkoi që as të mos



protesohet kundër burgosjes, pra kundër Gjykatës Speciale, dhe as të manifestohej në përkrahje të tyre. Asnjë barrë nuk ia lanë Kosovës për fatet e tyre personale, që kulmuan me eliminimin e tyre nga skena publike dhe politike dhe burgosjen prapa nëntë drynave në Hagë. Sigurisht që ata nuk e kanë kërkuar as sesionin shkencor për UÇK-në, as këtë përmbledhje me kumtesa, as këtë promovim të sotëm dhe as këtë fjalë që po e paraqes para jush dhe as ardhjen tuaj të respektuar, sot dhe këtu! Dhe, as nuk pres që do të kërkojnë diçka nga ndokush. Lufta çlirimtare dhe tërë ajo që ata bënë i përket tashmë Kosovës, popullit të saj, shoqërisë civile, partive politike, studentëve e profesorëve, qytetarëve të fshatrave, të qyteteve anembanë trojeve shqiptare dhe shqiptarëve në mërgim. Dhe, çfarë ata bënë? Çfarë bënë ata që janë në Hagë e çfarë i lanë Kosovës?

Miq,

Përtej retorikave patetike, në themele mbesin disa fakte absolutisht të pakontestueshme. Çlirimtarët e Kosovës bartën mbi supe tjetër fat nga ata të kombeve tjera, dhe fat shumë të ndryshëm sot përballë rusëve nga ukrainasit e sotëm trima. Ukrainasit e kanë

shtetin e tyre të mirëfilltë dhe ushtrinë e tyre shumë dekada para se të hyjnë në luftë me rusët. Anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, - strategët e lirisë, gjeneratat inspiruese të tyre, të inspiruarit dhe përkrahësit e tyre kishin më shumë detyra sesa çlirimtarët e kombeve tjera:

1-Të rezistonin në mënyrat që u kushtonin me lëçitje famiuljare e fafeshnore, me burgje e vrasje në torturë ose me plumb;

2-Nga asgjëja të krijonin celulata e para të armatosura e tutje formimin e Ushtrisë Çlirimtare nën kushtet e okupimit total, 100 vjeçar, dhe integrimin e celulare të armatosura nën një kupolë, gjithmonë në kohën kur në Kosovë ishte ngritur një mit i ri për një lider tjetër që herë pas here bënte akuza çorientuese, njollosëse, të pamatura për fat të keq;

3-Të luftonin duke qenë mijëra herë përballë vdekjes;

4-Të ruanin frymën perëndimore dhe të refuzonin çfarëdo tentative për ngjyrosje çfarëdo të luftës çlirimtare;

5-Të udhëhiqnin përballë presionesh të rënda Kosovën në konferencë ndërkombëtare;

6-Të çlironin Kosovën;

7- Të krijonin kushtet për shpalljen e shtetit;

8-Të shpallnin shtetin dhe ta afirmonin atë;

9-Të mbronin dhe të fitonin betejën juridike për Kosovën në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë;

10-Të duronin poshtërimin e burgjet tjera pas gjithë këtyre kryeveprave, siç ndodhi e po ndodh sistematikisht, që nga dita e parë e çlirimt, në qershor 1999 e deri më sot.

Këta njerëz nuk ishin jashtëtokësorë, por vetëm disa prej nesh, nga rrethi ynë, nga radhët e kombit shqiptar, njerëz fare të thjeshtë, por shumë këmbëngulës, kur është koha për këmbëngulje.

Nën udhëheqjen e tyre Kosova i ka siguruar 116 njohje ndërkombëtare dhe numri ka ngelë aty ku e kanë lënë; Kosova është anëtarësuar në disa organizata të specializuara të

OKB-së dhe në një mori organizatash tjera, përfshirë edhe ato me famë sportive dhe numri i anëtarësimeve ka ngelë aty ku e kanë lëna ata! Asnjë njohje ndërkombëtare dhe asnjë anëtarësim i Kosovës nuk është arritur nën udhëheqjen kundërshtare të luftëtarëve të lirisë që sot janë në Hagë, ndërkohë që janë përkeqësuar e ftohur raportet madje edhe me Shqipërinë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Njëkohësisht, nuk ka pushuar retorika negative kundër tyre nga krerët e sotëm të shtetit mu në ftohet shtetërore, siç është ajo e Kuvendit të Kosovës, rregullisht, sistematikisht nga të dy shtyllat kryesore të pushtetit të sotëm, nga qeveritarët e nga ligjvënësit e tyre, por edhe e para e shtetit. Është po ajo retorikë që nxiti vrasjen e tyre morale para burgosjes, vrasje morale paraprijëse ashtu që burgosja e tyre të përjetohej si çlirim i ri. Natyrisht, ata që mungojnë sot në këtë promovim, bëjnë sesione tjera, por kundër!

Të kthehemi te punimet e përfshira në libër

Për sa i përket ngritjes së UÇK-së, fazave të saj, strukturimit dhe zhvillimit janë me interes në këtë libër punimet e Bedri ZYBERAJT "Ushtria Çlirimtare e Kosovës në tri kohë", te Dr. Dorian KOÇI, - "Arkitektura e mundimshme e lirisë: roli udhëheqës i UÇK-së për krijimin e shtetit të Republikës së Kosovës" dhe të Prof. ass. dr. Skender ZHITIA, "Organizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës".

Për sa i përket rolit konkret të Shqipërisë në terren në përgatitjen e UÇK-së, disa shtjellime gjinden në punimet e Prof. asoc. dr. Bernard ZOTAJ, "Bazat dhe përgatitja e luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Shqipëri" dhe Prof. asoc. dr. Marenglen KASMI, "Ndihmesa e Ushtrisë Shqiptare në organizimin dhe përgatitjen e forcave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës".

Për sa i përket prejës së Gjykatës Speciale si një habi kundër një lufte çlirimtare dhe faktorit



ndërkombëtar, vlejné për vëmendje punimet e Prof. dr. Ksenofon KRISAFIT, “Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe faktori ndërkombëtar”; Dr. Dorian KOÇI, “Arkitektura e mundimshme e lirisë: roli udhëheqës i UÇK-së për krijimin e shtetit të Republikës së Kosovës”; Prof. asoc. dr. Zaho GOLEMI, “Drejtimi strategjik i luftës së madhe të një populli të vogël”; Prof. dr. Arben HOXHA, “Ushtria Çlirimtare e Kosovës si masë e aftësive reflektive për bërje”, pastaj punimet e sipërpërmendura të Zyberajt dhe Panxhës dhe para së gjithash, punimi shumë serioz në pikëpamje akademike i Paskal Milos, “Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe Konferenca e Rambujesë”.

Autori Ruzhdi PANXHA në punimin e tij “Privimi i Arkivit të Kosovës nga e drejta për administrimin e dokumentacionit të Dhomave të Specializuara” ka ngritur një çështje konkrete duke prekur vetëm një pikë të Gjykatës Speciale, por që, personalisht mendoj, mund ta sfidojë seriozisht këtë gjykatë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës nëse gjindet vullneti i domosdoshëm për të ngritur pyetje para Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Agjensia Shtetërore e Arkivave e Kosovës ka në themel konventat, kartat, ligjet, standardet dhe praktikat ndërkombëtare të Këshillit Ndërkombëtar të Arkivave (KNA) pranë UNESKOS me seli në Paris, pasi që nga viti 2005 është anëtare me të drejta të plota në kategorinë “A” pranë këtij mekanizmi arkivor ndërkombëtar, siç përkujton Panxha. Me Ligjin nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Agjensia e Arkivave privohet nga e drejta e posedimit dhe dhënies për shfrytëzim të një pjese të materialit arkivor, të cilin do ta krijojnë Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar, që janë institucione të Kosovës dhe, rrjedhimisht, dokumentacioni që prodhojnë ato duhet të jetë i Kosovës, i administruar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Si përfundim, Panxha i kërkon Kuvendit të Kosovës rishikimin e dy neneve përkitazi me materialet arkivore të asaj gjykate, prokurorisë dhe administratës së saj.

Prof. dr. Lulëzim LAJÇI në punimin “Çështja e Kosovës dhe roli i diplomacisë ndërkombëtare në procesin e çlirimit të saj”, me retrospektivë gjithëpërfshirëse, kronologji analitike dhe argumentuese të rrjedhave që sollën intervenimin ndërkombëtar të armatosur i qaset periudhës pas Luftës së Dytë Botërore. Një përshkrim telegrafik të rrjedhave e bën edhe autori Emin Sallah në kumtesën “Ushtria Çlirimtare e Kosovës si domosdoshmëri e kohës”.

Në vështrimin e Albulena HALILIT “Lufta e Ushtrisë

Çlirimtare të Kosovës dhe NATO-s, ndërmarrje e përbashkët çlirimtare”, nuk është polemikë me stëlmën e Gjykatës Speciale në Hagë për “ndërmarrjen e përbashkët kriminale”, por zbërthim konceptual i vetë termave të ngushtë ku pasqyrohet aleanca e heshtur ndërmjet UÇK-së dhe NATO-s si dhe intervenimi i NATO-s si testim për të ardhmen e vetë NATO-s pikërisht në 50 vjetorin e saj pas shqyrtimit të konceptit strategjik dhe drejtimit të NATO-s në mijëvjeçarin e ri, pra shekullin XXI. Këtë temë e thellon dhe shpjen më tej Hysen MATOSHI me tezën e tij se “ishte tërësisht e pakuptimtë të pritej që NATO ta trajtonte seriozisht çështjen e Kosovës dhe aq më pak që ta konsideronte Kosovën për aleate të saj në kohën kur Kosova s’kishte ushtri, përkatësisht një forcë të caktuar ushtarake. Në këtë kuptim Ushtria Çlirimtare e Kosovës përbën një kusht të domosdoshëm”.

Zbërthim filozofik të lirisë bën autori Arben HOXHA dhe përplasje me satanizimin që i bëhet UÇK-së edhe nga vetë shqiptarët. Është ndër komparacionet më interesante ajo e shfaqjes së Gjykatës Speciale si simptomë e mungesës së “rendit” të shoqërisë botërore. “Gjykata e Nurembergut me moralin e të drejtës kolektive, si një entitet konkret historik, do të vihet në funksion të lirisë, sigurisë dhe mirëqenies së njerëzimit. Duke u bazuar në të drejtën pozitive dhe duke e përjashtuar prej saj çfarëdo lloj mundësie implikimi të së drejtës morale në të, Gjykata Speciale në Hagë do ta trajtojë barabarësisht si pushtuesin ashtu edhe të pushtuarin; si ushtruesin e gjenocidit ashtu edhe atë që ka pësuar nga gjenocidi”.

Edhe kënga është medium i rëndësishëm i shpjegimit të ngjarjeve dhe domethënies. Prof. dr. Adem ZEJNULLAHU në kumtesën “Ushtria lirimtare e Kosovës në kngt popullore”. “Emri i Adem Jasharit, lufta e tij dhe e UÇK-së, jehoi fuqishëm në gjithë hapësirat shqiptare dhe më gjerë. Ajo frymëzoi rapsodët popullore, poetët, shkrimtarët, piktorët, skulptorët dhe të tjerët për të krijuar vepra me vlera të mëdha përmbajtësore dhe artistike”, shkruan Zejnullahu i cili konstaton se rapsodët madhërojnë luftën çlirimtare duke iu larguar traditës së këndimit. Kjo luftë çlirimtare u pranua me vështirësi në krye të herës nga vetë shqiptarët, për arsye të mbizotërimit të diskursve tjera më joshëse, prandaj me përplot vështirësi merr përmasën kombëtare. Për këtë natyrë vështrimi shquhet këtu punimi i Emin KABASHIT “Përmasa kombëtare e luftës së UÇK-së”.

Sali BYTYÇI, përkujton se përgjatë historisë njerëzore lufta është burim (material) për historinë dhe letërsinë, dhe



historia si ruajtëse e kujtesës së jashtme, e letërsia si ruajtëse të kujtesës së brendshme për luftërat. Bytyçi thotë se “janë shkruar libra për luftën e UÇK-së, por jo pak të tilla që janë fokusuar kundër luftës së UÇK-së, në shërbim të njollësjes së kësaj lufte dhe në një vijë me akuzat e Serbisë ndaj UÇK-së, të cilat në fund kanë rezultuar me ngritjen dhe aktivizimin e Gjykatës Speciale në Hagë”. Më tej, i njëjti autor përvijon të argumentojë tezën e tij se në Kosovë bëhet edhe përjashtimi historik i proverbës stereotipe që thoshte se pas luftës historinë e shkruan fituesi. E shkruan, në fakt, sipas argumentimit të Bytyçit, politika humbëse, ashtu siç i volitet kësaj politike, që, për interesa të saj thërret përforsime edhe nga jashtë, siç ka bërë me O.Shmitin. Ky historian zvicëran interpreton deri edhe në “fshatarë” e “intelektualë” çiftin dihotimik, luftën çlirimtare, si një version të luftës sonë, dhe politikën pacifiste, si version të tejkualuar nga e para. Këtë binom të historisë së re të Kosovës, Shmiti e konstruktin si çift antonimik, fshatarë-intelektualë (elitë qytetare). Kjo politikë e humbësve, apo “vija e ashtuquajtur paqësore, e cila për një dekadë nuk arriti të lëvizë as edhe një kashtë përpara në politikën e Kosovës, që dy dekada me radhë e shkruajnë historinë e Kosovës”. Ky autor ka të drejtë: në librat shkollorë është plasuar një histori tjetër, ndërsa në librat më të rinj ka hyrë edhe kryetarja aktuale e shtetit si model suksesi! Ata që janë në Hagë nuk ekzistojnë. Ndërsa, “elita qytetare”, përveç të tjerash, fjalën e vet për luftën e UÇK-së e tha vetvetiu duke e bërë Schmitin anëtar të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, thotë Bytyçi, në shenjë solidarizimi me të për konkluzionet e tij për këtë luftë. Në planin e letërsisë, “Lufta e UÇK-së jo vetëm që nuk ka zënë vendin e merituar në letërsinë shqipe pas përfundimit të saj në qershor të vitit 1999 kur, me ndihmën e NATO-s, regjimi

shtypës i Millosheviqit së bashku me makinerinë e tij u detyrua të lëshonte Kosovën, po kjo luftë në letërsi edhe është stigmatizuar, duke i dhënë ngjyra kriminale, nga shkrimtarë të cilët karrierën e tyre e kanë krijuar në Jugosllavinë socialiste, para rënies së Murit të Berlinit.” (Bytyçi).

Akademik Pëllumb XHUFIT në kumtesën “Rruga e nderit dhe e dinjitetit” jep premisat e UÇK-së (shpërthimet e mëparme të paarmatosura në Kosovë) dhe holokaustin e Jasharëve si premisë të lirisë dhe dinjitetit. Bedri ZYBERAJ e vështron UÇK-në si realitet ushtarako-politik në tri faza: atë të krijimit (para luftës frontale), pastaj gjatë luftës efektive deri në Marrëveshjen e Kumanovës (qershor 1999) dhe fazën e transformimit pas luftës (1999-2009)-periudha e TMK-së. “Nëse për demonstratat e vitit 1981 mund të thuhet se nxorën në skenë çështjen e pazgjidhur të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, UÇK-ja me luftën e saj imponoi domosdonë e zgjidhjes së një pjese të kësaj çështjeje, atë të Kosovës”, thotë ai. Zyberaj shtjellon padrejtësinë dhe absurdin e imponimit që iu bë Kosovës për formimin e të ashtuquajturës Gjykatës Speciale e Kosovës në Hagë. Më tej, si drejtues i arkivave të Kosovës, merr fokusim në nenin 62 të ligjit themelues të kësaj gjykate, formalisht e Kosovës, por që shprehimisht thekson (neni 62) se “dokumentet, letrat, të dhënat dhe arkivat e Dhomave të Specializuara, Zyrës së Regjistrimit dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar nuk konsiderohen dokumente publike të Kosovës. E drejta e përgjithshme për të pasur qasje në të dhënat apo arkivat e Dhomave të Specializuara, përfshirë të Zyrës së Regjistrimit dhe të Zyrës së Prokurorit të specializuar, nuk ekziston”. Këtu konsiston ideja e Zyberajt që tetë institucione shkencore shqiptare të harmonizojnë një Deklaratë (e publikuar më 25 nëntor 2020) ku adresohen shqetësimet konkrete që i prodhon ligji themelues i Gjykatës. Zyberaj kreu detyrën që ia parashtrroi ndërgjegjia e detyrës

zyrtare. Mbase duhet të përçohet më tej ajo Deklaratë dhe të kanalizohet ankesa e saj.

Nuk ka dyshim se ndër kontributet më të rëndësishme me kumtueshmëri janë punimet Paskal MILOS “Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe Konferenca e Rambujesë” dhe Ksenofon KRISAFIT “Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe faktori ndërkombëtar”. Milo e argumenton përputhjen e rrallë që sjell historia ndërmjet interesave kombëtare dhe atyre ndërkombëtare dhe Rambuje është ai moment. Punimi i Milos është i patejkalueshëm për studimin e Konferencës së Rambujesë. Ndër të tjera argumentohet rezistenca e UÇK-së, konkretisht e Thaçit për të nxjerrë maksimumin e të mundshmes nga ajo konferencë. “Në parim, fitorja e UÇK-së dhe disfata e regjimit të Millosheviqit u vendosën në Rambuje (...) Rambujeja dhe UÇK-ja ishin binomi që garantoj suksesin diplomatik e politik, themeli i luftës që çoi në çlirimin e Kosovës dhe në pavarësinë e saj. Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë më 24 mars 1999, lufta e UÇK-së e rezistenca e të gjithë shqiptarëve deri më 9 qershor, ditën e nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës që shënoi fundin e sundimit serbo-jugosllav, i kapërceu vendimet dhe vetë Marrëveshjen e Rambujesë”, shkruan Milo. Korniza analitike e Milos mbështetet në dy pohime, në fakt aksioma, të cilat i mbështes plotësisht:

1- Pa rolin udhëheqës të Shteteve të Bashkuara dhe ndërhyrjen e NATO-s, në mars - qershor 1999, Kosova nuk e fitonte lirinë.


2- “Pa rezistencën e gjithanshme të shqiptarëve të Kosovës dhe luftën kryengritëse të Ushtrisë Çlirimtare liria e pavarësia e saj do të mbetej një objektiv i bukur, fisnik, frymëzues, por i paarritur. Liria nuk dhurohet, por fitohet”.

Ky është libri i vetëm i intelektualëve që bën diçka për UÇK-në pas fushatës drakonike të Gjykatës Speciale me seli në Hagë.

Ju faleminderit për durimin dhe kureshtjen!



MBËSHTETJE PLEBISHITARE PËR SIMBOLIN E GJENOCIDIT NË KOSOVË!



“Epoka e re”

Në përfundim të këtij viti, vlen të përmendet kërkesa e Qendrës “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur” drejtuar institucioneve shtetërore të Kosovës dhe forcave politike të vendit që të përcaktohet lulëkuqja me katër petale si simbol unik i përkujtimit të viktimave të gjenocidit.

Që nga data 16 nëntor 2022 kur u bë publike kjo iniciativë, mbështetja është rritur vazhdimisht. Sot, pas një muaj e gjysmë mund të themi se çështja e lulëkuqes me katër petale ka marrë përmasa gjithëkombëtare duke u bazuar në faktet se në mbështetje të kësaj kërkesë kanë dalë:

- Shkrimtarë të shquar nga Shqipëria, Kosova dhe anekënd botës: Besnik Mustafaj, Bedri Islami, Virion Graçi, Namik Dokle, Adem Gashi, Mustafë Xhemajli, Flora Brovina, Muhamet Mavraj, Diçe Lohaj,

Sadri Ramabaja, Besnik Camaj, Isuf Sherifi, Vaxhid Sejdiu etj;

- Profesorë universitarë të artit dhe artistë të shquar shqiptarë: Kastriot Tusha, Ilir Shaqiri, Hivzi Muharremi, Blerim Grubi, Genc Prelvukaj, Hysni Klinaku, ELITA 5 etj;

- Personalitete të shquara kombëtare: Ekrem Bardha, një ndër figurat më domethënëse të lëvizjes atdhetare në Shtetet e Bashkuara, drejtues i njohur dhe mbështetës i fuqishëm i Lirisë dhe Pavarësisë së Kosovës, i pari që ka folur para Kongresit Amerikan në emër të mërgimtarëve shqiptarë në Amerikë, atdhetari, ndoshta i vetmi që në jetën e tij politike është takuar me 7 presidentë të SHBA-së;

- Akademiku Rexhep Qosja, i cili në vazhdimësi ka qenë zëri i “Popullit të ndaluar”;

- Zonja Vasfije Krasniqi Goodman- Njëra nga viktimat e mbijetuarat të gjenocidit, e cila me dëshmitë e veta tronditi Senatin dhe Kongresin amerikan

dhe disa institucione të shteteve të BE-së

- Ekrem Jashari, djalë i heroit të kombit, Sherif Jashari nga Prekazi;

- Shkëlqim Millaku, profesor në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren, i biri i dëshmorit Hazir Millaku.

- Saime Isufi, veprimtare e shquar e çështjes kombëtare, bashkëshorte e Kadri Zekës dhe bashkëveprimtare e Jusuf e Bardhosh Gërvallës;

- Shukrie Ramadani, veprimtare dhe bashkëshorte e heroit të kombit, Agim Ramadani;

- Mjekë: Shqiptar Adem Demaçi, Xhemajl Selmani, Naim Uka, Musa Gashi etj;

- Afrim Hoti profesor universitar i lëndës Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe e Drejta ndërkombëtare;

- Diplomati Flamur Gashi;

- Lidhja e Historianëve të Kosovës, Instituti i historisë, Federata Pan-Shqiptare e Amerikës VATRA, Shoqata VATRA Queens nga Amerika, Federata e

Paqes Universale për Kosovë, solidarizohet me kërkesën që lulëkuqja të bëhet simbol i gjenocidit në Kosovë, Fondacioni “Hasan Prishtina” në Kosovë, Shoqëria Shqiptare ILIRIA në Lyon të Francës, Shoqata “Mëmëdheu” në Zvicër etj;

- Kuvendet komunale: Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë, Gjakovë, Vushtrri, Deçan, Skenderaj, Shtime, Kaçanik, Hani i Elezit, Viti, Rahovec dhe në rend të ditës e kanë edhe disa komuna të tjera.

- Nëpërmjet rrjetit social “Facebook” dhe intervistave apo formave të tjera të komunikimit kanë shprehur mbështetjen e tyre edhe deputetë të Kuvendit të Kosovës nga të gjitha partitë politike, ministra të Qeverisë së Kosovës;

- Redaksia e gazetës “Epoka e re” në Prishtinë dhe Redaksia e gazetës “Dielli” në New York të SHBA-së.

Përveç mbështetjes nga shqiptarët e katër anëve të globit, iniciativa për të pasur lulëkuqen

si simbol të viktimave të gjenocidit u mbështet edhe nga:

- Regjisori dhe aktivisti norvegjez e të drejtave të njeriut, Maria Fugleavaag Warsinska-Varsi, e cila ka qenë e angazhuar në ekipet që hulumtuan dhe dokumentuan krimet edhe në Kosovë, në vitin 1999;

- Hulumtues shkencor, juristi, filozofi dhe shkrimtari danez Niels Henrik Hooge,, i cili në kohën kur Serbia kishte vënë në funksion të gjitha aparatet e dhunës për të zbatuar politikën e gjenocidit në Kosovë, la luksin e Danimarkës, erdhi në Kosovë dhe iu bashkëngjiti luftës çlirimtare të UÇK-së.

Me një fjalë, kërkesa që lulëkuqja me katër petale të bëhet simbol unik i përkujtimit të viktimave të gjenocidit ka gjetur një përkrahje plebishitare. Urojmë që më 15 janar, në Ditën e Gjenocidit në Kosovë, ky simbol të jetë simboli unik që përkujton viktimat e gjenocidit që shkaktoi Serbia ndaj shqiptarëve të Kosovës.

VITI 2022, VIT I GURTHEMELIT PËR SHTATOREN E TRIBUNIT TË KOMBIT RAMIZ CERNICA NË GJILAN



Shkruan: Ismet SYLEJMANI

Data 25 Nëntor 2022 do të mbahet mend dhe do të jetë e shënuar në memorien e kombit tonë si ngjarja e vendosjes së gurthemelit për shtatoren e deputetit të popullit shqiptar, Tribunit të Kombit Ramiz Cernica!

Në Gjilan u vendos gurthemeli i atij burrit të madh të truallit tonë, i cili morri pjesë në Prizren, saktësisht më 8,9 dhe 10 Korrik 1945, në Kuvendin e parë të Kosovës, ku me shumicë votash, vendosi padrejtësisht dhe në kundërshtim të hapur me dëshirën e popullit shqiptar, mbetjen e Kosovës nën Serbi!

Në atë Kuvend të madh antishqiptar të Prizrenit, figura që më shumti shkëlqeu si dikur biri i madh i krahinës liridashëse të Atdheut, frashërliliu i famshëm i Dangëllisë, patrioti e ideologu shqiptar Abdyl Frashëri, ishte deputeti ynë i lavdishëm, trim e i papërkulur, Tribuni i Kombit Ramiz Cernica!

Tribuni i Kombit Ramiz Cernica, me aktin e Tij që manifestoi në Kryeqytetin shpirtëror të Kombit në Prizren, i tregoi gjithë botës se ishte një nga bijtë më besnik të popullit dhe Atdheut!

Shqiptari i madh Ramiz Cernica, me qëndrimin e Tij, 100% në interesa të vendit të tij, dëshmoi se ishte pasardhës i denjë i Hasan Prishtinës e i qindra dhe mijëra patriotëve e luftëtarëve të dëshmuar të kombit!

Tribuni i Kombit Ramiz Cernica, as nuk u lig, as nuk u dorëzua sikur disa deputetët të tjerë, por edhe as nuk u frikësua dhe as nuk e uli kokën, por u ngrit si vigan i palëkundur, dhe kundërshtoi publikisht para deputetëve pushtues serb dhe para atyre deputetëve tradhtarë shqiptarë, duke deklaruar botërisht se Kosova duhet të shkojë me Shqipërinë dhe Jo siç votuan ata që të shkojë me Serbinë!

Që nga ajo kohë e largët e deri më sot, Tribuni i Kombit Ramiz Cernica, u shndërrua në figurën më të dashur dhe më të respektuar në tërë hapësirën e geografisë shqiptare!

Që nga viti 1945, kur shqiptari i madh Ramiz Cernica e kundërshtoi kategorikisht bashkimin e padrejtë e me

dhunë të Kosovës me Serbinë, e deri në çlirimin përfundimtar të Kosovës nga Serbia pushtuese më 1999, kur lufta e lavdishme e UÇK-së u kurorëzua me largimin përfundimtar të Serbisë nga Kosova, Ramiz Cernica ishte njëri prej frymëzuesve kryesorë të të gjitha lëvizjeve dhe grupeve politike-patriotike ilegale atdhetare për liri e pavarësi!

Ramiz Cernica koha po dëshmon, se ishte shumë i vetëdijshëm se si po vepronte në Kuvendin e Prizrenit!

Rruga në të cilën hyri, historia dhe bashkëmoshatarët e Tij, dëshmojnë se nuk ishte aspak e lehtë për t'u mbajtur, por pa as më të voglin dyshim ishte rruga e nderit dhe e krenarisë, ngase e dinte se i dilte zot Kosovës së tij të dashur e të shtrenjtë dhe njëkohësisht e bënte publike dashurinë e Tij mbinormale e mbinjerëzore për Nënë Shqipëri!

Tribuni i Kombit Ramiz Cernica nuk e zgjodhi rrugën e turpit siç vepruan deputetët tjerë, duke iu bashkuar tradhtisë në ballë me deputetët tradhtarë Sinan Hasani, Ali Shukriu e tradhtarë të tjerë, por e zgjodhi rrugën e lavdisë kombëtare dhe lavdia e ka mbuluar dhe po e mbulon përjetësisht e do të kurorëzohet edhe me shtatore gjigante para ndërtesës së Komunës në Gjilan! Për kontributin direkt në shërbim të kombit, që u ngrit me madhësi dhe kundërshtoi botërisht lënien e Kosovës nën Serbi, Ramiz Cernica meriton t'i ngritët shtatorja jo vetëm në Gjilan, sikur atë ditë që u hodh gurthemeli, por t'i ngritët edhe në Tiranë, edhe në Shkup e edhe

në Prishtinë, por edhe kudo nëpër territoret e Atdheut, e veçanërisht në Prizren, në vendin ku u mbajt Mbledhja e parë e Kuvendit të Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore!

Se si dhe kur do të realizohet ëndrra e madhe e liridashësit largpamës e të pakompromis të Bashkimit të Kosovës me Nënë Shqipërinë, mbetet të shihet se çka do të ofrojë e ardhmja, por për një gjë duhet të jemi të ndërgjegjshëm e të mos e harrojmë në jetë të jetëve, se qëndrimi heroik, burrërorë e syptrembur i Tribunit të Kombit Ramiz Cernica në Kuvendin e Prizrenit, të gjithë atdhetarëve pa përjashtim, të të gjitha gjeneratave, ua ka mbajtur gjallë ëndrrën për bashkim kombëtar!

Tribuni i Kombit Ramiz Cernica, me qëndrimin e Tij, ishte bërë frymëzuesi i qindra dhe mijëra atdhetarëve, ishte shndërruar në barrikadën e gjallë shpirtërore para pushtuesve, kriminelëve e gjakpirësve pushtues serb!

Tribuni i Kombit Ramiz Cernica, ishte dhe mbetet një nga ndriçuesit e vetëm të mëdhenj dhe fanari gjigant i ndriçimit të rrugës së lavdishme për çlirim e pavarësi të Kosovës dhe jo vetëm, me Nënë Shqipërinë! Ndriçim të tillë do të shpërndajë edhe me shtatoren e Tij gjigante që do t'i ngritët në qendër të Gjilanit, përpara ndërtesës së Komunës!

Populli shqiptar i Kosovës dhe Viseve të saja jashtë kufijve politik të Shqipërisë Nënë, të gjitha mendjet e ndritura të kombit tonë, që ishin të shpërndara kudo nëpër botë, te qëndrimi spektakular atdhetar i

patriotit Ramiz Cernica në Prizren më 1945, kishin parë kundërshtimin që e hapur që i bëhej jo vetëm aneksimit ushtarako-policor të Serbisë pushtuese por edhe tradhtisë së madhe parlamentare të deputetëve tradhtarë shqiptarë! Lindja e kësaj krijese të madhe kombëtare në vitin e largët 1903, ishte një nga lindjet nga më të mëdhatë, jo vetëm për familjen e Tij, jo vetëm për fisin Tij, jo vetëm për fshatin e Tij të lindjes Cernicën e jo vetëm për krahinën e Tij Anamoravën, por ishte lindje e madhe dhe e paarritshme për tërë Kosovën dhe gjithë Shqipërinë dhe Kombin shqiptar!

Ramiz Cernica me veprimin e Tij dhe aktin e qëndrimit burrërorë e heroik në Kuvendin e Prizrenit më 1945, dhe shembullin e madh se si duhet të veprojë biri besnik për interesat e shenjta të popullit dhe Atdheut, mesazh të tillë të drejtpërdrejtë, do të përcjellë edhe shtatoren e Tij gjigante që do ti vendoset në Gjilan!

Ishin, janë e do të mbeten të shumta zemrat e mëdha shqiptare dhe mendjet e ndritura të kombit, të cilat te Heroi i Kuvendit të Kosovës në Prizren, do ta kenë përgjithmonë simbolin e famshëm, i cili kishte pasur aq shumë guxim njerëzor e guxim kombëtar, ashtu sikur e dimë të gjithë, sa në mes të Parlamentit, ju kishte thënë pushtuesve serbë dhe tradhtarëve shqiptarë, se këtë gabim, mashtrim e kurth tuajën, populli shqiptar kurrë nuk do ta pranojë, dhe se do të vijë koha, e Kosova kurrë nuk do

të mbetet nën Serbi, por do të luftohet me të gjitha mjetet, do të derdhet gjak dhe Kosova do të jetë e lirë dhe do të jetë kurdoherë me Nënë e saj, me Shqipërinë!

Vëllau e shoku im Ndue Dodaj nga Mirdita e Shqipërisë, në një nga shkrimet e Tij e ka thënë qartë se: "...Ramiz Cernica përfaqësonte në atë mbledhje një vullkan të ndezur shqiptarë të rrallë që, si biri i popullit, Ai u bë nismëtari i realizimit të aspiratës për bashkim të popullit shqiptar të Kosovës me Shqipërinë! Në këtë kuptim kjo figurë na flet edhe sot, e na përcjell mesazhin për sot e për nesër, për t'u përballur me sfidat e reja siç u përballur me sfidat e ato kohë. Personaliteteve të mëdha në histori u rrezatojnë veprat e tyre dhe mbartin në vetvete bërthama filozofike prej nga mund të mbjellësh shumë pemë ëndrrash dhe të inspirohesh prej tyre. I tillë ishte dhe mbetet Ramiz Cernica...!"

Gurthemeli i 25 Nëntorit të vitit 2022, do të mbahet mend gjatë, sepse brenda tij, ka edhe porosinë e madhe se ashtu sikur me jetën dhe me veprën e Tij, ashtu sikur me qëndrimin heroik të mbajtur në Parlamentin e Kosovës në Prizren, edhe me shtatoren e Tij që do t'i ngritët e do t'i vendoset në Gjilan, Deputeti legjendar i popullit shqiptar, Tribuni i titanik i Kombit Ramiz Cernica, do të shndërrohet në ikonën më të madhe edhe në mesin shtatoreve gjigante të figurave e personaliteteve të mëdha të popullit, Atdheut e Kombit shqiptar!





MBI 200 MJEKË E LËSHUAN KOSOVËN

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Emigrimi i qytetarëve të Kosovës dhe fuqisë punëtore edhe në vitin 2022 ka vazhduar të jetë një ndër sfidat kryesore për institucionet dhe shoqërinë, sidomos në sektorin e shëndetësisë.

Vetëm gjatë këtij viti nga Kosova janë larguar 215 mjekë.

Pavarësisht prej kornizës ligjore dhe mekanizmave të ndërtuar për koordinimin dhe implementimin e politikave për migrim, mungojnë masa adekuate institucionale për ta adresuar largimin e qytetarëve jashtë vendit.

Mungesa e kushteve të punës në sektorin publik, pagat e ulëta dhe

mospërputhja e kurrikulës arsimore me kërkesat e tregut të punës, kanë sjellë si pasojë "largimin e trurit", duke shkaktuar emigrim të një numri të madh të mjekëve dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë.

Kjo ndikon direkt në zhvillimin ekonomik të vendit dhe ngrit nevojën për aktivizim të menjëhershëm të institucioneve. Mangësitë në sektorin publik të shëndetësisë kanë dëmtuar mirëqenien e qytetarëve në përgjithësi, duke sjell si rezultat largimin e tyre në masë të madhe jashtë vendit për kushte më të mira dhe qasje më të lehtë në shërbime shëndetësore.

Kërkesat e vendeve të zhvilluara për fuqi punëtore kanë rritur emigrimin e rregullt duke

lehtësuar integrimin e mjekëve dhe punëtorëve shëndetësorë emigrantë.

Ky trend i migrimit kërkon rritjen e buxhetit për sektorin e shëndetësisë, për të siguruar paga më të larta dhe vende të reja të punës. Në mungesë të masave adekuate institucionale, situata mund të përkeqësohet pa një strategji efektive të menaxhimit, është vlerësuar sipas raportit të ri të Grupit për Ballkan.

Brenda vendeve të BE-së ka lëvizje të mëdha të mjekëve. Aktualisht largimi i punëtorëve shëndetësorë nga Kosova është një problem i vazhdueshëm. Edhe punëtorët shëndetësorë nga Kosova emigrojnë për të njëjtat arsye që emigrojnë punëtorët shëndetësorë nga

vendet e tjera: për shkak të pagave të ulëta dhe për shkak të kërkesës së lartë për këtë profesion në vendet më të zhvilluara. Sipas të dhënave të Odës së Mjekëve të Kosovës, arsyet që më së shpeshti përmenden nga mjekët që largohen nga Kosova kanë të bëjnë me mungesën e vendeve të punës (38 % e të anketuarve), pagat e ulëta (31 %), kushtet e punës (27 %), arsye të tjera (4 %). Sipas një studimi, 14.43 % e punëtorëve shëndetësorë të anketuar kanë deklaruar se dëshirojnë të emigrojnë, prej tyre 20.81 % e mjekëve të Kosovës kanë deklaruar se dëshirojnë të emigrojnë, 12.81 % e infermierëve dhe 13.59 % e punëtorëve të tjerë shëndetësorë. Edhe pandemia

Covid-19 vetëm se ka rritur gatishmërinë për emigrim.

Pagat e ulëta dhe kushtet jo të kënaqshme të punës kërkojnë një përqendrim të veçantë institucional. Këta janë ndër faktorët kryesorë të emigrimit të punëtorëve në sektorin e shëndetësisë dhe, si të tilla, kërkojnë ndërhyrje të shpejtë në politika dhe strategji. Mungesa e kushteve të nevojshme të punës dhe kapaciteteve të mjaftueshme teknike kërkon rritjen e financimit të përgjithshëm në këtë sektor. Institucionet duhet t'i rritin shpenzimet për shëndetësi për ta arritur mesataren e BE-së dhe kjo rritje në buxhet duhet të shoqërohet me medoemos me rritjen e pagave për punëtorët shëndetësorë.

BOTA NË VITIN 2022



EPOKA ERE Përgatiti: **Lirim GECI**

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Pushtimi i Ukrainës nga Rusia, lëvizja protestuese në Iran, vënia në pikëpyetje e së drejtës së abortit në Shtetet e Bashkuara e kanë karakterizuar botën gjatë vitit 2022.

Rusia sulmon ushtarakisht Ukrainën

24 SHKURT - Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës, duke e zhytur botën në një krizë të paparë që nga fundi i Luftës së Ftohtë. Ndaj pushtimit të Ukrainës kanë reaguar njëzëri të gjitha vendet perëndimore, duke i dalë në ndihmë shtetit ukrainas, financiarisht dhe me armët më moderne. Që nga fillimi i kësaj lufte është raportuar për numër të madh viktimash dhe humbje të mëdha të Rosisë, së cilës i ka hasur "sharra në gozhdë" në Ukrainë, e cila është duke i rezistuar agresionit rus.

Pas 14 vjetësh presidenti izraelit viziton Turqinë

9 MARS - Presidenti i Izraelit, Isaac Herzog, ka qëndruar për një vizitë dyditore në Turqi, duke shënuar përmirësim në marrëdhëniet që kanë qenë të tensionuara për më shumë se një dekadë. Vizita e presidentit izraelit Isaac Herzog në Ankara është shenja më domethënëse e përpjekjeve për afrim mes dy vendeve. Turqia kishte tërhequr ambasadorin e saj në vitin 2018 në shenjë proteste ndaj sulmeve të Izraelit në Rripin e Gazës.

Navalny dënohet me nëntë vjet burg

22 MARS - Udhëheqësi i opozitës ruse, Alexei Navalny, është dënuar me nëntë vjet burgim për mashtrim dhe mospërfillje. Ky gjykim, nga kritikët e Kremlinit, është parë si përpjekje për ta mbajtur sa më gjatë në burg

armikun më të zjarrtë të presidentit Vladimir Putin. Navalny ka hedhur poshtë akuzat, duke i quajtur ato të motivuara politikisht. Prokuroria kishte kërkuar 13 vjet burg të sigurisë maksimale për aktivistin kundër korrupsionit dhe një gjobë prej 1.2 milion rublash.

OKB pezullon Rusinë nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut

7 PRILL - Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka pezulluar Rusinë nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut pas raportimeve "për shkelje sistematike dhe abuzim të të drejtave të njeriut" nga trupat ruse që kanë pushtuar Ukrainën. Kjo kërkesë e shtyrë nga Shtetet e Bashkuara është miratuar me 93 vota për, 24 kundër dhe 58 shtete kanë abstenuar. Në mesin e vendeve që e kanë mbështetur pezullimin janë: Shtetet e Bashkuara, kombet e Bashkimit Evropian, Mbretëria e Bashkuar dhe vetë Ukraina. Kina, Siria dhe Bjellorusia kanë votuar kundër. India, Egjipti dhe Afrika e Jugut kanë qenë në mesin e vendeve që kanë abstenuar. Për pezullimin e Rosisë janë nevojitur dy të tretat e shumicës. Pezullimet e tilla janë të rralla. Libia është pezulluar më 2011 për shkak të dhunës kundër protestuesve nga forcat besnike të ish-liderit, Muammar Gaddafi.

Macroni siguron mandatin e dytë presidencial në Francë

24 PRILL - Presidenti francez Emmanuel Macron ka shënuar

fitore bindëse ndaj rivales së tij të së djathtës ekstreme, Marine Le Pen, në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale të 24 prillit në Francë. Macron, 44-vjeçar, ka fituar më shumë se 58 për qind të votave në krahasim me më pak se 42 për qind sa ka fituar Le Pen, 53-vjeçare. Momentet e gëzimit janë parë menjëherë në ekranet e mëdha afër Kullës Eiffel, ku janë mbledhur mbështetësit e Macronit, të cilët janë parë me flamuj francezë dhe ata të Bashkimit Evropian.

Përmbyjsja e të drejtave të abortit në ShBA

25 QERSHOR - Në qershor Gjykata e Lartë e Shteteve të Bashkuara i ka dhënë çdo shteti lirinë për ta ndaluar abortin në tokën e tij, duke përmbytur vendimin historik të vitit 1973. Pas kësaj përmbysjese, rreth 20 shtete ndaluan plotësisht ose kufizuan të drejtën për ndërprerje vullnetare të shtatzënisë dhe çështja dominoi fushatën zgjedhore afatmesme. Në nëntor, zgjedhjet afatmesme nuk rezultuan në një "valë" të kuqe konservatore, siç kishin shpresuar mbështetësit e ish-presidentit Donald Trump. Demokratët mbajtën kontrollin e Senatit dhe republikanët siguruan një shumicë të vogël në Dhomën e Përfaqësuesve. Donald Trump, megjithatë, shpalli kandidaturën e tij për zgjedhjet presidenciale të 2024-s. Kandidatura e ish-presidentit mund të kërcënohet nga ndjekjet e mundshme, pasi një prokuror special u caktua në nëntor për dy nga hetimet e shumta që kanë në shënjestër atë.

Vritet ish-kryeministri i Japonisë, Shinzo Abe

8 KORRIK - Ish-kryeministri i Japonisë, Shinzo Abe, ka vdekur pasi është sulmuar me armë zjarri në një ngjarje në qytetin Nara. Abe, 67 vjeç, po mbante një fjalim për zgjedhjet, kur u qëllua me dy plumba. Sulmuesi i dyshuar është arrestuar në vendin e ngjarjes, ndërsa Abe është dërguar menjëherë në spital në gjendje të rëndë, ku kishte ndërruar jetë.

30 milionë pakistanezë preken nga përmbytjet e furishme

28 GUSHT - Provinca Khyber Pakhtunkhwa në veriperëndim të Pakistanit ka përjetuar tmerrin. Shumë persona kanë humbur jetën si pasojë e rrëshqitjeve të dheut dhe përmbytjeve të furishme. Autoritetet pakistaneze kanë njoftuar se numri i viktimave ka arritur në rreth 1 000, ndërsa mbi 20 mijë shtëpi janë të dëmtuar vetëm në qytetin Nowshera. Rreth 30 milionë njerëz janë prekur nga përmbytjet në mbarë vendin.

Vdes në moshën 91-vjeçare Mihail Gorbaçovi

30 GUSHT - Mihail Gorbaçovi, i cili i kishte dhënë fund Luftës së Ftohtë pa gjakderdhje, por që kishte arritur ta parandalojë shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik, ka vdekur në moshën 91-vjeçare. Gorbaçovi, presidenti i fundit sovjetik, kishte arritur marrëveshje me Shtetet e Bashkuara për pakësimin e armëve si dhe partneritete me fuqitë perëndimore për ta hequr "Perden e Hekurt" që kishte ndarë Evropën që nga Lufta e Dytë Botërore si dhe për ta mundësuar ribashkimin e Gjermanisë.





Ndërron jetë Mbretëresha Elizabeth e Britanisë, Charles III monarku i ri

8 SHTATOR - Mbretëresha Elizabeth, monarkia më jetëgjatë e Britanisë dhe kryetarja e shtetit për shtatë dekada, ka ndërruar jetë në moshën 96-vjeçare. I biri i saj, 73-vjeçari Charles, është bërë automatikisht mbret i Mbretërisë së Bashkuar dhe kreu i shtetit për 14 territore të tjera, përfshirë Australinë, Kanadanë dhe Zelandën e Re. Ai do të njihet si Mbreti Charles III. Bashkëshortja e tij, Camilla, do të njihet si mbretëresha bashkëshorte. Në varrin e Elizabethes kanë marrë pjesë personalitete të shquara nga e gjithë bota, duke përfshirë edhe Kosovën.

Revoltë kundër shamisë, shtypje e dhunshme në Iran

MË 16 SHTATOR - Mahsha Amini, një 22-vjeçare iraniane me origjinë kurde, ka vdekur në spital tri ditë pasi është arrestuar nga policia e moralit që e ka akuzuar për shkelje të kodit të rreptë të veshjes së Republikës Islamike për gratë. Vdekja e saj ka ndezur një valë protestash në të gjithë Iranin që nuk ishin parë që nga Revolucioni Islamik më 1979. Gratë e reja ishin në ballë të lëvizjes protestuese, prej tyre kanë hequr dhe djegur shamitë në kundërshtim me autoritetet. Demonstratat për lirinë e grave po kthehen gradualisht në një lëvizje më të gjerë kundër regjimit islamik, duke marrë rrugët, universitetet dhe madje edhe shkollat, pavarësisht shtypjes. Autoritetet kanë thënë se janë shënuar të paktën 300 vdekje (që nga 12 shtatori), me një OJQ me bazë në Norvegji që liston të

paktën 469. Në fillim të dhjetorit autoritetet bënë një gjest për protestuesit, duke njoftuar shpërbërjen e policisë së moralit.

Xi Jinping rizgjedhet kryetar i Partisë Komuniste, politika "zero Covid" sfidohet

23 TETOR - Presidenti kinez Xi Jinping është rizgjedhur në krye të Partisë Komuniste Kineze (CCP) në Kongresin e 20 të CCP, i rrethuar nga aleatë besnikë për t'u bërë udhëheqësi më i fuqishëm në Kinën moderne. Gjatë dhjetë vjetëve të tij në krye të vendit, Xi Jinping ka demonstruar një dëshirë për kontroll, duke ndërhyrë në pothuajse të gjithë mekanizmat e vendit dhe duke tërhequr kritika ndërkombëtare për të dhënat e të drejtave të njeriut në vend. Ajo, gjithashtu, ruan një rivalitet në përqendrim me Shtetet e Bashkuara. Tensionet në ngushticën e Tajvanit kanë arritur nivelin e tyre më të lartë në vite pasi kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve të ShBA-së, Nancy Pelosi, ka vizituar ishullin autonom në fillim të gushtit. Kina është hakmarrë duke kryer stërvitje tokësore dhe detare të një përmase të paprecedentë që nga mesi i viteve 1990. Dhe presidenti i ShBA-së, Joe Biden, ka deklaruar se trupat amerikane do ta mbrojnë Tajvanin nëse ishulli pushtohet nga Kina. Strategjia "zero Covid" e vendit, e cila ka qar në mbylljen e rretheve apo qyteteve të tëra kur shfaqen shpërthime, ka provokuar në fund të nëntorit protestat më të mëdha në dekada. Autoritetet janë përgjigjur me një goditje dhe më pas, në dhjetor, u miratua një lehtësim i përgjithshëm i rregullave shëndetësore për ta qetësuar zemërimin popullor dhe

për të mbështetur ekonominë e lëkundur. Në fund të dhjetorit Kina, më në fund, ka njoftuar se më 8 janar të vitit 2023 do t'i japë fund karantinës së detyrueshme kur dikush të mbërrijë në vend, mbetja e fundit e politikës së rreptë shëndetësore "zero Covid". Pas këtij relaksimi, rastet me Covid po përjetojnë një shpërthim në vend si pasojë e të cilit spitalet janë nën presion të madh, ndërsa farmacitë prekin mungesën e ilaçeve kundër temperaturës dhe gripit.

Sunak emërohet kryeministër i Britanisë

25 TETOR - Rishi Sunak zyrtarisht është emëruar në pozitën e kryeministrit të Britanisë, duke zëvendësuar Liz Truss, e cila kishte dhënë dorëheqje pas 44 ditësh si kryeministre, pasi një program ekonomik që ajo kishte prezantuar shkaktoi trazira në tregjet financiare, duke bërë që ta humbiste mbështetjen e Partisë Konservatore. Truss e kishte zëvendësuar Boris Johnsonin, i cili më 7 korrik pati dhënë dorëheqje nga posti i kryeministrit. Sunak, ish-ministër i Financave, është kryeministri i parë i Britanisë me prejardhje indiane. Më 25 tetor Mbreti Charles III e ftoi Sunakun që ta formojë qeverinë e re britanike. Sunak, multimilioner dhe ish-drejtues i fondeve investuese, ka thënë para ligjvënësve të Partisë Konservatore më 24 tetor, se Britania përballet me "krizë ekzistenciale" dhe "ne duhet të bashkohemi ose të vdesim".

Shpresa për paqe në Etiopi

2 NËNTOR - Pas dy vjetësh konflikt, Qeveria federale e Etiopisë dhe

autoritetet rebele në provincën veriore të Tigray kanë nënshkruar një marrëveshje "pushimi armiqësish" në Pretoria më 2 nëntor, që synon t'i japë fund një lufte që organizatat joqeveritare e quajtën atë "një nga më vdekjeprurësit në botë". Pas një armëpushimi pesëmuajor, luftimet kishin rifilluar në fund të gushtit. Përveç çarmatosjes së rebelëve, marrëveshja e paqes pritet ta lejojë dërgimin e ndihmave humanitare në Tigray, i cili praktikisht është shkëputur nga pjesa tjetër e botës dhe gjashtë milionë banorët e tij kanë qenë pa ushqim dhe ilaçe për më shumë se një vit. Kolona e ndihmës së parë që nga fundi i gushtit mbërrin më 16 nëntor. Trajtimi i punëtorëve emigrantë, thelbësor në një vend ku Katarianët përbëjnë vetëm 10 për qind të një popullsie prej tre milionësh, është veçanërisht i kritikuar. Disa medie raportojnë mijëra të vdekur në kantieret e ndërtimit, një llogari e mohuar nga Doha.

Slovenia zgjedh presidenten e parë grua

13 nëntor - Aktivistja e të drejtave liberale, Natasa Pirc Musar, ka fituar balotazhin e zgjedhjeve presidenciale të Sllovenisë. Musar është bërë presidentja e parë grua e shtetit të vogël, anëtar i Bashkimit Evropian (BE). Fitorja e saj i ka dhënë edhe më shumë shtytje bllokut liberal sloven pas fitores së koalicionit të qendrës së majtë në zgjedhjet parlamentare që ishin mbajtur në prill. Natasa Pirc Musar është një avokate e shquar slovene. Ajo ishte përfaqësuese ligjore e ish-zonjës së parë të ShBA-së, Melania Trump, në çështjet gjyqësore për të drejtat e autorit dhe çështje të tjera në vendlindjen e saj, Slloveni.

Bota me 8 miliardë banorë, në vitin 2023 India do të ketë më shumë banorë se Kina

15 nëntor - Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) ka bërë me dije se popullsia e botës ka arritur në 8 miliardë banorë dhe India në vitin 2023 pritet të jetë vendi me numrin më të madh të popullsisë, duke ia kaluar Kinës. Por, rritja e shpejtë e popullsisë mund të shkaktojë sfida ekonomike për Indinë. Në rrugët e mbushura me njerëz të kryeqytetit të Indisë, Nju-Delhi, banorët kanë shprehur shqetësimet e tyre për pasojat ekonomike. India aktualisht ka një miliard e 412 milionë banorë, ndërsa Kina një miliard e 426 milionë.

Mbi 300 të vdekur nga tërmeti në Indonezi

21 NËNTOR - Një tërmet i fuqishëm ka goditur Indonezinë, duke lënë të vdekur mbi 310 persona. Shërbimi Gjeologjik i ShBA-së (USGS) ka njoftuar se tërmeti 5.6 ballë është regjistruar 18 kilometra në jugperëndim të qytetit Ciranjang, në rajonin e Java-s Perëndimore të Indonezisë, në një thellësi prej 10 kilometrash.

Fitoret dhe humbjet për të djathtën ekstreme

Pas katër vjetësh në pushtet, presidenti i ekstremit të djathtë të Brazilit, Jair Bolsonaro, u mund ngushtë nga i majti Luiz Inacio Lula da Silva në zgjedhjet presidenciale të 30 tetorit pas një fushate toksike. Lula, i cili është burgosur për korrupsion (2018-2019) përpara se të rrezohet, do të kthehet zyrtarisht si kreu i shtetit të Brazilit më 1 janar 2023. Suksesi i tij



duket se shënon rikthimin e të majtëve në Amerikën Latine. Në Evropë, përkundrazi, ultra-konservatorët kanë shënuar fitore në zgjedhjet parlamentare në disa vende, duke filluar në prill me fitoren e katërt radhazi të liderit të partisë nacionaliste hungareze, Viktor Orban. Në Francë, Partia e Marine Le Pen (e djathta ekstrem) ka regjistruar një fitore historike në qershor, duke u bërë partia e parë opozitare në Asamblenë Kombëtare, ku kreu i shtetit Emmanuel Macron ka humbur një shumicë absolute. Partia Demokratike Suedeze (SD) nacionaliste dhe anti-imigruese është fituesja e madhe në zgjedhjet e shtatorit, duke u bërë forca e dytë politike më e madhe

në vend. Në Itali, Georgia Meloni ka shënuar një fitore historike në shtator me partinë post-fashiste të Italisë Adelphia dhe u emërua kryeministre në tetor.

Inflacioni si pasojë e krizës energjetike

Rritja e çmimeve, e cila filloi në vitin 2021 për shkak të ndërprerjes së zinxhirëve të furnizimit, e kombinuar me kërkesën e fortë për mallra dhe shërbime thelbësore, ndërsa ekonomitë rifilluan të rimëkëmbeshin pas Covidit është përshpejtuar në vitin 2022, duke arritur nivele të papara që nga vitet 1970 dhe 1980. Inflacioni ka arritur në 10.1 për qind në nëntor në Eurozonë.

Inflacioni është ushqyer nga lufta në Ukrainë, e cila është duke e zhytur Evropën në një krizë të thellë energjetike. Rusia, nën ndikimin e sanksioneve perëndimore, është duke i shumëfishuar hakmarrjet e saj derisa ta godasë pikën e ndjeshme të BE-së: varësinë e saj nga gazi rus. Eksportet e gazit rus, kryesisht përmes Gjermanisë dhe Italisë, shumë të varura, janë në rënie të lirë. Për shkak të kufizimeve të vazhdueshme shëndetësore të lidhura me Covid-19, mungesat e çipave elektronikë, kryesisht të prodhuar në Tajvan, kanë ngadalësuar edhe shumë sektorë ekonomikë. Për ta zbutur inflacionin, Banka Qendrore e ShBA-së ka rritur në mënyrë

agresive normat e interesit që nga marsi, duke e bërë huamarrjen gjithnjë e më të shtrenjtë, me Bankën Qendrore Evropiane që ndjek shembullin.

Kushtet ekstreme të motit

Në vitin 2022 fatkeqësitë e lidhura me ngrohjen e klimës janë shumëfishuar. Vera është më e nxehta e regjistruar ndonjëherë në Evropë, temperaturat rekord dhe valët e të nxehtit kanë shkaktuar thatësi dhe zjarre pyjore (të paktën 6 milionë e mijë 600 hektarë pyje janë kthyer në hi nga janari deri në mes të gushtit në BE). Akullnajat alpine shënuan humbje rekord të masës së akullit.

Të paktën 15 mijë vdekje janë të lidhura drejtpërdrejt me të nxehtin në Geria Epir, sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Kina ka thyer gjithashtu rekordet e të nxehtit në gusht dhe thatësira kërcënoi Bririn e Afrikës me zi buke. Zjarret dhe shpyllëzimi kanë thyer rekorde të reja në Amazonën braziliane. Në mesin e dhjetorit më shumë se 190 vende kanë miratuar një marrëveshje historike në Montreal në një përpjekje për ta ndaluar shkatërrimin e biodiversitetit dhe burimeve të tij natyrore. Marrëveshja parashikon një udhërrëfyes me synimin kryesor për mbrojtjen e 30 % të planetit deri në vitin 2030.





67 GAZETARË DHE PUNONJËS TË MEDIEVE U VRANË NË VITIN 2022

DHJETOR/JANAR - Lufta e Rusisë në Ukrainë, kaosi në Haiti dhe dhuna në rritje nga grupet kriminale në Meksikë, kontribuuan në një rritje prej 30-përqindësh të numrit të gazetarëve të vrarë duke bërë punën e tyre në vitin 2022 krahasuar me një vit më parë, sipas një raporti të ri të publikuar të premten.

Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve thotë se 67 gazetarë dhe staf mediatik janë vrarë në mbarë botën deri tani këtë vit krahasuar me 47 gazetarë të vrarë vitin e kaluar. Grupi me seli në Bruksel numëroi 375 gazetarë të burgosur aktualisht për punën e tyre, me shumicën prej tyre në Kinë, Myanmar dhe Turqi. Raporti i vitit të kaluar rendiste 365 gazetarë prapa grilave. Me rritjen e numrit të të vrarëve nga radhët e punonjësve të

medies, grupi i lartcekur u bëri thirrje qeverive të ndërmarrin veprime më konkrete për t'i mbrojtur gazetarët dhe gazetarinë e lirë. "Dështimi për të vepruar vetëm do t'i inkurajojë ata që kërkojnë ta shtypin rrjedhën e lirë të informacionit dhe ta minojnë aftësinë e njerëzve për t'i mbajtur udhëheqësit e tyre përgjegjës, duke përfshirë sigurimin që ata me pushtet dhe ndikim të mos qëndrojnë në rrugën e shoqërive të hapura dhe gjithëpërfshirëse", thuhet në deklaratën e sekretarit të përgjithshëm të IFJ-së, Anthony Bellanger.

Më shumë punonjës të medias u vranë duke mbuluar luftën në Ukrainë - 12 gjithsej se në çdo vend tjetër këtë vit, sipas IFJ-së. Shumica ishin ukrainas, por ky numër përfshin edhe ata të kombësive të tjera si regjisorin amerikan i filmave dokumentarë

Brent Renaud. Shumë vdekje ndodhën në javët e para kaotike të luftës, megjithëse kërcënimet ndaj gazetarëve vazhdojnë ndërkohë që luftimet zvarriten.

IFJ tha se "sundimi nga terrori i organizatave kriminale në Meksikë dhe prishja e rendit dhe

ligjit në Haiti kanë kontribuar gjithashtu në rritjen e vrasjeve". Viti 2022 ka qenë një nga më vdekjeprurësit ndonjëherë për gazetarët në Meksikë, e cila tani konsiderohet si vendi më i rrezikshëm për gazetarët jashtë një zone lufte.

Grupi i lartcekur regjistroi pesë vdekje të gazetarëve në mes të krizës politike të këtij viti në Pakistan dhe paralajmëroi për kërcënime të reja ndaj gazetarëve në Kolumbi dhe rrezik të vazhdueshëm për gazetarët në Filipine pavarësisht prej udhëheqjes së re atje.

Ai, gjithashtu, bëri thirrje për vrasjen e gazetares së "Al Jazeera", Shireen Abu Akleh, teksa ajo po raportonte nga një kamp refugjatësh palestinezë. Rrjeti arab këtë javë i kërkoi zyrtarisht Gjykatës Ndërkombëtare Penale ta hetojë vdekjen e saj.

IFJ me qendër në Bruksel përfaqëson 600 000 profesionistë të medias nga sindikatat dhe shoqatat në më shumë se 140 vende të botës. Raporti u publikua në prag të Ditës së të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara.





EKONOMIA E KOSOVËS NË 2022-n PËRBALLË KRIZËS SË PANDEMISË DHE LUFTËS NË UKRAINË

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, para medieve ka paraqitur zhvillimet në ekonomi dhe në sektorin financiar. Ai ka thënë se me gjithë vështirësitë me të cilat është ballafaquar, BQK-ja ka arritur edhe këtë vit t'i zbatojë objektivat e saj, duke siguruar një sistem financiar të qëndrueshëm, i cili vitet e fundit arriti t'i përballojë me sukses krizat e shkaktuara nga pandemia Covid-19, edhe nga agresioni rus në Ukrainë, por edhe të jetë një nga shtyllat kryesore të mbështetjes për bizneset dhe individët dhe të ekonomisë së vendit. Sipas Mehmetit, gjatë vitit 2022 ndryshimi i dinamikave globale, si pasojë e luftës në Ukrainë që u shoqërua me rritje të inflacionit, ndryshim të politikave monetare dhe rritje të normave të interesit dhe ngadalësim të rritjes së tregtisë botërore si rezultat i ndërprerjeve të zinxhirit të furnizimit, u reflektua edhe në aktivitetin ekonomik në Kosovë. Ai ka bërë me dije se sipas vlerësimeve të BQK-së, BPV-ja në vitin 2022 pritet të shënojë rritje të ngadalësuar prej 3 deri në 4 për qind, kryesisht për shkak të

tkurrjes së kërkesës së brendshme dhe rritjes së importit, ndërsa eksportet kanë ndikuar pozitivisht. Po sipas Mehmetit, viti 2022 shënoi një ritëm më të shpejtë të rritjes edhe për remitencat e dërguara nga diaspora në Kosovë, të cilat deri në fund të

muajit tetor 2022 arritën në 1 miliard euro, që paraqet rritje vjetore prej 5.5-përqindësh. Ndërkaq rritja e kërkesës së brendshme në Kosovë gjatë këtij viti u reflektua në një vlerë më të lartë të importit të mallrave, i cili deri në shtator 2022 shënoi vlerën 4.15 miliardë euro apo një

rritje vjetore prej 24.6-përqindësh. Në anën tjetër, eksporti i mallrave shënoi vlerën prej 688.0 milionë eurosh, duke shënuar rritje vjetore prej 27.1-përqindësh, kurse eksporti i shërbimeve deri në shtator 2022 shënoi vlerën prej 2.05 miliardë eurosh, duke shënuar rritje vjetore prej 32.8-përqindësh, që ka ndodhur kryesisht si rezultat i rritjes së vizitave të bashkatdhetarëve tanë dhe turistëve në vend.

“Me rritje u karakterizua edhe importi i shërbimeve që deri më shtator 2022 regjistroi vlerën prej 901 milionë eurosh”, ka thënë guvernatori Mehmeti.

Sa iu përket investimeve të huaja direkte, vlera e tyre deri në shtator 2022 arriti në 567 milionë euro në krahasim me vlerën prej 395 milionë eurosh të regjistruar deri në shtator 2021.

“Mesatarja e inflacionit deri në nëntor 2022 shënoi normën prej 11.5-përqindësh në krahasim me mesataren vjetore prej 3.4-përqindësh për vitin 2021, ndërsa

norma e inflacionit vetëm për muajin nëntor 2021 ishte 11.5 për qind, gjë që tregon se po ballafaqohemi me një trend në rritje të nivelit të përgjithshëm të çmimeve. Rritja e normës së inflacionit në Kosovë kryesisht reflekton rritjen e çmimeve në tregjet ndërkombëtare të cilat në Kosovë transmetohen përmes rritjes së çmimeve të mallrave të importuara. Sa i përket sistemit financiar, është shumë e rëndësishme të theksohet se Kosova ka arritur të ndërtojë një sistem financiar të shëndoshë, i cili jo vetëm se u dëshmuoi aftë t'i përballojë krizat e shkaktuara nga pandemia dhe agresioni rus në Ukrainë, por edhe të marrë një rol shumë të rëndësishëm në mbështetjen e ekonomisë për ta përballuar krizën me pasoja sa më të vogla që ishte e mundur. Gjithsej mjetet e sistemit financiar më 30 tetor 2022 ishin në vlerë prej 9.43 miliardë eurosh, me një rritje vjetore prej 10.2-përqindësh”, ka treguar Mehmeti.

Sektorit bankar, si komponentë kryesore e sistemit financiar në vend, edhe këtë vit po luan rol shumë të rëndësishëm në përkrahjen e ekonomisë së vendit duke vazhduar ritmin e rritjes së kreditimit dhe ta ruajë shkallën e qëndrueshmërisë.

Çfarë e pret ekonominë e Kosovës në vitin 2023?

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, thotë se ka shumë mundësi që vendet e Bashkimit Evropian të futen në recesion apo rënie të përgjithshme të aktivitetit ekonomik në vitin 2023 e që, gjithashtu, edhe Kosova do të jetë në rrezik nga recesioni ekonomik. “Vitin 2023 po e ndaj në dy pjesë. Deri në qershor-korrik e shoh si një sfidë shumë të madhe. Siç janë duke shkuar trendët dhe sipas disa raporteve





që kam arritur t'i lexoj, parashihet mundësia shumë e madhe që disa shtete të Bashkimit Evropian të hyjnë në recesion. Nëse tregu evropian hyn në recesion, ai automatikisht reflekton edhe në Kosovë. Tregu evropian nuk ka pasur recesion nga viti 2008. Nëse i shpëtojmë kësaj, atëherë pjesa e dytë e vitit është më optimiste. Më bën optimist se çmimet e derivateve kanë filluar të bien. Vendet e Bashkimit Evropian kanë siguruar burime alternative të energjisë dhe nuk janë të varura nga gazi rus. Po ashtu, në tregun evropian çmimi i gazit nuk ka pësuar ngritje dhe ka filluar të bjerë. Shpenzimet e transportit ndërkombëtar kanë filluar të bien. Këto janë indikacionet që më çojnë në pjesën e dytë... Nëse nuk hyn tregu evropian në recesion, pjesa e dytë do të jetë më optimiste", ka theksuar Rafuna.

Të evitohet shndërrimi i Kosovës në shtet social, të shndërrohet në shtet zhvillimor

Njohësi i ekonomisë, Safet Gerxhaliu, thotë se qytetarët e Kosovës kanë problem që nuk i pranojnë krizat si kriza, edhe pse kjo, sipas tij, i prek më së shumti ata dhe ekonominë e shtetit. "Në Kosovë problemi më i madh është që nuk po pranohet kriza si krizë dhe derisa të gjitha vendet e rajonit marrin masa për ta

sensibilizuar efektin negativ të krizës, në Kosovë promovohen inflatorë të ndryshëm ekonomikë që i paraqesin si negativë, që defenitivisht krizën sot e përjeton qytetari i Kosovës. Krizën është duke e përjetuar sektori privat dhe në këtë drejtim vërtet efektet e krizës do të jenë shumë të mëdha dhe është një humbje urgjente e ekonomisë së një shteti", ka thënë Gerxhaliu. Ai ka theksuar se gjatë vitit 2022 shqetësues ishte edhe ngritja e çmimit të energjisë, peletit dhe drunjve, si dhe produkteve të tjera konsumuese.

Kritikat e tij Gerxhaliu i ka ngritur për qeverinë e vendit, pasi nuk po punohet për uljen e pasojave negative të krizës dhe pakkush po i qan njerëzit që gjenden në varfëri ekstreme. "Shtetet e tjera kanë përdorur strategji dhe mekanizma për të qenë më afër qytetarëve, që t'i ulin pasojat negative të krizës. Por në Kosovë promovohet rritja ekonomike, promovohet rritja e të hyrave, promovohet punësimi, promovohen ilustrimet, ndërsa njerëzit e shtresës së mesme dhe qytetarët e varfër që janë nuk varfëri ekstreme pakkush po i qan", ka theksuar ai.

Gerxhaliu ka thënë se Qeverisë së Kosovës i mungon një dialog me qytetarët, duke theksuar se qeveria aktuale duhet ta evitojë shndërrimin e Kosovës në shtet social dhe të punojë për ta shndërruar vendin në shtet zhvillimor.



ATK-ja inkasoi 721 milionë euro në 2022-n

Vitin 2022 do ta karakterizojë tejkalimin e të gjitha parashikimeve në mbledhjen e të hyrave për buxhetin e shtetit të cilat shënojnë 721.6 milionë euro, që i bie se, përveç realizimit të planit për këtë vit, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka arritur të inkasojë mbi 10 milionë euro më shumë se plani i rishikuar. Rritje dhe tejkalim të të hyrave ka edhe nëse krahasojmë këtë

vit me vitin 2021, ku shifrat shkojnë në 124 milionë euro. Mbledhja e të hyrave nuk është i vetmi indikator që ATK-ja ka shënuar progres në vitin që lamë pas, progres ka edhe në trajtimin e borxheve tatimore, te të cilat është arritur të kemi 152.2 milionë euro borxhe të mbledhura. Veç kësaj, vitin që lamë pas janë ndërmarrë një numër i konsiderueshëm i aksioneve për konfiskim të borxheve ndaj tatimpaguesve të cilët nuk i kanë respektuar afatet dhe kushtet për t'i kryer obligimet tatimore.

Fokusi i ATK-së në vitin 2022 ka qenë më theks të veçantë në përmirësimin e përmbushjes tatimore në sektorët të cilët, sipas analizës së riskut, kanë paraqitur hendek tatimor. ATK-ja gjatë vitit 2022 u vlerësua lart për performancën e saj nga të gjitha institucionet ndërkombëtare të cilat bëjnë monitorimin e punës së ATK-së, sikurse raportet e vlerësimit nga FMN-ja, raporti i KE-së, OECD-së, USAID-i, si dhe vlerësimet nga Ambasada e Britanisë së Madhe dhe institucionet e tjera.



SI E NDRYSHUAN GRATË BOTËN GJATË VITIT 2022



DHJETOR/JANAR - Kur titujt e medieve mbushen me luftën në Ukrainë, kolapsi ekonomik dhe autoritarizmi në rritje, historitë për gratë dhe se si ato nxisin ndryshimin, shpesh qëndrojnë në heshtje. Megjithatë, gratë janë në vijën e parë të çdo krize dhe konflikti. Në vitin 2022 kanë fituar poste, kanë ndryshuar ligjet dhe kanë bërë përparim të vërtetë në luftën për barazi. Në vitin 2023 ka arsye edhe për shpresë.

Protestat e Iranit

Që nga vdekja e 22-vjeçares Mahsa Amini në paraburgim, nga e ashtuquajtura polici morale e Iranit, e cila zbatoi rregulla të rrepta fetare, gratë iraniane dhe aleatet e tyre kanë mbushur rrugët e Teheranit si dhe zonat e mëdha e të vogla për të protestuar kundër shtypjes së

grave prej dekadash nga qeveria e tyre.

Protestuesit rrezikojnë arrestimin dhe vdekjen: Të paktën 481 demonstrues janë vrarë deri më tani nga autoritetet iraniane, sipas raporteve nga Agjencia e Lajmeve të Aktivistëve të Drejtave të Njeriut në Iran. Përpjekja e grave iraniane për të fituar të drejtat e tyre ka fituar mbështetje të gjerë ndërkombëtare dhe ka nxitur protesta solidariteti në qytete nga Seuli në Toronto. Shumë tifozë iraniane në Kupën e Botës FIFA në Katar mbanin tabela me sloganin e lëvizjes: "Gratë, Jeta, Liria".

Prokurori i përgjithshëm i Iranit, Mohammad Javad Montazeri, në dhjetor njoftoi se qeveria kishte shfuqizuar policinë e moralit. Por kjo nuk i ndaloi trazirat. Siç argumentoi Sina

Toossi në Foreign Policy, "do të ishte gabim të supozohej se lëvizja e qeverisë përfaqëson diçka tjetër përveç një ndryshimi në rritje".

Mbështetja e ndryshimeve klimatike

Gratë janë të prekura në mënyrë disproporcionale nga ndryshimet klimatike. Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin vlerëson se gratë përbëjnë 80 për qind të atyre që janë zhvendosur nga ndryshimet klimatike.

Vendet pjesëmarrëse në konferencën e OKB-së për ndryshimet klimatike në nëntor, njohur si COP27, ranë dakord të krijojnë një fond për dëmet dhe humbjet për t'i mbështetur vendet në zhvillim që janë veçanërisht të prekshme ndaj ndryshimeve klimatike.

"Vala e gjelbër" e Amerikës Latine

Këtë vit një lëvizje bazë e grave që kërkonin autonomi për sa i përket abortit vazhdoi marshimin në të gjithë Amerikën Latine. E ashtuquajtura "Vala e gjelbër" filloi në Rosario, Argjentinë, në vitin 2003, me një tubim prej 10 000 grave, të cilat

kërkuan të drejtën e tyre për abort.

Shpejt u përhap në të gjithë vendin dhe arriti kulmin me një protestë masive jashtë Kongresit Kombëtar të Argjentinës në vitin 2019. Në vitin 2020 Argjentina legalizoi abortin deri në javën e 14-t të shtatzënisë.

"Vala e gjelbër" e Argjentinës nxiti protesta në Meksikë, Ekuador,





Kili, Peru dhe Kolumbi. Në Meksikë Gjykata e Lartë vendosi në vitin 2021 se ndjekja penale për abortin është jokushtetuese. Këtë vit Kolumbia dekriminalizoi abortin deri në 24 javë, Ekuadori legalizoi abortin në rastet e përdhunimeve dhe Quintana Roo i Meksikës u bë shteti i fundit në vend që dekriminalizoi abortin pas vendimit të gjykatës të vitit 2021. Të gjithë këta hapa drejt të drejtave riprodhuese në Amerikën Latine janë dukur më të theksuar kur krahasohen me trajktoren e Shteteve të Bashkuara. Gjykata e Lartë e ShBA-së në

thelbësisht në kryqëzimin midis çështjeve.

Gratë fermere të Ukrainës

Edhe kur ushtarët rusë pushtuan kopshtin e saj të mbushur me kajsi, Nadiia Ivanova vazhdoi të merrej me bujqësi. "Unë kam 45 fusha, të mëdha dhe të vogla, dhe gjeta një raketë ruse në secilën prej tyre", tha Ivanova Amie Ferris-Rotman.

Ajo është një nga rreth 10 000 gra që drejtojnë ndërmarrje bujqësore në Ukrainë dhe po luftojnë për ta vazhduar



Nadiia Ivanova

Ukraine, les récoltes des agriculteurs bloquées

qershor përmbysi precedentin historik të çështjes Roe kundër Wade, i cili kishte garantuar të drejtën e një gruaje për një abort. Foreign Policy tregoi se si spirala në rënie e ShBA-së për të drejtat e abortit shkon kundër rrymës globale të liberalizimit dhe Erica Hensley e Projektit Fuller tregoi se si gratë amerikane po luftojnë. Catherine Osborn e FP-së argumentoi se "Vala e gjelbër" ka qenë më e suksesshme se aktivizmi i ShBA-së për të drejtat e abortit, sepse është fokusuar

prodhimin. Ukraina shpesh cilësohet si shporta e bukës së Evropës dhe është një furnizuese e madh e grurit në Afrikë, Lindjen e Mesme dhe Azi. Pushtimi rus i Ukrainës ka përkeqësuar mungesën globale të ushqimit dhe një krizë urie në Lindjen e Mesme dhe Afrikë që ndikon në mënyrë disproporcionale gratë dhe vajzat.

Ajo u bë aq e rëndë sa OKB-ja ndërhyri gjatë verës për të ndërmjetësuar një marrëveshje me Turqinë për të transportuar



drithë në mënyrë të sigurt nga Ukraina nëpërmjet Detit të Zi. Megjithatë, gratë fermere të Ukrainës kanë vazhduar strehimin dhe ushqyerjen e ushtarëve ukrainas, si dhe kanë luftuar për të siguruar që prodhimet e tyre të dalin në treg. Gratë e shohin ushqimin si mundësinë e tyre për ta bërë pjesën e tyre gjatë luftës.

Gratë afgane në luftë kundër talebanëve

Në vitin që kur talebanët rimorën kontrollin e Afganistanit, dy dekada të fitimeve në punësimin dhe arsimimin e grave janë zhdukur. Gazetarët e Projektit Fuller kanë bashkëpunuar me

Rukshana Media, një redaksi afgane e udhëhequr nga gratë, për t'i dokumentuar realitetet e reja për gratë në Afganistanin e kontrolluar nga talebanët.

Talibanët kanë urdhëruar gratë të qëndrojnë në shtëpitë e tyre, kanë ndaluar gratë nga shumica e vendeve të punës dhe kanë bërë të detyrueshëm mbajtjen e shamisë për gratë në publik. Gratë, gjithashtu, nuk mund të udhëtojnë pa një mashkull.


Kufizimet e reja kanë kufizuar qasjen e grave në kujdesin shëndetësor, arsim dhe punë. OKB-ja tha se të ardhurat e humbura nga ndalimi i grave nga fuqia punëtore mund t'i kushtojnë Afganistanit deri në 5 për qind të PBB-së së tij, duke e zhytur vendin në varfëri më të thellë dhe duke përkeqësuar pasigurinë ushqimore.

Pavarësisht prej këtyre pengesave, disa gra afgane po protestojnë. Këto janë histori të grave që luftojnë për të drejtat, për veten dhe për të tjerët. Por ka ende për të reguar.



POEZI NGA XHEVDET BAJRAJ

nga libri Unaza e Saturnit, 2022



SYTË E SAJ

Po kërkoja diçka
për t'u kapur për jetën
qoftë ajo
edhe vetëm një fije kashte
a një rreze e fikur drite
dhe kështu
e zbulova poezinë
apo ajo më zbuloi mua

Se poezia kishte sytë e saj
e dikush duhej t'i përshkruante ata

AMANETI

E dashur
jam pakëz
vetëm pakëz i lodhur
nëse nuk do të jem më
kur të botohet ky libër
amanet
le të më varrosin me këpucë të mbathura
apo le të m'i lënë pranë kresë
a pranë këmbëve
se s'jam i marrë ta bëj as dhe një hap pa to
në të panjohurën
Atëherë kur ta kesh librin në duar
zbërtheji pullat e këmbëshës
dhe më afro mes gjinjve
dua të t'i dëgjoj të rrahurat e zemrës
tek më thonë
tash rrahim që ta mbajmë gjallë këtë plakë
që të mund të të sjellë mbi varr
ndonjë degë të njomë bliri

Ti e di se bliri i ka gjetet në formë zemre
apo jo
Nuk është koha për modesti

ZEMRA E ÇARË

Poeti
në dritaren e hapur
një mbrëmje të bukur vere
e këndonte me kitarë
një këngë të dhimbshme dashurie
se zemrën e kishte të çarë si pjepër
Fqinja që po e përgatiste darkën
në shtëpinë në të njëjtën lagje
tek po e dëgjonte
qante
e thithte gjakun nga gisht
që e kishte prerë
duke bërë sallatë me domate

UNAZA E SATURNIT

Jam më i lehtë se jeta
se kënga e jetës
mbaje derën e zemrës hapur
tekefundit
vetëm mos e mbyll me çelës
Është duke fryrë
nga dheu i kujtesës
mund të befasohemi për të mirë
një ditë
kur të më del gjumi i vdekjes
e unë të shfaqem para derës sate
me një cigare mes gishtërinjve
e tëra që do të më duhej do të ishte
një çakmak
një kafe
dhe gjysma e krevatit tënd

Për kompensim
do të ta dhuroja njërën nga unazat
e Saturnit

VAJZA E PUSHIMIT TË GJATË

Ajo ishte nëntë vjeçe
unë isha tetë vjeç
çdo pushim të gjatë në shkollë
mbështetej për muri
dhe fliste me shoqet e saj
Mungonin edhe dy vjet
për t'ia nisur duhanit
kështu që kisha kohë
t'ia hidhja ndonjë shikim
sa herë që
nuk ma tërhiqte vëmendjen
ndonjë shok

Një ditë të bukur e çuan në spital
dhe atje vdiq
që nga atëherë më askush nuk e pa
përveç meje
I kam gjashtëdhjetë vjet
dhe sa herë kaloj aty pranë
e shoh
të mbështetur për muri
e vetme
duke buzëqeshur

GRUAJA QË DI T'I TRAJTOJË LULET

Po pinim kafe
një ditë të bukur vere
dhe mezi po e dalloja
fytyrën e saj
nga tymi i cigares
kur më pyeti
ç'ke sot
nuk ke fjetur mirë
ke pirë shumë mbrëmë
Oh
thashë





mirë jam unë
por lulet e kopshtit
brenda meje
ankohen
janë të mërzitura
thonë që u mungon
erë e njeriut tjetër
Ajo buzëqeshi
u avit dhe më puthi
o Zot
sa më pëlqejnë femrat
që dinë të sillen me lule

KUR TI FLE UNË SHKRUAJ

E paramendoj që je duke fjetur
ndoshta edhe duke buzëqeshur në gjumë
prandaj
shkruaj vargje në qetësi
Jam i lumtur
se ende nuk ka lindur dielli
dhe se ty ende pa ngrënë mëngjes
nuk t'i ka përplasur
jargët e botës në fytyrë
të kësaj bote
në të cilën mollëve ka kohë që
u mungon
shija

Pra
kur ti fle
unë shkruaj
për ato që m'i ke mësuar
se kush jam
si ta shoh njeriun
e sëmurë
si ta trajtoj gjysmënjeriun
gjysmëkafshën
dhe
si të ec rrugës
që ma ke vizatuar
për te Zoti

TË LUTEM E DASHUR

E dashur
faleminderit shumë
që i hoqe këpucët
por aman
para se të hysh
përgjithmonë
në zemrën time
të lutem shumë
bëhu e mirë
hiqi edhe çorapët
fustanin
sytjenin
dhe brekët

Këtu bën vapë
si në ferr
e ti ke ardhur për të qëndruar
përgjithmonë

PEIZAZHI

Po e shikoja një film
në Netflix
në një çast
derisa personazhi kryesor
po kthehej në shtëpi
ecte mes për mes
një peizazhi aq të bukur
saqë e preka në pauzë
(ka disa muaj
vetëm peizazhe urbane
shoh)
Oh
e hapa një shishe verë
pastaj iu afrova ekranit
u mora erë luleve
i futa këmbët në lumë
e mora të dashurën për dore
vrapuam
vallëzuam
qeshëm
bëmë dashuri
pastaj duke e shikuar qiellin
na zuri gjumi



Kur u zgjova
ekrani ishte bërë i zi
e ndeza sërish
ishte i njëjti peizazh
por pa ne

NUK E DI SESI NDIHESH

Nuk e di sesi ndihesh
brenda poezisë sime
Mos ke nevojë
për më shumë diell
më shumë ajër
shi

Nuk është edhe aq vështirë
të kujdesesh për qengjat
që kanë lindur në vitin
që kurrë nuk e solli pranverën
dhe tash pranë përroit të jetës
kërcejnë përditë
rreth teje
derisa ti
në një copë qielli që e mban në prehër
e qëndis një ylber

Nesër është dita e parë
e Kurban Bajramit
do të të laj në përroin
që rrjedh brenda një poezie
do të ta fërkoj trupin
me lule të egra

GRUAJA E VESHUR ME TË ZEZA

Plumbi udhëtoi me shpejtësi
dhe e goditi mu në lule të ballit
njeriun që po ecte drejt ëndrrës së vet

U hap një varr
një grua u vesh me të zeza
mbi kokë e mbante një shami të bardhë
në duar e përkundte dhimbjen
sikur donte ta vente në gjumë
i jepte gji

Njeriu është si guri
më së shumti peshon në ëndrrën e vet

BUZËQESH

Pse t'u kanë shtuar
këto rrudha në fytyrë
a thua
kaq gjatë paskam munguar

Tash që do të çmallesh
buzëqesh
merre zemrën time
dhe fshij rrudhat e mallit me të

Pse e gjithë kjo heshtje
ne përnjëmend kemi vdekur
së jashtëmi
por përbrenda jemi
më gjallë se kurrë

Ma blej një akullore
ose një çamçakëz
nëse do të ta lexoj një poezi
që e kam shkruar për ty

Buzëqesh
nëse e ke më lehtë
ose unë po e vë buzën në gaz i pari
e ti ma kthe

DITË E SHTUNË

E zgjon alarmi
si çdo ditë të punës
Bië shi
vetura nuk i ndez
taksi i vonohet
laget
Kur më në fund mbërrin
para dverve të ndërtesës ku punon
e sheh që dyert janë të mbyllura
nuk sheh njeri
Mendon që ka ardhur herët
e nxjerr një cigare
e ndez dhe pret pret pret
e ulur në shkallë
Dikur i bie ndër mend
oh
do të vdesë
dhe kurrë nuk do ta harrojë
gëzimin që e përjetoi
më në fund
pas aq shumë kohe
se sot qenka ditë e shtunë
dhe se të shtunave nuk punohet

Niset për në shtëpi
me Zotin e ulur këmbëkryq
brenda zemrës së saj



BËNTE FTOHTË NË JETËN E TIJ

Bënte ftohtë shumë ftohtë në jetën e tij derisa e takoi një grua me një gazetë të vjetër nën sqetull që ia fali gazetën (pasi e hoqi faqen për kulturë) derisa po e shikonte në sy

Së pari i ngrohu duart në zjarrin e dashurisë se mërdhinte buzë çmendjes pastaj e nxori zemrën (m'u duk nga xhepi i këmishës) dhe ia fali

Ajo shkoi në shtëpi se e prisnin obligimet ky shkoi te pëllumbat e egër dhe e zuri gjumi të mbështjellë me gazetë (pa faqen për kulturë) dhe një buzëqeshje në fytyrë që kurrë më nuk iu hoq në jetë

GRUAJA NË MES TË RRUGËS SË ZOTIT

Një grua me një zog që i cicëron dhimbjes brenda kafazit të saj të krahavorit kurrë nuk duhet t'i kërkojë falje një burri asnjë burri sidomos nëse jeton në një qorrsoak të kujtimeve Një grua e cila netët i kalon në mes të shtrëngatës qan në gjumë si fëmijë e zgjohet në mes të natës të bëjë dashuri me njeriun e zi të Eseninit nuk ka nevojë t'i kërkojë falje kurrë një gruaje asnjë gruaje

Një grua me sy aq të gjallë që prapa syve mban të lidhur si shtazë diçka që madje mund ta tmerrojë dikë qoftë ajo edhe dashuria s'ka nevojë t'i kërkojë falje asnjë fëmijë as fëmijës së vet

Një grua ballëlartë në mes të rrugës së Zotit që shikon përpara me lehtësi arrin deri tek origjina dhe e shpëton shikimin e saj prej engjëlli Dhemb kjo por me rëndësi është se akoma mund të shkruajë letra dashurie dhe tash e mban këtë libër në duar

ËNDRRA E NJË DITE VERE

Gruan që i vinte nxehtë nga jeta e kishte befasuar gjumi lakuriq në pikë të ditës pranë librit me poezi me titullin Kur qajnë hardhitë

Nëpër dritaren e hapur të shtëpisë hyn tinëzisht një fllad veror ia përkëdhel flokët fytyrën gjinjtë belin bregun e Venerës këmbët I shfleton disa faqe të librit ndalet te një poezi pushon mes dy vargjeve pas pak del jashtë andej nga ka hyrë këtë herë duke e përplasur dritaren Gruaja nis të marrë frymë thellë dhe me shpejtësi shpejt e më shpejt dikur iu normalizua frymëmarrja buzëqeshte në gjumë

NË SOMA BOOK STATION

Ishte në SOMA pinte cigare në tarracë ndërsa po i digjnin sytë gruas që e kishte përballë e thirri me zë të lartë kamerierin ma sill një kriko të madhe kamerieri ia solli (shërbimi është i shkëlqyeshëm aty) Pastaj e mori edhe një kriko edhe një kriko edhe një Gruaja e pyeti me kureshtje ju pëlqen shumë birra jo moj u përgjigj bën vapë dhe po më thahet lulja e ballit po ashtu po më vdesin nga etja zogjtë e këmbëve Gruaja po e shikonte me habi I kam mësuar që kur isha i ri Heshtën një copë herë burrit papritmas ia nisën t'i këndojnë zogjtë e këmbëve dhe lulja e ballit filloi t'i çelë para syve të saj

HEMFRI BOGART

Hemfri Bogarti i sëmurë nga kanceri në shtëpinë e tij në Hollywood zbriti në katin përdhes nga lifti i vogël i kuzhinës dy shërbëtorë e bartën deri te kolltuku ai e mbante një gotë uiski në dorë i përshëndeti miqtë e tij që kanë ardhur për ta vizituar dhe gruas që i kishte sytë si dikush që me ta i recitonte poezitë nga libri Vitet që nuk e sollën pranverën i buzëqeshi ia mori dorën dhe ia puthi

Porositi edhe një gotë uiski dikur i erdhi radha këngës së dëshpërimit dielli kishte kohë që kishte perënduar

të njëjtët shërbëtorë e morën dhe e bartën deri në ashensorin e kuzhinës dhe e pritën në katin e tretë i shtrirë në krevat nuk rehatohej i dukej krevati i vogël e mori me të mirë ujkun që e bartte brenda vetes dikur e zuri gjumi atëherë doli ujku nga ëndrra e tij dhe iku në mal donte ta shihte zanën duke vallëzuar në dritë hëne para syve të tij të një engjëlli të çmendur brenda tij një plak i sëmurë dhe i dehur qante nga dashuria

BUZË VARRIT


Buzë një varri arnon ëndrra të shqyera kujtime të dëmtuara Del në gjah muajve që u mungojnë ditët i zë dhe i kthen i lidh që të mos ikin më nga kalendarët e vjetër që nuk i hyjnë më askujt në punë

I mbërthyer brenda një pranvere me një tufë lulesh në dorë e pret zanën të kthehet në varrin që e mban të hapur të bëjnë dashuri

NË QIELL

Kur e pa vdekjen për herë të parë iu fshi e tërë jeta e mëparshme E tash në qiell herë pas here copëza të jetës mbi tokë e fytyra e saj e buzëqeshur i kthehen si ëndrra të parajsës së humbur





AZIZ NESIN

KUJTIMET E NJË TË INTERNUARI

Në fushën e Bursës ngadalë po zbret pranvera. Jemi dy shokë të internuar. Kur dalim nga shtëpia në të cilën qën-drojmë me qira shkojmë dhe vijmë duke u dridhur rrugës së asfaltuar, e cila gjendet në mes të Setbashit dhe çarshisë së stacionit policor. Çdo mbrëmje shkoj në stacionin policor të çarshisë dhe nënshkruaj fletoret që gjenden aty.

Një mbrëmje dola nga stacioni policor së bashku me shokun tim. Atypari ndodhej një njeri rreth moshës njëzetvjeçare. Fillimisht mendova se është i njohshëm i shokut tim. E pyeta shokun tim se kush është duke i bërë isharet me sy. Ai duke ngritur njërin krah dhe duke rrudhur buzët tha: nuk e di.

Ne kemi paksa ngurrim. Nuk na pëlqen shumë të flasim me të huaj ngaqë nuk e dimë kush dhe çfarë janë. Djaloshi kishte një shikim shumë të mprehtë, sikur përpiquej ta lexojë brendinë e tjetrit.

- Ju, a mos jeni filani? - më pyeti.

- Po, - i thashë.

Më pas e pyeti edhe shokun tim. Edhe ai i tha po.

Ne jemi të internuar këtu, dhe rreth nesh kanë dalë shumë thashetheme, për këtë shkak djaloshi na mendon se jemi shefa të një organizate të fshehtë. Të them të drejtën, në sytë e tij unë jam në krye të një bande të fshehur të përhapur në Turqi, të cilët e kanë gjoksën e mbushur me fishekë, dhe ka komitë nën urdhrat e tij. Çfarëdo që t'i them, s'po mund ta bind djaloshin.

- Natyrisht, më thotë, organizata juaj është e fshehtë. Ju punoni tejet fshehur - më tha.

- Sigurisht që nuk mund t'ia shpjegojmë që ne punojmë fshehurazi - i thashë.

- Edhe unë dua të punoj në organizatën tuaj! - më tha.

I betohem e stërbetohem: për Zotin nuk ka një gjë të tillë! As organizatë, as punë fshehurazi nuk ka bre vëlla! Shikoje

njëherë gjendjen tonë.

Assesi nuk bindet.

- Natyrisht, natyrisht... sigurisht që duhet të visheni kështu në mënyrë që askush mos të dyshojë te ju.

Një bela e tillë që nuk mund të përshkruhet. Herët në mëngjes vjen papritur. Ne, në kohën kur ai vjen, jemi duke ngrënë mën-gjes. Pyet:

- A mermi para?

- Çfarë parash?

- A nuk ju vijnë para nga jashtë?

- Çfarë parash, bre vëlla?

- Për ta udhëhequr organizatën...

- A nuk e sheh se çfarë jemi duke ngrënë? A ha kështu ai që ka para?

- Natyrisht, natyrisht! - thotë. Duhet të dukeni kështu në mënyrë që mos ta kuptojnë të tjerët.

Në fakt, kishim edhe një tjetër arsye që nuk e donim atë. Mbase është turp ta them por, po e them. Djaloshi na bashkë-ngjitet në ushqimin tonë dhe ka apetit të shtuar. Ullinjte, të cilët ne i ndajmë për katër ditë, ai i ha në një mëngjes të vetëm.

Një ditë prej ditësh erdhi njëri nga Stambolli. Përmes tij, një mik yni na ka dërguar një pako. Sapo hapëm pakon, çfarë të shohësh! Një pulë e skuqur dhe një kuti bakllavë.

Derisa ne po shikonim me lakmi trokiti dera. Teksa unë po fshihja bakllavën dhe pulën në frigorifer, pronarja e shtëpisë e hapi derën. Djaloshi po ngjitej shkallëve.

- Përhëndetje! - na tha.

- Përhëndetje! - i thamë.

Djaloshi ndaloi dhe vështroi me kujdes.

- Ka diçka te ju! - tha.

- Çfarë ka?

- Keni diçka ju sot. Çfarë keni?

- Për Zotin nuk kemi asgjë!

- Keni, keni, por po e fshihni nga unë.

- Jo, për besë!

- Ju nuk më besoni mua. Sot ka një ndryshim te ju. Edhe pse kundërshtuam, assesi nuk bindej. Mendjen e kisha te pula dhe bakllava. Më rridhte lëng nga goja. Mendoja çfarë të bënim që ta largonim djaloshin nga shtëpia. Mbase për herë të dhjetë na tha ju po fshihni diçka nga unë. Duke bërë gjepte sikur me të vërtetë isha shef i një organizate të fshehtë, i thashë: Po, ka diçka që jemi duke fshehur nga ti. Shoku im i kishte zmadhuar sytë dhe po më shikonte.

- Por, sot do të të sqarojmë diçka - i thashë me zë kum-bues, me fytyrë të rrudhosur e me vetullat e ngritura.

- Deri më sot nuk të kemi dhënë detyrë në organizatën tonë të fshehtë. Sepse deri më tani organizata jonë të ka kontrolluar - hetuar. Tani ne të besojmë ty - i thashë.

- Faleminderit! - tha.

Këmbë e kokë ishte i koncentruar.


Tani do të të jap një zarf. Këtë zarf duhet ta lësh në zgavrën e blinit që gjendet në kopshtin e Xhamisë Jeshil. Edhe do të kthehesh pa shikuar mbrapa. Mos gabo ta hapësh zarfin dhe të shikosh mbrapa. Nuk është punë e shakasë. Kjo është organizatë nëntokësore. Mund të ketë edhe vdekje - i thashë.

Në zarfin e zbrazët që e mora mes librash që gjenden në korri-dor, vendosa një letër të pashkruar, e mbylla dhe ia dhashë.

- Vazhdo mos prit! Kjo punë është punë sekondash - thashë.

E mori zarfin dhe shkoi fluturimthi. Ne shtruum tavolinën dhe menjëherë i përfunduam pulën e bakllavanë. Nuk e kujtoj që ndonjëherë në jetën time të kem ngrënë ushqim kaq të hare-shëm.

përktheu nga turqishtja: Fatijona Bajraj



GEORGE ORWELL

POLITIKA DHE GJUHA ANGLEZE

Shumica e njerëzve që shqetësohen për këtë çështje do ta pranonin se gjuha angleze është në një gjendje të keqe, por mbizotëron mendimi i përgjithshëm se asgjë nuk është në dorën tonë për ta ndryshuar për këtë gjendje. Qytetërimi ynë është në rënie dhe gjuha jonë, sipas këtij arsytimi, s'mund të mos jetë në mënyrë të pashmangshme pjesë e këtij rrënim të përgjithshëm. Rrjedhimisht, çdo luftë kundër shpërdorimit të gjuhës është diçka e vjetruar dhe e ndikuar nga ndjenjat, si të parapëlqesh qirinjtë në vend të dritës elektrike ose karrocën në vend të aeroplanëve. Ajo mbështetet në një bindje për të cilën janë gjysmë të vetëdijshëm se gjuha zhvillohet në mënyrë të natyrshme dhe nuk është një mjet të cilin e formësojmë sipas qëllimeve tona.

Tani është e qartë se zvetërimi i një gjuhe në fund të fundit ndodh për shkaqe politike dhe ekonomike: nuk ndodh thjesht prej ndikimit të keq të një shkrimtari të veçantë. Por një pasojë mund të kthehet në shkak duke përforcuar shkakun burimor dhe duke krijuar të njëjtën pasojë, madje edhe më të rëndë, e kështu me radhë, pafundësisht. Mund të

jepesh pas pijeve dehëse ngaqë mendon se je dështak, dhe pastaj dështimi është shumë më i madh sepse je i dhënë pas pijes. Pak a shumë kjo po ndodh me gjuhën angleze. Po shëmtohet dhe po bëhet e pasaktë, sepse mendimet tona janë pa kuptim, por përshtjellimi i gjuhës na e bën më të lehtë të kemi mendime pa kuptim.

Çështja është se ky proces mund ta marrë drejtimin e kundërt. Anglishtja moderne, sidomos ajo e shkruar, është plot me shprehje të këqija që janë përhapur me anë të imitimit dhe të cilat mund të shmangen nëse kemi vullnetin të bëjmë atë që duhet. Nëse heqim dorë nga këto shprehje, do të mund të mendojmë më qartë, dhe të menduarit qartë është hapi i parë i domosdoshëm drejt ripërtëritjes politike: në mënyrë që lufta kundër anglishtes së keqe të mos jetë thjesht në dukje dhe shqetësim i posaçëm vetëm i shkrimtarëve profesionistë. Do t'i rikthehem kësaj çështjeje pak më vonë dhe shpresoj që deri atëherë domethënia e asaj që kam shprehur këtu të jetë bërë më e qartë. Ndërkohë, ja ku kemi pesë gjedhe të gjuhës angleze siç shkruhet më shpesh sot.

Këto pesë pjesë shkrimesh nuk

janë zgjedhur sepse janë veçanërisht të dobëta - mund të kisha zgjedhur pjesë shumë më të dobëta po të doja, por janë zgjedhur sepse sjellin shembuj të ndryshëm të veseve të këqija mendore që tashmë kemi marrë. Janë pak në nivelin mesatar, por janë shembuj mjaft përfaqësues. I kam shënuar me numra në mënyrë që të jetë e lehtë t'i citoj sërish kur të jetë e nevojshme:

"Nuk jam, në të vërtetë, i sigurt nëse nuk është e vërtetë të thuhet se ai Milton,¹ i cili më parë nuk dukej i pangjashëm me një Shelli² të shekullit të shtatëmbëdhjetë, nuk ishte bërë për shkak të një përvoje që bëhej gjithnjë e më e hidhur vit pas viti, më i huaj për themeluesin e atij sekti Jezuit, të cilin asgjë nuk mund t'ia mbushte mendjen për ta toleruar".

Profesor Harold Laski,³ (ese e botuar në *Freedom of Expression (Liria e shprehjes)*).

"Para së gjithash, nuk mund të bëjmë petulla me ujë me një sërë idiomash amtare që krijojnë bashkëvendosje të tilla të stërholluara fjalësh, siç janë thënie me të thjeshta si: "i bëj ballë" në vend të "duroj" ose "humb toruan" për "hutohem".

Profesor Lancelot Hogben⁴ (*Interglossa*).

"Nga njëra anë kemi personalitetin e lirë: sipas përkufizimit nuk është neurotik, ngaqë nuk ka as konflikt dhe as ëndrra. Dëshirat e tij, ashtu si janë, janë transparente, ngaqë janë vetëm ato që miratimi institucional i mban në vijën e parë të vetëdijes; një tjetër model institucional do ta ndryshonte numrin dhe dendësinë e tyre; ka pak gjë në to që është e natyrshme, e pashndërrueshme ose kulturalisht e rrezikshme. Por, nga ana tjetër, lidhja sociale nuk është asgjë tjetër përveçse reflektim reciprok i këtyre parimeve morale të vetësigurta. Kujtoni përkufizimin e dashurisë. A nuk është kjo vetë figura e një akademiku të vogël? Ku paska vend në këtë sallë pasqyrash qoftë për personalitet qoftë për vëllazëri?"

Ese mbi psikologjinë botuar në revistën *Politics (Politika)*, Nju-Jork.

"Të gjithë "njerëzit më të mirë" nga klubet e xhentëlmenëve dhe të gjithë komandantët e tërbuar fashistë, të bashkuar nga urretja e përbashkët ndaj socializmit dhe nga tmerri shtazarak prej valës në

rritje të lëvizjes masive revolucionare, u janë kthyer akteve të provokimit, për t'i hedhur benzinë zjarrit, me anë të legjendave mesjetare të puseve të helmuara, për ta përligjur shkatërrimin e organizatave të tyre proletare dhe për ta yshtur borgjezinë e vogël e cila është e zemëruar duke nxitur ethet e tyre shoviniste në emër të luftës kundër rrugës revolucionare të daljes nga kriza".

Pamflet komunist.

(5) "Nëse një frymë e re *do të duhej* të futej në këtë vend të lashtë, është një reformë e mprehtë dhe problematike që duhet trajtuar, dhe ai është humanizimi dhe galvanizimi i BBC-së. Ndruajtja në këtë rast do ta paralajmëronte kalbëzimin dhe atrofizimin e shpirtit. Zemra e Britanisë mund të jetë e fortë dhe të rrahë fuqishëm, bie fjala, por hungërima e luanit britanik aktualisht është si ajo e Botëmit⁵ në komedinë *Ëndrra e një nate vere* të Shekspir - e butë si e çdo pëllumbthi. Një Britani e re, burrërore, nuk mund të vazhdojë pafundësisht të përgojohet në sytë ose, më mirë të themi, në veshët e botës nga lëngata e rëndë e Pallatit Langëm,⁶ paturpësisht e paraqitur



si maskaradë e “anglishtes standarde”. Kur dëgjohej *Zëri i Britanisë* në orën nëntë, tejet më mirë dhe pambarimisht më pak qesharake është të dëgjosh “h-të”⁷ e pashqiptuara ndershmërisht sesa mjaullimat djallëzore, të fryra, të sforcuara, prej lëneshash pedante, kinse të pafajshme dhe të turpshme!”

Letër e dërguar në gazetën *Tribune (Tribuna)*.


Secila nga këto pjesë ka të metat e veta por, po ta lëmë mënjanë faktin se kanë një shëmti e cila mund të shmangej, dy cilësi janë të përbashkëta për të gjitha. E para është përdorimi i imazheve bajate; tjetra është mungesa e saktësisë. Autori i tekstit ose ka një mendim që s’e shpreh dot, ose thotë diçka tjetër pas dashur ta bëjë këtë, ose deri-diku as që do t’ia dijë nëse kanë apo s’kanë kuptim fjalët e tij. Kjo përzierje e paqartësisë dhe e mungesës së plotë të aftësisë është tipari më i theksuar i prozës së sotme në anglisht, veçanërisht i çdo lloj shkrimi politik. Sapo hapet një temë e caktuar, konkretja bëhet njësh me abstrakten dhe gati askush nuk është në gjendje të mendojë më, sepse gjuha e përdorur është e stërpërsëritur: proza ka gjithnjë e më rrallë fjalë të zgjedhura për kuptimin e tyre dhe gjithnjë e më shpesh fraza të bëra tok si blloqe parafabrikat. Më poshtë po radhis, me shënime dhe shembuj, marifetet e ndryshme me anë të të cilave autorët e shmangin prozën e mirëfilltë.

Metafora që po vdesin. Një metaforë e sapokrijuar e ndihmon të menduarit duke ngjallur në mendje një imazh pamor, ndërsa nga ana tjetër një metaforë që është teknikiisht “e vdekur” (p. sh. *vendosmëri e hekurit*) në të vërtetë është kthyer në një fjalë të zakonshme dhe në përgjithësi mund të përdoret pa e humbur gjallërinë. Por në mes të këtyre dy kategorive ka një moçal të madh metaforash të stërpërdorura të cilat e kanë humbur plotësisht fuqinë tërheqëse dhe përdoren thjesht vetëm e vetëm se ua heqin përdoruesve të tyre mundimin për të krijuar vetë shprehje. Ja disa shembuj: *Bëhet promotor i ndryshimit, dal në mbrojtje të, të jesh gjithmonë gati, t’i biesh në qafë, rri krah për krah me, bëj lojën e, si ua do puna, çoj ujë në mullirin e lundron në ujëra të turbullta, i vë kazmën miqësisë, sipas interesit të ditës, thembra e Akilit, kënga e mjellmës, vatër konflikti.* Pjesa më e madhe përdoren pa ua ditur domethënien (çfarë do të thotë “t’i vësh kazmën”, për shembull?), dhe shpesh përzihen metafora të papajtueshme, një shenjë e sigurt se autori nuk do t’ia dijë për atë që thotë. Disa metafora të përdorimit të sotshëm kanë domethënie tjetër për tjetër nga ai zanafillori dhe ata që i kanë përdorur as që kanë qenë të vetëdijshëm për këtë ndryshim. Për shembull *gjithmonë gati* nganjëherë shkruhet *kurdoherë gati*. Një shembull tjetër është *si kudhra dhe çekani*, tani përdoret

gjithmonë me nënkuptimin se kudhra është më e dobët. Në jetën reale është gjithmonë kudhra ajo që thyen çekanin, asnjëherë e kundërta: ai autor që s’u ndal për të menduar se çfarë po thoshte do ta kishte parandaluar shtrembërimin e kuptimit të vërtetë të kësaj shprehjeje.

Foljet ndihmëse ose gjymtyrët foljore të rreme. Ato të shpëtojnë nga telashi i zgjedhjes së foljeve dhe emrave të duhur, në të njëjtën kohë shtojnë artificialisht në çdo fjali rrokje të cilat vetëm në dukje krijojnë simetri. Disa shprehje tipike janë: e bën jofunksional, fakte që flasin kundër, e bën të papranueshme, vendos lidhje me, nënshtrohet ndaj, bëhet shkak për, bëhet shkas për, kanë ndikim në, luan rol kryesor në, bën që të ndjehet, *hy në veprim*, shfaq prirje për të, i shërben qëllimit të etj. Ideja kryesore e këtij marifeti është shmangia e e foljeve të thjeshta. Në vend të një fjale të vetme, si: *prish*, ndaloj, *prish*, ndreq, vras, një folje bëhet *shprehje*, e përbërë prej një emri ose mbiemri që i ngjitet një foljeje të përgjithshme si *bëj, shërbej, përbëj, luaj, shndërroj*. Gjithashtu, diateza pësore parapëlqehet të përdoret kudo që të jetë e mundshme në vend të diatezës veprore, dhe struktura emërore përdoren në vend të emrit foljor (*me anë të shqyrtimit të në vend të duke shqyrtuar*). Gama e foljeve tkurret edhe më tej me anë të përmes prapashtesave *-izoj* dhe *de-*, dhe thënie banale krijojnë përshtypjen e thellësisë me anë të strukturave të tilla si *jo pa*. Lidhëza dhe parafjalë të thjeshta zëvendësohen me shprehje të tilla si: *në lidhje me*, për sa ka të bëjë me, *fakti është se*, me anë të, duke pasur parasysh, *për të mirën e, duke pranuar hipotezën se*, dhe fundet e fjalive u hiqet mundësia e ndonjë mbylljeje që s’është mbresëlënëse dhe kumbuese si shprehjet: *mezi pritet të, nuk mund të mos kihet parasysh se, një zhvillim i pritshëm në të ardhmen e afërt, që meriton konsideratë serioze, arrin në një përfundim të kënaqshëm, e kështu me radhë.*

Mënyra pompoze e të shprehurit. Fjalët si *fenomen, element, individ, objektiv, kategorik, i efektshëm, virtual, bazik, kryesor, promovoj, konstituoj, ekspozoj, shfrytëzoj, utilizoj, eliminoj, likuideoj*, përdoren që gjykimet e njëanshme të mbështillen me lëvizshmëri e rreme të paanësisë shkencore. Mbiemrat si *epokë-krijues, epik, historik, i paharrueshëm, triumfues, shekullor, i pashmangshëm, i paepur, i vërtetë*, përdoren për të bërë të duken madhështore proceset e ndyra të politikës ndërkombëtare, ndërsa të shkruarit që synon ta himnizojë luftën rëndom merr ngjyresa të lashtësisë, me fjalë tipike si: *mbretëri, fron, koçi, grusht i hekurit, sfurk, mburojë, stemë, bajrak, çizme (me qafat mbi gju), bori, kushtrim*. Fjalët dhe shprehjet e huaja si: *cul de sac, ancien régime, deus ex machina, mutatis mutandis, status quo, geichschaltung, weltan-*



schauung përdoren për t’i dhënë një frymë kulture dhe elegance. Përveç shkurtësive me vlerë (d.m.th., p.sh. dhe etj.) nuk është fare e nevojshme të përdoret asnjëra prej qindra shprehjeve të huaja që i gjen sot në gjuhën angleze. Ata që janë të dobët në të shkruarit, dhe sidomos autorët e shkrimeve shkencore, politike, dhe sociologjike, dëshmojnë se thuajse gjithmonë kanë të tiposur në mendje idenë se fjalët latine a greke janë më madhështore se ato saksone, dhe fjalë të panevojshme si *ekspeditoj, perfeksionoj, prediktoj, irrelevant, i spostuar, klandestin, sub-akuatik, dhe qindra të tjera* ua zënë vendin pareshur barasvlerësve të tyre anglo-saksone.⁸ Zhargoni tipik për shkrimet marksiste (hienë, xhelat, kanibal, borgjezi e vogël, të ashtuquajturit zotërinj, lakëj, shërbëtorë, laro, reaksionarë etj.) në pjesën më të madhe përbëhet prej fjalësh dhe shprehjesh të përkthyer nga rusishtja, gjermanishtja, ose frëngjishtja; por mënyra e rregullt e fjalëkrijimit është përdorimi i rrënjës latine ose greke me prapashtesën e duhur dhe, kurdo që është e nevojshme, prapashtesa *-izoj*. Shpesh është më e lehtë të trillosh fjalë të këtij lloji (deregjionalizoj, i palegjitimuar, ekstra-matrimonial, jofragmentar e kështu me radhë), sesa të kujtosh fjalët anglisht që shprehin të njëjtin kuptim. Si pasojë, në përgjithësi, teksti bëhet më i pështjelluar dhe i paqartë.

Fjalët e pakuptimta. Në disa lloje tekstesh të shkruara, sidomos në tekstet e kritikës së artit dhe të kritikës letrare, është normale të hasësh pjesë të gjata që iu mungon gati plotësisht kuptimi.⁹ Fjalë të tilla si: romantik, plastik, vlera, human, i vdekur, sentimental, i natyrshëm, jetik, siç përdoren në kritikën e artit, janë absolutisht të pakuptimta, meqë jo vetëm se nuk shenjojnë ndonjë gjë që mund të

zbulohet, por edhe lexuesi vështirë se pret që ta bëjnë këtë. Kur një kritik shkruan: “Tipari i jashtëzakonshëm i veprës së aksh autori është ndjesia e gjallë që krijon”, ndërsa një tjetër shkruan: “Gjëja goditëse e veprës e aksh autori sapo e kap në duar është ndjesia e të vdekurës që krijon”, lexuesi e pranon këtë thjesht si ndryshim mendimesh. Po të përdoreshin fjalë si “bardh” e “zi” në vend të fjalëve zhargon “i vdekur” dhe “i gjallë”, ai do ta kuptonte menjëherë se gjuha e përdorur nuk është e duhura. Shumë fjalë politike shpërdoren në mënyrë të ngjashme. Fjala “fashizëm” s’ka kurrfarë kuptimi, përveçse shenjon “diçka të padëshirueshme”.

Secila nga fjalët *demokraci, socializëm, liri, patriotik, realist, drejtësi* ka disa kuptime të ndryshme që s’pajtohen me njëra-tjetrën. Në rastin e një fjale si *demokraci* jo vetëm që s’ka përkufizim me të cilin bihet njëzëri dakord, por edhe përpjekja për të pasur një të vetëm kundërshtohet nga të gjithë. Ekziston një ndjesi gati e përbotshme se kur e quajmë një vend *demokratik* po e lavdërojmë: rrjedhimisht, mbrojtësit e çdo lloj regjimi mëtojnë të jenë demokraci, dhe kanë frikë se do t’u duhet të mos e përdorin këtë fjalë po të lidhej me një kuptim të vetëm. Fjalët e këtij lloji përdoren shpesh në mënyrë të pandershme me vetëdije të plotë. Domethënë, ai që i përdor ka një përkufizim vetjak, por e lejon dëgjuetin të mendojë se folësi nënkupton diçka krejt tjetër. Deklarata të tilla si: *Marshalli Pétain ishte një patriot i vërtetë, Shtypi sovjetik është më i liri në botë, Kisha Katolike është kundër persekutimit*, bëhen gati gjithmonë me qëllimin për të gënjyer. Fjalë të tjera që përdoren me domethënie të ndryshme, në shumicën e rasteve deri-diku në mënyrë të pandershme, janë: *klasë*

shoqërore, totalitarizëm, shkencë, përparimtar, reaksionar, borgjezi, barazi.

Tani që e kam krijuar këtë katalog marifetesh dhe zvetënimesh, më lejoni të jap edhe një shembull tjetër se çfarë lloji proze të katandisin të shkruash. Kësaj radhe shembulli do të jetë i trilluar. Do ta përkthej një pjesë të shkruar mirë në anglisht - në anglishten e sotshme të llojit më të keq. Ja një strofë e mirënjohur nga Predikuesit [një nga librat e Biblës] 9:11:

Vëzhgova e pashë nën diell edhe këtë: s’e fitojnë vrapimin të shpejtët, as të fortët luftën, as të urtët bukën, as të diturit pasurinë, as të maturit përkrahjen, por gjithçka sjell koha e rastit.

Ja tek e keni në anglishten e sotme:

Vlerësimet objektive të fenomeneve bashkëkohore diktojnë konkluzionin se suksesi ose dështimi në aktivitetet konkurruese nuk ekspozojnë asnjë tendencë për të korresponduar me kapacitete të lindura, por se një element i konsiderueshëm i të paparashikueshmes duhet marrë parasysh në mënyrë konstante.

Kjo është parodi, por nuk e kemi tepruar aspak. Fragmenti numër 3 më sipër, për shembull, përmban disa mballoma të një anglishteje të këtyllë. Do të shihet se nuk kam bërë një përkthim të plotë. Fillimi dhe fundi i fjalisë e ndjekin domethënien zanafillore deri-diku me përpikëri, por në mes të shembujve (ilustrimeve) konkrete - gara, beteja, buka - treten në shprehje të paqarta “suksesi ose dështimi në aktivitetet kompetitive”. M’u desh ta bëja kështu, sepse asnjë shkruer i sotshëm i llojit që po diskutoj, dhe që përdor shprehje si: “konsiderata objektive të fenomeneve kontemporane” - nuk është i zoti t’i rendisë mendimet e veta në mënyrë të përpiktë dhe të hollësishtme. E gjithë prirja e prozës së sotme është larg konkretës. Tash, le



t'i analizojmë dy fjalitë pak më hollësisht.¹⁰ E para përmban 38 fjalë, por vetëm 60 rrokje: të gjitha fjalët janë të përdorimit të përditshëm. E dyta¹¹ përmban 38 fjalë dhe 90 rrokje, 18 prej tyre janë me rrënjë latine, dhe një prej greqishtes. Fjalja e parë përmban gjashtë figura të gjalla, dhe vetëm një frazë ("koha e rasti") që do mund të quhej e paqartë. Fjalja e dytë nuk përmban asnjë frazë të freskët, mahnitëse, dhe pavarësisht 90 rrokjeve thjesht jep një version të shkurtuar të domethënies që përmban e para. Sidoqoftë, pa dyshim, është lloji i dytë i fjalisë që po zë gjithnjë e më shumë hapësirë në anglishten e sotme. Nuk dua ta teproj. Ky lloj shkrimi nuk është ende i përgjithshëm, dhe ka shenja thjeshtësie aty-këtu qoftë edhe në faqen e shkruar në mënyrën më të keqe të mundshme. Megjithatë, po të na thoshin mua dhe ty të shkruanim disa rreshta për pasigurinë e fateve njerëzore, ne me gjasë do t'i afrohem më shumë fjalisë time të përfytyruar sesa asaj të Predikuesve.¹²

Siç jam përpjekur të tregoj me shembuj, shkrimi në kohën e sotme në formën e tij më të keqe nuk përbëhet prej fjalësh të zgjedhura për hir të domethënies dhe figurave të krijuara për ta qartësuar kuptimin. Përbëhet nga gjithfarë fjalësh të ngjitura tok, të cilat tashmë i ka të renditura nga dikush tjetër, duke përdorur më parë broçkulla të tilla. Kjo mënyrë të shkruari është tërheqëse sepse është e lehtë. Është shumë më e lehtë, madje s'të merr fare kohë, sapo ta krijosh shprehinë të thuash: *sipas mendimit tim, nuk është supozim i pajustificueshëm të thuash se...* në vend që të thuash: *"Mendoj se"*. Nëse përdor fraza të gatshme, jo vetëm që nuk të duhet

të kërkosh të gesh fjalë, por s'të duhet as të lodhesh të krijosh ritëm brenda fjalisë meqë këto fraza përgjithësisht fjalë i kanë renditur aq mirë sa tingëllojnë deri-diku bukur. Kur shkruan me nxitim, - kur i dikton një stenografi, për shembull, ose mban fjalim publik - është e natyrshme të rrëshqasësh në një stil pompoz, të latinizuar.

Shprehje si "*një konsideratë që do të bënim mirë ta mbajmë mirë parasysh*" ose "*një konkluzion të cilin do ta pranoni të gjithë pa asnjë dilemë*" do ta shpëtonte fjalinë pa ia përplasur lexuesit në fytyrë. Duke përdorur metafora, krahasime, dhe idioma bajate, kursen goxha mund mendohet, por në kurriz të një domethënieje të paqartë, jo vetëm për lexuesin, por edhe për vete. Këtë bëjnë metaforat e përziera. I vetmi qëllim i një metafore është të ngjallë një përfytyrim pamor. Kur këto përfytyrime përplasen - si në rastin "Oktapodi fashist ka kënduar këngën e mjellmës, *çizmja e pushtuesit ka përfunduar në kazanin e historisë*, - mund jemi të sigurt se shkruesi nuk po sheh një imazh pamor të gjërave që po i emërton; me fjalë të tjera, në të vërtetë nuk po mendon. Shihini përsëri shembujt e dhënë në fillim të kësaj eseje. Profesor Laski (1) përdor pesë pjesëza mohuese në 53 fjalë. Njëra prej tyre është e panevojshme, dhe e bën krejt fragmentin të pakuptimtë. Më tutje, ndodh lajthitja - përdoret "i huaj" për "i ngjashëm" - gjë që e bën edhe më të pakuptimtë tekstin, ndërsa hasim dhe disa raste të shmangshme ngathësie që e shtojnë paqartësinë e përgjithshme. Profesor Hogbeni në shembullin numër 2 "luan me petulla në ujë me një sërë idiomash që janë në gjendje të japin

udhëzime" dhe, teksa shpreh mosmiratimin e shprehjes së përditshme "i bëj ballë", nuk e ka vullnetin të shohë në fjalor se çfarë kuptimi ka "i stërholluar". Shembulli 3, nëse nuk mbajmë një qëndrim bujar ndaj tij, është thjesht pa kuptim: ka gjasë të nxirret kuptimi i synuar vetëm duke lexuar të gjithë artikullin nga është marrë. Në shembullin 4, shkruesi e di pak a shumë se çfarë do të thotë, por një grumbullim shprehesh bajate e ngulfat ashtu sikur ndodh kur gjetet e çajit bllokujnë lavamanin. Në shembullin 5, fjalët dhe kuptimi gati sa s'ia kanë kthyer shpinën njëri-tjetrit. Ata që shkruajnë në këtë mënyrë zakonisht kanë një mendim të përgjithshëm emocional - nuk e duan një gjë dhe duan të shprehin solidaritet me një gjë tjetër - por nuk u interesojnë hollësitë e asaj që po thonë. Një shkrimtar me skrupuj, në çdo fjalë që shkruan, i bën vetes së paku katër pyetje:

Çfarë dua the them?

Cilat fjalë do ta shprehin?

Çfarë imazhi ose idiome do ta bëjë më të qartë?

A është ky imazh i freskët sa duhet për të pasur efekt?

Dhe ka gjasë që t'i bëj vetes edhe dy pyetje të tjera:

A mund ta them më shkurt?

Mos kam thënë ndonjë gjë të shëmtuar që mund ta shmang?

Por nuk ju detyron kush t'i nxirri vetes kaq shumë telashe. Mund t'u bëni bisht këtyre pyetjeve thjesht duke mos e varur mendjen dhe duke u hapur udhë frazave të gatshme që të dynden pa pushim. Ato do të ta bëjnë fjalinë në vendin tënd - madje edhe do të mendojnë për ty deri-diku dhe, po të jetë nevoja, do të bëjnë një shërbim të


rëndësishëm duke fshehur pjesërisht kuptimin madje edhe prej teje. Dhe te kjo pikë bëhet e qartë lidhja e posaçme midis politikës dhe zhvlerësimit të gjuhës.

Në kohën tonë është mëse e vërtetë që shkrimi politik është shkrim i keq. Kur kjo nuk është e vërtetë, përgjithësisht shkruesi është një lloj rebeli që shpreh mendime vetjake dhe jo të "vijës së partisë". Mendimet dogmatike, të çfarëdo ngjyre qofshin, duket se kërkojnë një stil të pajetë, imitues. Zhargonet politike që gjenden në pamflete, kryeartikuj, manifeste, dokumente qeveritare, dhe në fjalimet e përgatitura nga sekretarët, ndryshojnë, sigurisht, nga partia në parti, por e përbashkëta e tyre është se gati asnjëherë nuk gjen shprehje të freskëta, të gjalla, të krijuara vetë.

Kur sheh një shkarrashkrues të lodhur në tribunë që përsërit mekanikisht shprehjet e njohura: "*mizori shtazarake, thembra e hekurt, tirani që i ka duart e zhytura në gjak, popujt e lirë të botës, krah për krah*" - shpesh ke ndjesinë e çuditshme që nuk je duke parë një njeri të gjallë, por ndonjë lloj kukulle me pamje njeriu: ndjenjë që papritmas bëhet edhe më e fortë në çastin kur drita bie mbi syzet e folësit dhe i kthen ato në disqe të zbrazëta që duken sikur s'kanë sy pas tyre. Dhe kjo s'është aspak fantazi. Një folës që përdor këtë lloj frazeologjie ka bërë jo pak për ta shndërruar veten në makineri. Nga gurmazi i dalin zhurmat e duhura, por s'e ka vënë trurin në punë, gjë që do të ndodhte nëse do t'i kishte zgjedhur vetë fjalët për vete. Nëse fjalimi që po mban pasqyron çfarë është mësuar të bëjë sa e sa herë, ka gjasë të jetë gati i pavetëdijshëm për atë

që po thotë, ashtu si është dikush që i murmurit fjalët në kishë. Dhe kjo gjendje e vetëdijes së rrëguar, nëse nuk është e domosdoshme, në çdo rast është e përshtatshme për konformizmin politik.

Në kohën tonë fjalimi dhe shkrimi politik janë kryesisht mbrojtje e të pambrojtshmes. Gjëra si vijimi i sundimit britanik në Indi, spastrimet dhe internimet ruse, hedhja e bombave atomike në Japoni, në të vërtetë mund të mbrohen, por vetëm me argumente që për shumicën e njerëzve janë shumë të panjerëzishme t'i përballosh, dhe të cilat nuk përputhen me synimet që predikojnë partitë politike. Prandaj, gjuha politike është e detyruar të përbëhet në pjesën më të madhe prej eufemizmave, premisave të paracaktuara dhe paqartësive krejt të mjegullta. Fshatra të pambrojtura bombardohen nga ajri, banorët dëbohen drejt maleve e fushave, gjëja e gjallë qëllohet me mitraloz, kasolleve u vihet zjarri me plumba ndezës: kjo quhet paqësim i gjendjes. Miliona fshatarëve u plaçkiten feramat, nxirren me forcë në rrugë me aq sa mund të mbajnë në duar; kësaj i thonë *shpërngulje e popullsisë ose korrigjim i kufijve*. Njerëzit burgosen për vite me radhë pa gjyq, vriten me plumb pas qafe, ose çohen të vdesin nga skorbuti në kampet e lëndës drusore në Arktik: kjo quhet *eliminim i elementëve të dyshimtë*. Një frazeologji e tillë lypset kur do t'i përmendësh gjërat pa ngjallur imazhet e tyre mendore. Përfytyrojeni, për shembull, një profesor anglez që i patrazuar mbron totalitarizmin rus. Ai s'mund të thotë troç: "Unë besoj se me vrasjen e kundërshtarëve politikë mund të kesh pasoja të





mira nëse e bën këtë". Prandaj, ka gjasë që të shprehet pak a shumë kështu: "Duke pranuar hapur se regjimi sovjetik ka disa tipare që humanitarët mund të jetë të prirë t'i dënojnë, na duhet, mendoj, të biem dakord që një kufizim i caktuar i së drejtës së opozitës politike është një element i pashmangshëm shoqëruar i periudhave kalimtare, dhe se masat e rrepta të cilave popullit rus i është dashur t'u nënshtrohet kanë qenë më se të përligjura në fushën e arritjeve konkrete".

Stili i fryrë është në vetvete një lloj eufemizmi. Një shtresë fjalësh latine bie mbi faktet si borë e butë, duke i turbulluar pamjet dhe duke i fshehur të gjitha hollësitë. Armiku i vërtetë i gjuhës së qartë është mungesa e sinqeritetit. Kur ka një hendek mes qëllimeve të vërteta dhe qëllimeve të shpallura, në mënyrë instiktive përdoren fjalë të gjata dhe idioma të stërpërdorura, si një sfungjer që të spërkat me bojë. Në epokën tonë nuk ka diçka të tillë si: "t'i rrih larg politikës". Të gjitha çështjet janë çështje politike dhe vetë politika është një grumbull i madh gënjeshttrash, shtrembërimesh, marrëzish, urrej-tjesh, dhe skizofreni. Kur atmosfera e përgjithshme është e keqe, gjuha është ajo që në mënyrë të pashmangshme vuan. Ma merr mendja, - ky është thjesht hamendësim, meqë s'kam dijeni të mjaftueshme për ta vërtetuar - se gjuhët gjermane, ruse, e italiane janë përkeqësuar të gjitha gjatë këtyre dhjetë apo pesëmbëdhjetë viteve të fundit si pasojë e diktaturës.

Por nëse mendimi e korrupton gjuhën, edhe gjuha mund ta korruptojë mendimin. Një përdorim i keq mund të përhapet nëpërmjet traditës dhe imitimit, edhe mes njerëzve që duhet dhe dinë më shumë. Gjuha e zhvlerësuar për të cilën po flas është një farë mënyre shumë e volitshme. Frazja si: "një supozim jo i papërligjur, lë shumë për të dëshiruar, nuk do t'i shërbente kurrfarë qëllimi të mirë, një konsideratë e cila lëpsat mbajtur mirë parasysht", janë tundim i përhershëm, një paketë aspirinash që i mbajmë gjithmonë te kryet. Kthejuni shembujve në këtë ese, dhe me siguri do të zbuloni se edhe unë vetë kam bërë në mënyrë të përsëritur pikërisht ato gabime ndaj të cilave po shpreh mospajtimin tim.

Në postën e këtij mëngjesi më erdhi një pamflet që merrej me gjendjen në Gjermani. Autori më tregon se "ishte ndër i detyruar" të shkruante. E hap rastësisht, dhe ja ku është fjalia më e parë që më kapin sytë: "(Aleatët) kanë mundësinë jo vetëm për të kryer një transformim radikal të strukturës shoqërore dhe politike të Gjermanisë në një mënyrë që të shmangë një reagim nacionalist në vetë Gjermaninë, por në të njëjtën kohë të hedhë themelet e një Evrope bashkëpunuese dhe të bashkuar".

E shihni, ishte "ndier i detyruar"

të shkruante - u ndie, na e merr mendja, se ai ka diçka të re për të thënë - por prapëseprapë fjalët e tij, prapë si kuaj të kavalerisë që turren pasi jepet kushtrimi, vetvetiu mblidhen grumbull në kallëpe të zakonshme dhe të mërziatshme. Pushtimi i mendjes me fraza të gatshme (për t'i hedhur themelet, për të arritur një transformim radikal) mund të parandalohet vetëm nëse autori është vazhdimisht syçelët ndaj tyre, sepse çdo frazë e tillë i bën anestezë një pjese të trurit.

Thashë më parë se zvetënim i gjuhës sonë mund të jetë sëmundje e shërueshme. Ata që e mohojnë këtë do të argumentonin, nëse do të gjenin një argument, se gjuha thjesht pasqyron gjendjet ekzistuese shoqërore, dhe se ne nuk mund të ndikojmë në zhvillimin e saj përmes asnjë veprimi përmirësues me fjalë dhe struktura fjalësh. Nëse kemi parasysht tonin ose frymën e përgjithshme të një gjuhe, mund të jetë e vërtetë, por nuk është e vërtetë kur flasim për hollësitë e një gjuhe. Fjalë dhe shprehje pa kuptim shpesh janë zhdukur nga përdorimi, jo për shkak të ndonjë procesi zhvillimi, por falë veprimit të vetëdijshëm të një pakice folësish. Dy shembuj të kohëve të fundit janë: "të shfrytëzosh të gjitha mundësitë e mundshme" dhe "të mos lësh gur pa lëvizur" që u vranë nga shpotitë e pak gazetarëve. Është një listë e gjatë metaforash të vdekura, të cilat në mënyrë të ngjashme mund të hiqen qafe nëse aq njerëz sa nevojitet shfaqin interes për ta bërë këtë punë; dhe duhet të jetë gjithashtu për të qeshur sajesa me jo pa-¹³, për ta zvogëluar sasinë e fjalëve latine dhe greke në një fjalë mesatare, për t'i nxjerrë jashtë përdorimit frazat e huaja dhe fjalët e keqvendosura shkencore dhe, në përgjithësi, për ta nxjerrë ligjërimin pompoz jashtë mode. Por të gjitha këto janë çështje të vogla. Mbrojtja e anglishtes nënkupton më shumë se kaq dhe, ndoshta, më e mira është të fillojmë të themi çfarë nuk nënkupton.

Si fillim, duhet thënë se s'ka të bëjë fare me fjalët e vjetruara (arkaizmat), me shpëtimin e fjalëve e togfjalëshave që s'përdoren më, dhe kapërcimet gjuhësore, as me vendosjen e një "anglishteje standardë" prej së cilës nuk duhet të shmanget asnjëherë. Përkundrazi, është veçanërisht e interesuar të flakë çdo fjalë ose idiomë e cila s'ka asnjë lloj dobie. S'ka të bëjë aspak me gramatikën dhe sintaksën e saktë, të cilat nuk kanë rëndësi për sa kohë mendimi bëhet i qartë, as me shmangien e amerikanizmave, apo me atë që quhet "stil i mirë proze". Nga ana tjetër, nuk është e interesuar për një thjeshtësi të rreme dhe as përpiqet ta bëjë anglishten e shkruar të ligjërimin bisedor. As që nënkupton të parapëlqehet fjala saksone kundrejt asaj latine, ndonëse nënkupton që duhet të përdoren sa më pak fjalë dhe më të shkurtrat, fjalë që e mbartin kuptimin. Para së



gjithash, është e nevojshme ta lësh kuptimin ta zgjedhë fjalën, dhe jo e kundërta. Në prozë, më e keqja që mund të bësh me fjalët është të dorëzohesh para tyre. Kur mendohet për një gjë konkrete, mendohet pa fjalë, dhe pastaj, nëse doni ta përshkruani atë që keni përfytyruar, ka mundësi të kërkonte me mendje derisa t'i gjeni fjalët e sakta që duket se përshatën.

Kur mendohet diçka abstrakte, ka prirje të përdoren fjalët që në fillim, dhe vetëm nëse bëhet një përpjekje e vetëdijshme për ta parandaluar, e folura ekzistuese do të turren për ta bërë punën për ty, në kurriz të mjegullimit madje të ndryshimit të kuptimit. Ndoshta është më mirë ta lëmë anash përdorimin e fjalëve sa më shumë të jetë e mundur dhe ta qartësojmë kuptimin me anë të pamjeve dhe ndjesive. Pastaj, mund të zgjidhen - jo thjesht të pranohet - frazat që më së miri mbartin kuptimin dhe pastaj të marrë një rol të kundërt dhe të përcaktojë se çfarë mbresash ka gjasë të lënë fjalët e zgjedhura të dikush tjetër. Me këtë përpjekje të fundit të mendjes hiqen të gjitha imazhet bajate ose të përziera, të gjitha frazat e gatshme, përsëritjet e panevojshme, broçkullat dhe paqartësitë në përgjithësi. Por ndodh shpesh të jesh në mëdyshje për efektin e një fjale ose fraze, dhe nevojiten rregulla të cilat të mbështetemi kur gabon instinkti. Mendoj se rregullat e mëposhtme vlejnjë për shumicën e rasteve:

Mos e përdor asnjëherë një metaforë, krahasim, ose figurë tjetër letrare të cilën je mësuar ta shohësh në shtypin e shkruar. Mos e përdor një fjalë të gjatë kur të bën punë një e shkurtër. Nëse është e mundur ta heqësh një fjalë, gjithmonë hiqe. Mos e përdor asnjëherë diatezën pësore kur mund ta përdorësh vepron. Mos e përdor asnjëherë një frazë të huaj, fjalë shkencore, ose fjalë zhargoni, nëse mund t'ia gesh një barasvlerës në anglishten e përditshme. Më mirë t'i shkelësh këto rregulla sesa të thuash diçka që kuptohet hapur se është barbare.

Këto rregulla ngajnë elementare, dhe ashtu janë, por kërkojnë ndryshim të plotë qasjeje prej kujtdo që është mësuar të shkruajë me stilin që është tani në modë. Mund t'u përmbahesh të gjitha këtyre rregullave dhe përsëri të shkruash me anglishte të keqe, por nuk do të mund të shkruash sipas asnjërit prej shembujve që citova në të pesë gjedhet në fillim.

Nuk e shtjellova këtu përdorimin letrar të gjuhës por, thjesht, gjuhën si mjet për të shprehur dhe jo për të fshehur ose parandaluar mendimet. Stjuert Çeisi dhe të tjerë gati sa s'kanë deklaruar se të gjitha fjalët abstrakte janë të pakuptimta, dhe e kanë përdorur këtë si pretekst për të mbrojtur një lloj mosangazhimi politik. Meqë s'e dini se çfarë është fashizmi, si mund të luftosh kundër fashizmit? Nuk është e nevojshme të kapërdish absurditete si kjo, por duhet ta pranohet se kaosi i tanishëm politik lidhet me rrënimin e gjuhës dhe se, ndoshta, mund të bëhen përmirësime nëse ia nisim nga gjuha që përdorim. Nëse e thjeshtëzoni anglishten që përdor, çlirohesh prej marrëzive më të këqija të mendimeve dogmatike. Nuk mund të flasësh asnjërin nga zhargonet e nevojshme, dhe kur thua një broçkull pa kuptim, idiotësia e saj do të jetë e dukshme edhe për ty. Gjuha politike - me variantet e saj, (kjo është e vërtetë për të gjitha partitë politike, duke nisur nga konservatorët tek anarkistët) është e projektuar që t'i bëjë gënjeshttrat të tingëllojnë të vërteta dhe vrasjen të respektueshme, dhe ta bëjë të duket e patundur edhe vetë erën. Askush nuk e ndryshon të gjithë këtë sa hap e mbyll sytë, por secili mund t'i ndryshojë të paktën shprehitë e veta dhe, herë pas here, mund jo vetëm t'i përqeshë, por edhe t'i flakë në koshin e plehrave disa fraza të vjetra dhe të padobishme - disa çizme, thembra Akilash, vatër konflikti, pikëtakim kulturash, provë e zjarrit, një ferr i vërtetë, ose mбетje shprehesh, mu aty ku e kanë vendin.

Botuar në *Horizon*, në prill 1946. Marrë nga revista *Akademia*, nr. 15

¹ John Milton (1608-1674), poet dhe intelektual anglez, që shërbeu si nëpunës civil për Komonuelthin, i njohur për veprën e madhe letrare, poemën *Parajsa e humbur* (1667). (Shënim i përkthyesit).

² Percy Bysshe Shelley (1792-1822) një nga poetët më të mëdhenj romantikë anglezë. (Shënim i përkthyesit).

³ Harold Joseph Laski (1893-1950), teoricien politik dhe ekonomist anglez, kryetar i Partisë Laburiste britanike (1945-1946) dhe profesor në Kolegjin e Ekonomisë dhe Shkencave Politike të Londrës në vitet 1926-1950. (Shënim i përkthyesit).

⁴ Lancelot Thomas Hogben (1895-1975) shkroi libra mbi shkencën dhe matematikën për t'i bërë popullorë për publikun e përgjithshëm. *Interglosa* është gjuhë e krijuar nga ky biolog gjatë Luftës së Dytë Botërore, si një përpjekje për ta bërë leksikon ndërkombëtar të shkencës dhe teknologjisë, pjesë të një gjuhe ku secila fjalë i përgjigjet një morfeme të vetme, si "variant i një mjeti ndihmës për një rend botëror demokratik". (Shënim i përkthyesit).

⁵ Nick Bottom një nga personazhet kryesor dhe më argëtuesit në komedinë *Ëndrra e një nate vere* Uiliam Shekspir (1595). (Shënim i përkthyesit)

⁶ Vendi ku ndodhet selia e BBC-së. (Shënim i përkthyesit).

⁷ Në Britani, mosshqiptimi i tingullit "h" shihet si tregues i mungesës së arsimimit ose si tregues se i përket një klase të ulët shoqërore. (Shënim i përkthyesit).

⁸ Një ilustrim interesant është mënyra se si emrat anglezë të luleve ishin në përdorim deri kohë të fundit, po nxirren nga përdorimi nga ata grekë, *Snapdragon* po zëvendësohet nga *antirrhinum*, lulja mos më harro (angl *forget-me-not*) po zëvendësohet nga *myosotis* etj. Është e vështirë të kuptohet një arsye praktike për këtë ndryshim të modës: ndoshta po ndodh për shkak të një largimi instinktiv nga fjala më e njohur dhe një ndjesi e paqartë që fjala greke është shkencore.

⁹ Shembull: "Katolicizmi i perceptimit dhe imazhit të ngushëllimit, çuditërisht Uitmanian në gamën e vet, pothuajse e kundërta në shtysën e brendshme estetike, vazhdon të ngjallë atë aluzion mjedisor drithëruar ndaj një pakohësie në mënyrë të pashmangshme, jashtëzakonisht të qetë... Wrey Gardiner arrin ta kapë demin për brirësh. Vetëm se nuk është kaq e thjeshtë dhe nëpërmjet këtij trishtimi të kënaqur del në sipërfaqe hidhërimi i heqjes dorë". (Revista *Poetry Quarterly*).

¹⁰ Originali në anglisht nga Predikuesit që analizohet: "I returned and saw under the sun, that the race is not to the swift, nor the battle to the strong, neither yet bread to the wise, nor yet riches to men of understanding, nor yet favour to men of skill; but time and chance happeneth to them all". (Shënim i përkthyesit).

¹¹ Fjalia e trilluar nga Oruelli në anglisht që analizohet: "Objective considerations of contemporary phenomena compel the conclusion that success or failure in competitive activities exhibits no tendency to be commensurate with innate capacity, but that a considerable element of the unpredictable must invariably be taken into account". (Shënim i përkthyesit).

¹² Përkthimi shqip ka 36 fjalë, prej të cilave katër me prejardhje latine, dhe një ose dy me rrënjë turke. (Shënim i përkthyesit).

¹³ Mund të vetëshërohem nga përdorimi i strukturës -jo pa duke e mësuar përmendësh këtë fjalë: Një qen jo i pazi po ndiqte një lepur jo të pavogël nëpër një fushë jo të pagjelbër.



LAURA OLLDASHI

PIKTURA

Ishte veshur ndryshe. Fustanin e bardhë lino, të gjatë. Në mes, rripi i hollë i mblidhte belin. Jaka ishte e hapur ku i zbulonte supet e imta. Herë pas here i mbulohehin nga flokët e gjata dhe të holla që i binin si litar. Imagjinonte fëmijërinë e saj që i lozte në pjesën e dekoltesë sa herë që fuste gishtat tek ondet. Ecte duke tundur veten si shtojzovalle. I pëlqenin valët që krijonin palët e fustanit. Rrotullohej me tingujt që si pika vese i rridhnin nga mendja. Pastaj ndalonte dhe shikonte qiellin. Kishte dashur të futej atje. Të kthehej në re dhe të shkrihej në lëvizjen e tyre. Ti humbte tokës! Imagjino shpalljen e ikjes së saj në një letër të vjetër ngjitur mbi një shtyllë. Apo në raste më dinjitoze, vdekja e saj do të ishte deklaruar mbi xhamat e pista të dyqanit ku do t'i bënin edhe pazarin e varrimit. Nuk ishte kohë e përshtatshme. Kishte rënë çmimi. Pak kushtonte dhimbja. Vdekja ishte në modë edhe kur jeto-nim! Të paktë ata që duronin. Imagjino një shifër për vdekjen e saj. Nuk i

pëlqeu. Kushton asgjë, më e vogël se jeta. E sponon vdekjen në tjetër kohë. Deri atëherë kur ta ketë realizuar paktin e një vdekjeje të denjë. Iuduk i komplikuar ky komunikim. Pompoz. Kur motivi i veshjes së saj me të bardha kishte qenë i thjeshtë: pozim në studion e një piktori. Meqenëse do të hynte në kornizën që s'do të dilte kurrë, kishte vendosur të prezantohej sa më mirë.

Pak më vonë është shtrirë mbi pëlhurën e bardhë. Pa fus-tanin e bardhë. Sipër re të fotografuara, në ikje. Përballë artisti me penelin në dorë pikturon trupin e saj nudo. Herë i hidhte sytë mbi telajon dhe herë mbi atë. I fliste ngadalë kur nuk mundte të kapte dot ndonjë dritë hije të muskujeve.

"Hidhe vështrimin nga dritarja! Dua profilin tënd me të mirë! Ngrije dorën! Mbështete bindur mbas koke! Spostoji flokët nga supet! Gjoksi duhet të jetë i lirshëm! Aspank i ngjeshur me tokën si tul buke. Duhet vetëm ta prek lehtë që herë pas here ta shoh zigzagun e

mbështetjes së mishit. Beli i ngritur në ajër dhe vithet spostoji sa më larg nga busti! Kofsha e majtë e futur pak më brenda se kofsha e djathtë! Seksi duhet të jetë i dukshëm. Bëj një tjetër provë, të lutem! Si thua, ndoshta është mirë t'i hapësh pak më lehtë kofshët? Të lutem, zgjati natyrshëm gjunjët, edhe gishtat! Jo, shko fshi manikyrim!"

Vajza ngrihet e lodhur nga aty. E detyruar shkon në banjë. Merr pambukun dhe mundohet ta heqë smaltin nga thonjtë. I kishte kushtuar 60 euro dhe për kapriçon e artistit duhej ta fshinte. Por nuk kundërshton. Mbasi i pastron kthehet në dhomë. Kërkon leje për të pirë duhan. Hap çantën dhe merr paketën. I afrohet lakuriq dritares duke mbështetur cigaren te buzët. Ajri i freskët i preklëkurën. Piktoria vjen dhe ia ndez. Ajo e thith bollshëm. Aq sa ndien parfumin e nikotinës në mushkëri. E mban gjatë brenda vetes si për t'i qetësuar të gjitha zhurmat e orendive. Elëviz trupin majtas-djathtas për ta

spostuar në cepat më të thella të mobilieve. Mjegulla që bën tymi ia mbulon mirë rrëmujën. Ndoshta ky ishte motivi që pinte cigare: t'i vinte maskë dhimbjes. Pastaj e shfryn sa fuqi që ka dhe e nxjerr nga goja. E shikon si i largohet çalë-çalë. Beze e bardhë e konsumuar nga pesha. Ndoshta edhe ky ishte motivi që pinte cigare: ia merrte dhimbjet dhe ia nxirrte në shëtitje.

Ndjek me sy fraksionin e pikës së fundit të tymit që bie mbi kapelën e një burri tek ecte i shoqëruar nga një qen.

Shkëputet nga vëzhgimi mbi rrugë sepse mbas veshit ndien puthjen e piktorit. E largon nga vetja dhe i zgjat cigaren. E thith edhe ai, pastaj menjëherë nxjerr tymin. E bardhë. Ajo ia merr duhanin nga dora dhe e vendos mbi buzët e saj. Përsërit ritualin e thithjes sikur donte të dinte në ç'tjetër kapele do të mbështetet grupi ibrengave të reja. Ishte në merak për fatin e tyre. Ne ç'të tjera jetë do të hynin?

- "Dua të them që nuk më pëlqen

pozimi im! - flet duke shqepur tegelat e përqendrimin.

Duket sikur jam vetëm formë. M'i dëshifron mendimet kur më pikturon? I dëgjon ato? Për shembull unë thitha cigaren dhe ndoqa rrugën që bënte tymi i cili më pa, më preku në brendësi. U mundua të nxjerrë një pjesë të konsiderueshme të problemeve të mia. Ti i pe?

- Po, i perceptoj! I kuptoj kur mbështet krahët mbas qafe. Si e fshih mes flokëve, gjoksin. Nuk ke natyrshmëri. Je ushtar që nuk kërkon të dalë jashtë nga zona komforte e saj. Të sugjerova disa lëvizje edhe në hapjen e kofshëve, por pushë si t'u drejtuan qimet mbi pubis. Gjymtyrët e tua nuk shprehin jetë. Të thashë, ta pastroshe smaltin për t'i vënë në gjallëri gishtat. Si tymi i duhanit edhe unë të shoh, por bëj të kundër-tën e tij. I lë të flenë brenda teje problemet dhe mbi lëkur ta sjellë përsosmërinë e çrregullt të bukurisë tënde. Tek-tuk, kur ta lexoj brengën, e ngre më sipër ose e



ul më poshtë vizën e penelit. Ai i ndjek mendimet e tua.

- Sipas teje spektatori do të më deshifrojë?

- Edhe këtu perceptimet mbesin individuale. Sa më shumë këndvështrime kërkon të sjellë arti, aq më shumë analizohet.

- Të kërkoj edhe diçka - thotë ajo.

Pastaj merr frymë. Rri gjatë në heshtje. Ndez një tjetër cigare. E thith më ngadalë. Vështrimin në rrugë, mbi kapelën e një burri që ecte i shoqëruar nga një mace. Cigarja konsu-mohet. E hedh në parketin e dhomës dhe e shkel me këmbën e zbatshur. Shtrembëron fytyrën nga dhimbja e djegies. Mbështjell krahët për ta prekur gjoksin dhe ecën për t'u ulur në karrigen e sallës. Zgjat dorën dhe loz me onden e flokëve. Pastaj, shumë më vonë del zëri i saj, më i pjekur se mosha.

- Dua të më kuptosh. Nuk më shkojnë punët mirë. Nuk i duroj dot dhimbjet. Më kanë pushtuar nga të gjitha anët. Kam menduar seriozisht ta lë botën, por nuk dua të largohem për-gjithmonë. Dua ta vëzhgoj nga larg dhe ajo të më vëzhgojë. S'dua as t'i shoh, as t'i kuptoj më dhimbjet e mia. Askush nuk duhet të shoh çfarë mbaj brenda. As unë vetë nuk dua t'i ndiej më. Po më hedh në tokë pesha e tyre. Të lutem m'i vij në gjumë dhe të lirohëm përgjithmonë nga ato. Të shpëtoj edhe nga ankthi i fatit të tyre. S'do të më interesoj më në ç'kapele do të ulen. Pikturo imazhin tim më të mirë dhe më lërë aty! Më bëj të përjetshme! Pa moshë. Pa jetë. E ndalur dhe e shtrirë pezull mbi çdo kohë.

- Do të vras mbasi të kem pikturuar?

- Jo! Më fut në kornizë kështu siç jam. Me lër të qëndroj aty. Unë nuk kam simpati për këtë botë. Ka kohë që nuk më pëlqen. As njerëzit. Janë të gjithë të çoroditur. Ose ndoshta jam unë!? Më bëj të përjetshme dhe unë bëj të pavdekshëm emrin tënd. Vetëm të kërkoj që në krahë të pikturës, në çdo vend, në çdo galeri që do të jem, ma lë të ndezur cigaren.

- Okay - tund me mëdyshje kokën piktori duke imagjinuar kartelat ku shkruhet "Ndalohet duhani".

- Do të përpiqem të të bëj njësh me pikturën. Mbasi të kem pikturuar do t'i vë xham kornizës.

Ajo nuk ka më dëshirë ta dëgjojë. Ia vë dorën përpara gojës. Ia merr duart dhe ia vendos mbi gjoks. Ai kërkon ta puthë në buzë.

"Pa prekje buzësh - i thotë ajo. Buzët janë të dikujt tjetër".

Nuk është më aty kur ai i prek kofshët. Nuk është as në çdo centimetër që ai avancon mbi trupin e saj. Kishte mbyllur sytë dhe ishte larguar. Ulur mbi një re, ku zemra edhe trupi dashuronin.

Pesë minuta më vonë shtrihet mbi pëlhurën e bardhë, pa fustanin e bardhë. Cigarja tymoste dhomën.

Duart e piktorit i vihen punës. Për herë të parë mbas një kohe të gjatë janë në harmoni. Edhe trupi i

saj është i zhëp-vjellshëm, i shkëmbyeshëm, i komunikueshëm. Është bërë plasteline që modulohet sa herë që dëgjon urdhrat e tij.

Punojnë mbi një muaj. Derisa piktura është gati.

Prezantimi bëhet në galerinë më të ndriçuar të "Palazzo Reale".

Më në fund brenda një kornize shtrihej ajo. Kishte kohë që nuk pushonte. Ishte momenti i duhur për të fjetur gjumë, për të mos menduar asgjë. As ora që do ta zgjonte. As zilja që do ta përplaste çdo mëngjes nga komodia. As sharjet e të dashurit: "ngrihu, dreqi ta marrë! S'e kuptoj xhanëm përse duhet të më zgjosh edhe mua?" Më vonë do të dilte dielli dhe do të shullehej. Retë mbi kokë. As pazare s'do te bënte më. As fatura për të paguar. S'do të merakoset as për dietën, kirur-gun plastik, kremrat e fundit, palestra. Nuk do ta përgjonte çdo moment telefonin e të dashurit. Kush i bëri like, me kë po flirton? Pastaj edhe nga kolegët shpëtoj. Nuk i duroj kur i lëpinin bythën. I qeshnin në fytyrë dhe mbas shpine ndiente dhimbjen. Redaktorit të gazetës do t'ia thoshte në sy që është vetëm një copë mishi dhe pastaj ta pushonte nga puna.

Më në fund, "addio" metro, njerëz mediokër, egoistë, boshë, injorantë, të mbaruarit e shekullit! Tani ishte ora e saj. E shtrirë në pikturë. Të gjitha format i shkëlqenin. Trupi i saj qumësht i bardhë.

E kishte parë veten një çast përpara se të mbyllej brenda kornizës. Nuk u kishte besuar syve. S'mund të ishte ajo. Nuk ishte bukuri, por krenaria. Dukej në të tjera lartësira. Piktori e kishte pyetur: si të duket?

- Kralnesh, mor burrë! - i ishte përgjigjur.

Ndërsa tani pushonte në një nga muret më të rëndësishme të qytetit. Çmimi i kishte shkuar në stratosferë. I kujtohet pakti që kishte bërë me veten. Do të ikte nga kjo botë kur vdekja e saj të kushtonte më shumë se jeta. Iukujtua që edhe piktori e kishte mbajtur fjalën. Në krahë të majtë ishte korniza ku cigarja tymoste dhe thithte vetveten.

Në ditët e para të vjeshtës, një të shtunë, hapen dyert e galerisë. Ajo kishte ngritur kokën, kishte nxjerrë dhëmbët me një buzëqeshje që rrumbullakoste dukshëm mollëzat. Pendohet që s'ka marrë kremin me vete. Një burrë i veshur me uni-formë prezanton emrat e personaliteteve që hynin në sallë. Dëgjon disa prej tyre. I njihte?! I kishte parë në televizor ose kishte lexuar për to në gazeta. Turpërohet për vetveten që nuk ishte asgjë. Thjesht, vajza e pikturës. Të ftuarit do të rinin me të vetëm dy minuta. Por nuk ka kohë për mendime, spekta-torët i kishte përpara.

Të parët që i ndalojnë janë një çift i moshuar. Zbrisnin nga një

mbretëri, nga një tjetër botë. Ajo, me kapelën e verdhë, mbante për dore të shoqin. Burri dukej sikur kishte ardhur nga vdekja vetëm për ta shoqëruar. Me zë të lehtë i pëshpërit gruas: kështu e bukur ishte kur të njoha. Ajo shtrëngon më fort dorën dhe i skuqen faqet. Burri shikon buzëqeshjen e vajzës së pikturës dhe e përshëndet siç bëjnë ushtarakët duke ulur lehtë kokën.

Mbas tyre ndalojnë dy burra të vrenjtur. Njeh presidentin e Amerikës dhe të Rusisë. Po flisnin me zë të lartë duke lëvizur duart. Hedhin sytë nga piktura. Heshtin. Pastaj Putini thotë: "Bota është si trupi i kësaj femre. E shikon pikën ku është kërthiza? Pikërisht nga aty deri te koka, bota është e imja. Pastaj ju amerikanët së bashku me Evropën mund të merrni nga kërthiza deri te këmbët".

A nuk i keni zgjidhur gjërat me anë të seksit? - dukej sikur thoshte presidenti rus.

Burri i moshuar, presidenti i Amerikës, bënte shumë mundim të mbante sytë hapur. Kishte idenë që i flihej. Në atë çast një zë futet në mendimet e zotit Biden dhe i thotë: ne e dimë që Rusia është e fuqishme. Së bashku me Kinën kanë mjaftue-shëm armë bërthamore. Pastaj jemi idiotë që kemi zgjedhur Evropën si aleancë që di të grijë sallatë".

Një moment hap sytë dhe ngre dorën drejt kolegut:

- E mbyllim këtu pazarin. Nga kërthiza e poshtë është e imja.

Putini për herë të parë sheh në sy vajzën epikturës. I akullt. Ftohtësia e vështrimit futet në të gjithë trupin e saj. Ndalet gjatë poshtë kërthizës. Bashkon buzët fort sa një gjysmë buzëqeshje i shtrydhej mbi fytyrë. Nxjerr gjuhën dhe lëpin lëngun që i rridhte nga buzëqeshja.

-Dakord jam edhe unë! - përfundon komunikimin duke i shtrënguar duart kolegut.

Presidenti i Amerikës del nga salla, ndërsa Putinie merr në telefon agjentin më të mirë. I kërkon të gjejë informacione mbi modelen, autorin dhe mbi personelin e galerisë. E mbyll telefonatën duke thënë: "Vajzës në ndonjë vrimë, poshtë kërthizës, futini një çimkë përgjues!"

Modelja dëgjon të gjithë komunikimin dhe ul duart për ta mbuluar dhe zhdukur seksin.

Pastaj përpara pikturës ndalon një tjetër çift. Ai kishte qenë lojtari më i bukur i Anglisë. Ishte folur gjatë për historinë e dashurisë së tyre që i kishte rezistuar kohës. Yll ishte ende. Po mos të kishte qenë xhami, vajza do të kishte fluturuar dhe do t'i kishte ndaluar mbi trup. T'ia shqyente smokingun gri. T'ia shihte shpatullat, muskujt e poshtëm të barkut, kofshët. Ta rrotullonte për ta parë të gjithin.

Dhe t'i futej?

Ku?

Në gjoksin e tij...

Ishte nga të paktët burra që i kishte qenë besnik për një vit rresht. Kalendarin e tij e kishte varur në murin e zyrës. Çdo ditë, çdo muaj, ai kishte qenë aty. Vajza

me trishtim fut kujtimet brenda kornizës dhe nxjerr buzëqeshjen më të mirë të saj. Beckham i shihte me admirim sidomos format e gjoksit.

I thotë Victories: "Këto janë topa. Edhe sikur gjithë jetën të loz me ato, të forta mbeten. Jo si të tuat".

-Shpirt, më duhet të fle një javë me gjoksin e modeles dhe të kthej përgjigje. Për momentin kënaqu me portokajtë e mi të shtrydhur - flet zëri i hollë i gruas.

Vajza heq duart nga seksi dhe mbulon gjoksin. Jo, një javë me Victorien nuk mundet. Mos e teprojmë! Është shumë. Imagjinon prekjen e skeletit të duarve anemike: pa mish, të drunjta, të ftohta.

Për fat të mirë që Davidit nuk i pëlqeu ideja. E merr për krahu fijen e shpagnetit dhe të dy largohen.

Çifti i fundit vinte nga vendi i saj. Ajo nuk studion as indi-vidin, as artistin, as politikanin. Thjesht, kur shikimet e tyre ndeshen, zmbrapset. Shkon mbas murit ku ishte varur pik-tura. Bën një vrimë dhe fshihet. Kishte vetëm dy duar. Nuk mund të mbulohet e gjitha. Në një tjetër botë, në një tjetër jetë ai kishte tentuar të abuzonte mbi trupin e saj. Ne atë mbrëmje kur gruaja e individit ishte futur rastësisht në dhomën e errët ia kishte fluturuar fjalët si shpulla: "Femër e mallkuar, faji është i yti! Përse e provokove?" E gjithë salla "e ndershme" ia kishte shkelur siluetën dhe e kishte dëbuar turpërisht nga ajo tokë që nuk u bë kurrë e premtuar.

Kur i sheh përpara vetes dridhet. Plaga i çahet. Në vend që të struket, del nga vrima me një forcë të çmendur. Futet në kornizë dhe ngrihet në këmbë. I vihet përballë burrit. Krahët lart i mbështet mbas kokës. Gjoksi varet në lartësinë e buzëve të tij. Mjafton që ai t'i zgjasë duart dhe t'i prekë kofshët. Burri tentohet dhe në heshtje i thotë: "Më thuaj çmimin tënd? Sa lekë do që të jesh e imja? Unë të blej".

Vajza-pikturë i qesh. ia ulërin buzëqeshjen, pastaj ia shkër-moq përpara fytyrës duke i thënë: "Ti vjen nga një vend ple-shtash. Unë iu shita Amerikës, jam spiune e Rusisë. Kina me mua prodhon viruset. Evropa në Francë më ka bërë tritol për armët bërthamore. Dhe ti do të më blesh?! Me lekët që ia vjedh fukarait, popullit tënd. E shndërrova pa dinjitet si vetveten!"

Pastaj zëri i burrit i drejtohet të shoqes: "Na fëlliqi Atdheun! Nuk ke ndonjë çarçaf ta mbulojmë?"

Gruaja me mllef mendon: "E bukur në jetë, e shkëlqyer në pikturë" por duatë gris, ta shkel me këmbë. Ti s'do të jesh asnjëherë në fantazitë e tim shoqi".

Ndërsa me zë të lartë thotë: Atdheu më ka mua! Na ka NE që s'ia ulim nderin!

Largohen të dy. Ai përplas derën e germave të fjalës "kurvë". Ajo e thërret "kuçkë".

Ky kishte qenë inaugurimi. Burrat që do ta shpëtonin globin,

shtetet, popujt e sflitur, i kishin parakaluar përpara. Kishte pozuar ditë me radhë. Shumë herë e kishin marrë me qira për mbrëmje dhe festa të rëndësishme. E njëjta dhjerje e botës i kishte parakaluar edhe nga mbrapa. Kur jetonte nuk kishte pasur simpati për botën, kurse tani e vllite.

Mbas shumë vitesh ekspozim, mbas një mbrëmje, kur kishte mundur t'i qetësonte kockat dhe veshët nga dërdëllitjet e ditës; në atë mbrëmje kur ishte e bindur që burrat e kishin urreyer për zgjuarsinë dhe gratë për bukurinë; në atë mbrëmje kur kuptoi që bota është tërësisht e mbaruar, e fundosur për-fundimisht në errësirën e interesave dhe pakteve të shpirttrave mediokër; kur kuptoi që askujt nuk i plas për individin; në një nga ato mbrëmje kur pastruesja ia freskonte lodhjen duke i fshirë pluhurin; në ato mbrëmje kur ajo i liste për jaranin që bëhej tap çdo natë; kur i liste për lodhjen e fëmijëve që me mundim të madh i çonte në universitet.

Pikërisht në atë mbrëmje, xhami i pikturës kriset. Vajza modele merr frymë gjatë. Parfumi i parë ishte duhani. Nga korniza që ikishte ndenjgur gjithmonë në krah, merr cigaren. E thith gjatë. Pastaj e nxjerr nga polmonet. Vëzhgon rrugën e tymit. Ai e çon në qendër të qytetit te një lokal. Në krah i ecën lumi. Ulet mbi karrige. Veshur me fustan lino të bardhë. Përballë i ulet një burrë. Konsumojnë birrën në heshtje. Sytë shihen. Ajo ngrihet drejt tij. Buzët puthen. Kamerieri shton karrigen. Vjen dashuria. Kamerieri vendos një tjetër karrige. Ulet familja. Më vonë, kamerieri mbështet rehatllëkun e divanit. Gruaja ka nxjerrë gjoksin dhe i jep qumësht të voglit. Ndërsa burri sheh futboll me fëmijën e rritur. Mbas darkës të dy marrin shku-mësin dhe vizatojnë muret e shtëpisë. Në orën 12.00 të natës dritat fiken. Lumi fle i qetë në krahë të tyre. Në fraksione të caktuara të jetës gruaja fshin me gomë vizën e bardhë të shkumësit. Hap dritaren për ta pirë cigaren. Ai ka një tjetër dashuri. Në fraksione të caktuara të jetës burri fshin vizën e shkumësit. Del në dritare për ta thithur cigaren: ajo është dashuruar me një tjetër burrë.

Dhoma me muret prej shkumësi gjallëron nga zhurma e fëmijëve.

Në orën shtatë të mëngjesit dëgjohej alarmi në galerinë "MoMa" të Nju-Jorkut. Vinte nga kati i dytë, afër kopshtit të skulpturave. Korniza e varur, bosh dëgjon dialogun e inspek-torit të policisë: "Piktura vajzë që pozonte prej kaq vitesh nuk është më. E kanë vjedhur. Çmimi i saj kishte kapur shifra marramendëse".

Pastruesja mblidhte nga toka xhamat e thjera të kornizës dhe thithte gjysmën tjetër të cigares. Duke murmuritur kë-n-donte: "Eh vika deti mi lale, o tallaz tallaze. Eh se m'ka zon o mi shpirt, sevdaja me plase".



ANDREA GRILL

DAJA I VERDHË

Daja, sa herë që i jepte makinës, mbathte gjithnjë këpucë të posaçme. Ca këpucë shumë të buta me shollë të lëmuar dhe lëkurë italiane. Me to, sikurse thoshte ai, pedali i gazit dhe ai i friksionit ndihej shumë më mirë sesa me këpucë të tjera. Kishin ngjyrë kafe e ishin shumë elegante, s'kishin lidhëse, thjesht fusje këmbën dhe makinën ato asnjëherë s'e braktisën. Kur nuk i mbante veshur, i ruante në bagazh. Të tjerë me to, ndoshta, do të kishin shkuar për të kërcyer, kurse ai i jepte makinës. Çdoherë para se të hipte në makinë hapte si fillim bagazhin, nxirrte këpucët e lëkurta e i ndërronte me ato që mbante veshur. Kurrë s'e pashë në timon me këpucë të tjera përveçse me ato të makinës. Gjithnjë udhëtonte me makina japoneze thua se nuk kishte lloje të tjera. Daja kishte flokë të errët dhe me kalimin e viteve, një pjesë tullace mu në mes të kokës. Vishte përherë këmisha të hekurosura dhe shpeshherë edhe kravatë.

Kur ishte i ri kishte qejf të udhëtonte për në Itali, në Trieste dhe Venecia. Merrte shpesh të ëmën me vete. E bënin pazarin aty,

blinin këpucë, këmisha e bluza italiane. Një nga këto bluza, që daja ia kish blerë gjyshes në një nga këto udhëtime, vazhdoj ta vesh edhe sot. Njëra prej tyre ka ngjyrë bojëqielli, tjetra është bezhë. "Bezhë", këtë fjalë për herë të parë e dëgjova nga daja. Plot sekrete e kaq e huaj më tingëlloi kjo fjalë kur ai e shqiptoi në praninë time. Me siguri po fliste për këmisha e këpucë dhe kombinimin e tyre. A shkonte kjo lloj "bezhe" me atë tjetrën.

Daja i dashuronte ngjyrat dhe i pëlqente bisedat për to. Megjithatë, daja vuante nga daltonizmi dhe kishte vështirësi t'i dallonte ato ngjyra që anonin nga e kuqja apo e blerta. Ndaj i përfshinte motrat në marrjen e vendimeve, nënën time dhe motrën e saj, kur donte të dinte nëse këmisha shkonte me pantallonat dhe këto të fundit me xhakatën. Daja ishte fëmija i dytë, nëna ime ishte më e vogla. Kishte mbaruar elektrikun dhe më vonë kishte filluar të punonte në një bankë, punë që nuk e ndryshoi më përgjatë gjithë jetës. Sidoqoftë, ia arriti të tran-sferohej nga dega e vogël e bankës së fshatit në një filial në kryeqytet. Por, prapë, për

krishtlindje kthehej gjithnjë për të varur tela me llamba të vogla ndriçuese rreth e përqark pemës së krishtlindjeve aty lart në kullën e kishës së fshatit. Këtë ritual e bëri për plot dyzet vjet. Por nuk mjaftohej vetëm me zbu-kurimin e pemës për çdo vit në kullën e kishës. Edhe bredhat e argjenditë në oborrin e nënës së vet që ishte veç një rrugë prerëse më tutje, se kisha i mbështillte megjarpërinj dritash dhe po kështu ishte po ai që vendoste qirinj me ca kapëse argjendi në bredhin që ndodhej në dhomën e ndenjes së prindërve në dhjetor. Thua të jetë tashmë vetë prifti ai që zbukuron pemën? Sidoqoftë vazhdon të jetë gjallë, dhe e di këtë me siguri sepse s'ka pak ditë që pashë se flitej për të në gazetë. Daja nuk jeton më.

Një ditë u bë fare verdhan. Nuk u bë gri në fytyrë ashtu siç bëhen njerëzit kur sëmuren e kur nuk ia rreh më ajri i pastër fytyrën e gjaku nuk i qarkullon më me vrull. Nuk u zverdhe e as nuk mori ngjyrë limoni, por u bë verdhan si e verdha e një bananeje që kishte qëndruar gjatë, shumë gjatë, në dollapin e kuzhinës, e tani ishte pjekur tamam për t'u shijuar. Që nga ky

çast unë nuk e takova më. Nuk donte të takonte më asnjë, asnjë nga familja të paktën. Veç rrallë e më rrallë vinte në oborrin e së ëmës. Në fillim kujtoja se nuk vinte ngaqë e ëma në oborr nuk ulej më. Shumë kohë më vonë m'u qartësua se ai në këtë kohë, thjesht, nuk mundej të vinte. Nuk mund t'i jepte më makinës. Këpucët e makinës qëndronin në bagazh të papërdo-rura prej javësh e ai në krevat në apartamentin e tij në kryeqytet, apartament që e shkela vetëm një herë kur isha katërmbëdhjetë vjeçe, kur kisha shkuar me mamanë që e kishte ndihmuar për vendosjen e perdeve. Me siguri ai sapo i kishte blerë ato atëherë dhe kishte nevojë për këshillim për ngjyrat. A shkonte "bezha" me tapetin dhe tapicerinë e kolltukëve? Po me jeshilen e divaneve?! E kujtoj çorape veshur sipër divanit, me krahët lart duke mbajtur perdet në mënyrë që e motra që kishte hipur sipër një karrigeje afër dritares të mund të fuste ullukët e perdeve në kornizë. Sa herë që mendimet më çojnë në apartamentin e dajës dhe në qytetin ku ky apartament ndodhet, më krijohet një ndjesi kaq e mirë

edhe pse aty isha vetëm atëherë kur vumë perdet dhe qytetin vetë e vizitohet kaq rrallë.

Të gjitha kujtimet që kam për dajën ma risjellin atë para syve o me papuçe o me çorapë teksa qëndron sipërnjë divani apo kolltuku. Bënte gjithë qejf fotografi ndaj dhe hipte sipër ndonjë karrigeje, divani apo tavoline buke që të kishte një perspektivë tjetër fotografimi - siç thoshte ai. Me këmishën e tij me katrorë, nga ku vihej re mirë se sapo ishte hekurosur për merak, rrinte mbi karrige dhe na fotografonte ulur në tavolinën e kuzhinës ku mblaçitnim ëmbëlsira. Ca gojë të fryra na dilnin nëpër këto foto, e të zbehtë dilnim prej blicit. Të zbehtë si çarçafët sipër të cilëve ai hekuroste këmishët e veta.

Çdo të diel pasdite e gjeje duke hekurosur në kuzhinën e së ëmës afër bufesë, siç e quante ajo këtë mobilie. Pranë tij një legen plot me rroba dhe një shishe spërkatjeje, një shishe plas-tike ngjyrë gurkali me tapë të kuqe plot me vrima si një enë ujitëse. Sipër bufesë ishte një mbulesë ngjyrë rozë me ca viza të bardha te cepat. Çdo këmishë që e nxirrte nga legeni e lagte mirë e



mirë me shishen spërkatëse. Jakat dhe mëngët e mun-donin shumë. Kushedi sa herë e kalonte sipër hekurin e nxehtë për t'i lëmuar e kurrë nuk u lodh së përsërituri këtë gjë. Kur hekuroste pantallona i lagte ato ende më shumë dhe i linte për pak kohë poshtë një piceteje kuzhine me katrorë ngjyrë blu para se të fillonte t'i hekuroste. "Epo unë punoj në bankë", - më përgjigjej kur e pyesja për zellin e të hekurosurit. "Nuk mund t'ia lejoj vetes të bredh me rroba të pahekurosura nëpër bankë. Të gjithë te ne i ke të veshur me këmishë e kravatë, sidomos unë". Meqë për çdo ditë nevojitej një këmishë e pastër, i binte të hekuroste minimumi shtatë këmisha çdo ditë. Por, ngando-njëherë, ishin tetë apo dhe madje dhjetë, kur kishte qëlluar të kishte edhe ndonjë seminar. Në një rast të tillë duhej veshur një tjetër këmishë e pastër në mbrëmje.

Daja ishte burri i parë që kam parë duke hekurosuar. Ta kri-jonte përshtypjen se kjo punë i pëlqente e madje e bënte me gjithë qejf. Kur mbaronte së hekurosuri apo kur vendoste të bënte pak pushim, sidomos në ato ditë ku bëhej fjalë për më shumë se shtatë këmishë, e ëma rivendoste makinën e kafesë prapë në bufe, sepse përgjatë hekurosjes makina e kafesë zhven-dosej sipër kaloriferit, pasi bufeja ishte plot çarçafë e këmisha. Sapo makina e kafes zinte vendin e vet, daja fillonte të mbushte filtrin prej letre plot me kafë, hidhte ujin dhe shtypte sustën. Dihej se pinte kafë pa fund dhe dihej, gjithashtu, se ishte kafë-bërësi më i mirë i familjes. Se si ia dilte të bënte kafën më të shijshme, do të mbetet enigmë pasi ishte e njëjta makinë kafeje, i njëjti ujë, e njëjta kafë dhe po kështu e njëjta sustë. Kur ishte ai në shtëpi dihej se kush do ta bënte kafën. Të tjerët as afër nuk i shkonin makinës së kafes. Shpesh pinte kafë edhe natën vonë, madje dhe pas mesnate. Edhe një filxhan me kafë shqeto, se ndryshe nga të tjerët që ua kishte qejfi të shtonin sa më shumë qumësht që të ishte e mundur, ai e pinte shqeto. Veç në raste shumë të rralla ia bënte qejfin së ëmës dhe e lejonte atë t'i hidhte ca pika qumësht. E ëma thoshte gjithnjë se me qumësht kafja të bënte mirë për shëndetin. Tepër vonë shkonte në shtat. Lexonte deri në orët e para të mëngjesit romane policore ose shikonte filmat e Alfred Hiçkokut në televizor. Nga ai kam trashëguar dy dollapë plot me libra të Sherlok Holms-it dhe të Edgar Uollës. Në fundjavë rrinte shtirë pa fund. Shfaqej për mëngjes në kuzhinë kur të tjerëve një tjetër drekë do t'i kishte shkuar mjaft për shtat, pastaj fillonte ta bënte kafën dhe sa gëzoheshin të gjithë, sepse në pikë të mëngjesit ishin mjaftuar me kafën që kishte lënë pa pirë gjatë natës.

Kur u rrita në moshë nganjëherë provoja ta bindja të më ftonte në apartamentin e vet në kryeqytet. E lajmë-roja se kur do të ndodhesha

aty me punë ose kur doja të vizitoja një ekspozitë apo kisha ndonjë aktivitet tjetër, gjithnjë me shpresën se do të thoshte: "Po, eja më vizito!". Asnjëherë nuk e tha. Teksa rri e mendoj tani, them me vete se e dyshimtë duhej të më ishte dukur kjo punë. Po aq i dyshimtë sa gjesti i dhurimit të luleve për çdo vajzë/grua në familje në ditën e Shën Valen-tinit. Aq i dyshimtë sa xixat e byzylykëve që na i dhuronte në fëmijëve kur kthehej nga udhëtimet e tij nga Tailanda apo Kina. Aq e dyshimtë sa e vërteta që sillte pra me vete gjithë ato zbukurime, por asnjëherë një grua. Me thënë të drejtën, asnjë-herë nuk erdhi me dikë tjetër në oborrin e së ëmës. Gjithmonë vetëm vinte. I vetëm zbriste nga makina e vet japoneze dhe po vetë i fuste këpucët e makinës në bagazh. I vetëm rrinte në krevat i rrethuar nga romanet policore. I vetëm zgjohej, na bënte kafën e po kaq i vetëm kthehej pastaj sërish në kryeqytet. Kështu ishte të paktën gjatë viteve të fundit. Më parë me siguri do të kish marrë herë po e herë jo të ëmën me vete, që do të kishte bujtur në shtëpinë e tij në kryeqytet, e do ta kishte ndih-muar t'i zgjidhte ngjyrat e duhura të çarçafëve dhe jorganëve, ose motrën më të madhe, tezen time, që bënte pazarin me të. Çuditërisht nuk më erdhi asnjëherë në mendje ta pyesja nëse mund t'i shkoja për vizitë ose si s'më shkoi në mendje, thjesht, të shkoja e t'i bija ziles pa e lajmëruar. Kush e di, ndoshta do ta kishte hapur derën!

Nuk më kujtohet më se kur e pashë për herë të fundit. Ndoshta në ceremoninë e varrimit të të atit. Ose në kuzhinën e së ëmës ku s'hipte më sipër karrigeve apo hekuroste po, thjesht, ulej në tavolinë për ta pirë kafën si gjithë të tjerët. Kafënë e sapobluar vazhdonte ta hidhte po ai në filtër, në mos gaboj. Ka shumë gjasa të ketë qenë në kuzhinën e së ëmës. Ishte ky kryesisht vendi ku unë e takoja atë. Për ne vende të tjera nuk kishte. Atëherë kur e pashë për herë të fundit ishte verdhan.

Pa pritur e pa kujtuar erdhi vdekja e tij. Në fakt, çdo vdekje vjen pa pritur e pa kujtuar, por kjo e tij ishte më e papritur se të tjerat. Askush s'e dinte sesa i sëmurë paskësh qenë. Askush nuk u përkujdes për të. Askush nuk i tha lamtumirë. Kur ishte gjallë s'më kishte shkuar në mendje ta njihja më mirë. Tani që nuk jeton më, zbulova se sa të përbashkëta kishim. Veprat e Çaikovskit, për shembull, që i kishim kolek-sionuar të dy. Një udhërrëfyes operash. Shami hundësh me vrime te cepat. Se si i linte librat hapur sa andej-këndej e për shenjë leximi për-dorte gërhërë apo hapëse shishesh. Zbulova se i kalonte mbrëmjet në një lokal në të dalë të qytetit. Një kafë me tavan prej druri e stola bari me sfungjer, ku takonte njerëz që nuk mbanin veshur as këmishë e as pantallona të hekurosura, por një buzëqeshje rrezëluesekur e shihnin dajën të ulur në vendin e tij

të zakonshëm. Ata nuk punonin në ndonjë bankë e nuk dëgjo-nin seminare, përveç atyre që ai ua ofronte ndërsa ata nuk e vinin re nën shoqërimin e një gote vere kështu-en passant, siç do të kishte thënë daja që vdiste për fjalë shik. Zbulova se në kohën e tij të lirë i mësonte mate-matikë një të burgosuri. Kishte tasa filxhani plot me lule dhe me një vizë ari të buza dhe gota prej kristali.

Pikërisht tani që vdiq solli dikë me vete. Dhe ky dikush nuk ishte çdokush, e në oborrin e gjyshes ai sigurisht nuk erdhi kurrë. Ishte një djalë i ri dhe ishte i bukur. Sipas njerëzve, ishte ky ai që ia hëngri lekët dajës, po ai që e katandisi të shkretin në atë mizerje, e ngriheshin zërat që e dinin, që besonin se, që e kishin dëgjuar se në ç'gjendje kishte qenë apartamenti i dajës në fund. Gjithandej rroba të palara, gjitha-ndej enë të palara, e as krevati nuk kishte qenë i pastër. Çfarë turpi ta lësh njeriun të katandiset kështu - tregonin ata plot pasion dhe ishin gati t'ia tregonin çdokujt që donte t'i dëgjonte. Motrat i dëgjuan thashethemet dhe u tmerruan e heshtën.

Prania e djalit të bukur që kishte qenë prej vitesh afër me dajën, sikurse tregoi ai vetë, i tmerrroi më shumë se rrëmuja e apartamentit. Në muajt e fundit madje kishte banuar me të. Unë vetë u tmerrrova nga fakti që ky dajë nuk ishte fare ai daja që kisha njohur, që përgjatë tridhjetë vjetëve që unë e kisha njohur, nuk kisha vënë re kurrë që daja shoqërohej më me qejf me burra sesa me gra. Isha rritur me mijëra pyetje, por asnjë-herë me pyetjen se pse daja ishte i vetmi burrë në familje që nuk ishte martuar të paktën një herë. Dhe ajo që më nevr-i-koste më shumë ishte, se nëse daja vazhdonte të ishte gjallë, unë ende nuk do ta dija e, ndoshta, do të më duhej ta kisha arritur moshën e dajës për ta nuhatur këtë vetë. Sepse askush nuk do të ma kishte treguar. Tmerrri ia la vendin habitës. Dhe tashmë kur daja ishte i paarritshëm e s'ishte më aty për të sqaruar, u ngjir farefisi duke folur për kënaqësitë e çuditshme të tij. Për ato kënaqësi të çuditshme në kohën që mbetej pas asaj të hekurosjes dhe qëndrimit në oborrin e së ëmës.

Veç tani më erdhi në mendje se gjithë ato foto të tij nëpër gjithë ato udhëtime që na i tregonte për orë të tëra në tavo-linën e kuzhinës s'do të kishte mundur t'i shkrepse vetë. Ama në foto nuk kishte asnjëherë dikë tjetër. Ai me bluzë me lule, me një gjarpër gjigand rreth e përçark qafës. Ai para një tem-pulli shumëngjyrësh në bali. Ai ulur në një shezlong tajlandez duke shijuar diellin. Ai me kapele kashte në kokë. Ai me aparatin fotografik që i varej në kraharor. Ai para piramidave. Ai para një kupe të stërmadhe me akullore me fruta. Asnjë shok apo miqësi e krijuar përgjatë udhëtimeve. Dhe kishte qenë, sidoqoftë, herë një djalë i ri e herë një tjetër nëpër të gjitha këto



udhëtime. Ama fotot e tyre ai s'na i tregoi asnjëherë.

Një ndër ta ende kishte çelësat e apartamentit të dajës. Atij i vihej faji sa herë që mungonte diçka gjatë zbrazjes së aparat-mentit edhe pse thellë-thellë dyshimi se diku do të gjendej ishte. A ishte i pikëlluar i huaji nga vdekja e dajës, apo a mos kishte ai dëshirë a ndoshta të drejtë për të trashëguar ndonjë rrip ore ose pajisje dëgjimi? Këtë pyetje nuk e ngrinte asnjë. Varrimi u bë në fshat. I gjithë farefisi dhe shoqëria nga qyteti erdhi kastile për këtë në fshat. Zunë vend në varreza që ishte ende më ngjitur me shtëpinë e së ëmës sesa kisha. Shumë fjalë tha dhe prifti, që i duhet tashmë të gjejë dikë tjetër për t'i zbukuruar bredhin për çdo vit.

Varreza ndodhej në rrugën që të çonte në mal. Aty ku mba-ronin varret fillonte pylli. Një pyll i dendur me bredha. Daja u varros në një copë tokë gjysmë metri larg të atit i cili ishte varrosur veç pak kohë më parë në të njëjtën sipërfaqe toke pylli prej katër metrash katrorë. Pas disa ditëve para kryqit prej druri të çelët, ku tashmë ishin shkruar emrat dhe mbiemrat që i kishin njësoj, u

vendos një pllakë varri me dy fotografi me korniza në formë vezore.

Sapo u krye lutja e fundit djaloshi i bukur u largua me shpejtësi. Pronarja e lokalit të zakonshëm të dajës, aty në të dalë të qytetit, u ftua në restorant. Pas varrimit shkoi gjithnjë në restorant që - në varësi të stinës apo motit - të shplohesh nga i ftohti apo i ngrohti si dhe lodhjet e tjera që një ngjarje e tillë sjell me vete. Bashkë me pronaren erdhën dhe ca burra e gra, po kështu klientë bazë të lokalit që unë s'do t'i kisha përfytyruar kurrë si njerëz me të cilët daja kalonte kohën. Kishin pamje qyteti, fytyra shumëngjyrëshe, e veç bezhë nuk ishin. Sa të dashur ishin të gjithë, e veç gjëra të bukura tregonin për dajën.

Edhe djaloshi me siguri do të më kishte pëlqyer, por s'e pashë kurrë më. Një ditë më telefonoi një punonjës nga banka për të cilën kishte punuar daja. Për mua ishte një librezë kursimi në dispozicion, por ama që të mund të bëja veprime me të më duhet të dija kodin. Unë fjalën e dija shumë mirë. Ishte emri i të atit.

përktheu nga gjermanishtja:
Majlinda Çullhaj

“Gjaku, trupat e njeriut, uji dhe breshri i kuq do të mbulojnë tokën” | Profecinë e frikshme të Nostradamusit për 2023

Michel de Nostradamus, i njohur më mirë si Nostradamus ishte një astrolog, mjek dhe psikik francez dhe ai botoi librin e tij të famshëm të profecive në 1555. Botëkuptimi i tij i errët besohet se është formuar nga Dhiata e Vjetër dhe trauma e humbjes së gruas dhe fëmijëve të tij nga sëmundjet, ndoshta murtaja. Në pamundësi për të shëruar ata që donte më shumë, ai u përpoq ta paralajmëronte njerëzimin paraprakisht për rreziqet që i kërcënonin.

Në librin e tij Nostradamus parashikon luftëra, murtaja, fatkeqësi natyrore, trazira civile, vrasje politike... Dhe ja çfarë paralajmëroi “profeti i dënimit” për vitin 2023.

Ngrohja globale dhe shumë peshq të ngordhur

Në një pasazh të vogël për shkatërrimin e detit, Nostradamus parashikon se “dielli do të djegë detin e



shndritshëm” dhe se “peshqit e Detit të Zi do të ziejnë të gjallë”. Hulumtimet e fundit sugjerojnë se, në fakt, shumë lloje peshqish, përfshirë ato që hahen më shpesh, mund të përballen me zhdukjen si rezultat i drejtpërdrejtë i ngrohjes globale.

Pallati Buckingham do digjet

Nostradamus parashikoi se në vitin 2023 bota do të shohë “zjarr qiellor mbi ndërtesën mbretërore”. Marrë fjalë për fjalë, kjo mund të nënkuptojë se

meteori shkon drejt e drejt Buckingham Palace. Në mënyrë metaforike, flakët mund të ndizen nga një serial i Netflix në të cilin Princi Harry dhe Meghan Markle transmetuan çfarë ndodh brenda familjes mbretërore britanike.

Lufta e Tretë Botërore

“Shtatë muaj një luftë e madhe, njerëz të vdekur nga e keqja” - kjo është ajo që pa Nostradamus dhe është asociacioni i parë me luftën shkatërruese në Ukrainë. Profecia tregon se konflikti në vitin 2023 do të përshkallëzohet në një luftë botërore, e cila, duke pasur parasysh arsenalet bërthamore, mund të barazohet me apokalipsin.

Antikrishti po vjen

Nostradamus shkruan se rreth vitit 2023 “antikrishti do ta shkatërrojë trinitetin”. “Lufta e tij do të zgjasë 27 vjet. Jobsimtarët do të jenë të vdekur, të kapur, të mërguar. Gjaku, trupat e njeriut, uji dhe breshri i kuq do të mbulojnë tokën”. Dhe ndërsa disa tashmë po përpiqen të kuptojnë se pas së cilës fuqi botërore fshihet antikrishti, as BabaVanga nuk ka lajme të mira as për vitin 2023.

Pesë profecitë e frikshme të Baba Vangës për vitin 2023

Parashikuesja e njohur konspirative Baba Vangja parashikoi 11 shtatorin dhe Brexit-in, fatkeqësinë e Çernobilit dhe vdekjen e Princeshës Diana.

Në profecitë e saj, ajo zbuloi gjithashtu atë që nuk presim në vitin e ardhshëm 2023.

Ndërsa shumë do të shpresojnë për një lajm të mirë në vitin 2023, megjithatë parashikimet e Baba Vangjës janë plot fatkeqësi dhe zymtësi.

Ndryshimi në orbitën e Tokës —

Baba Vangja parashikon se në vitin 2023 Toka do të përjetojë disi një ndryshim në orbitën e saj. Nuk specifikohet se çfarë do të thoshte ajo, por cilido qoftë ky ndryshim, ai mund të ketë pasojë katastrofike, pasi edhe ndryshimi më i vogël në ekuilibrin e lëvizjes së Tokës mund të çojë në ndryshime të padëshiruara dhe jashtëzakonisht të dëmshme në klimë dhe në nivelin e detit.

Nëse Toka i afrohet Diellit, do të përballemi me rritje të rrezatimit dhe temperaturave, duke rezultuar në shkrirjen e shpejtë të akullnajave, rritjen e nivelit të detit dhe një emergjencë globale; nëse planeti do të largohet nga



Dielli, ne do të shkonim në një epokë akullnajash me periudha më të gjata errësire, gjë që do të shkaktonte një grup krejtësisht të ndryshëm efektsh katastrofike për jetën në Tokë.

Armët Biologjike — Vangja njoftoi se një “vend i madh” do të kryente studime të armëve biologjike te njerëzit, të cilat do të rezultojnë me vdekjen e mijëra njerëzve. Megjithatë, në këtë kohë, Konventa e Kombeve të

Bashkuara për Armët Biologjike i ndalon këto lloj eksperimentesh. Përkundër kësaj, disa vende besohet se po punojnë fshehurazi tashmë shumë për të.

Shpërthimi bërthamor — Ndër parashikimet e Vangjës për vitin 2023 është edhe shpërthimi i një centrali bërthamor. Kjo profeci ogurzezë fiton peshë pas parashikimit të saj për fatkeqësinë e Çernobilit dhe në kontekstin e shqetësimit të botës

për situatën në Ukrainë. Edhe gabimi më i vogël në termocentralin bërthamor të Zaporizhzhya mund të çojë në një katastrofë që do të kishte pasojë të tmerrshme për shumë vende evropiane.

Stuhia Diellore – Një tjetër parashikim, megjithëse mjaft i paqartë, është ardhja e një stuhie masive diellore të një shkalle të paparë më parë në planetin Tokë. Stuhitë diellore janë në fakt

shpërthime të mëdha që ndodhin në Diell. Dielli më pas lëshon nivele të larta energjie dhe rrezatimi, të cilat mund të shkaktojnë probleme me sistemet GPS, komunikimet radio dhe satelitët që rrotullohen rreth Tokës.

Megjithatë, stuhitë më të fuqishme diellore të parashikuara nga Baba Vangja do të çojnë në dëmtime teknologjike dhe madje edhe ndërprerje masive të energjisë elektrike dhe prishje të komunikimit, të cilat mund të shkaktojnë një mori problemesh.

Fundi i lindjes natyrale – Vizioni i

Baba Vangjës për vitin 2023 përfshin fundin e lindjes natyrale të njeriut. Në këtë projeksion, autoritetet ndalojnë lindjen e fëmijëve dhe e gjithë jeta e njeriut kultivohet në laborator. Kështu, udhëheqësit dhe ekspertët mjekësorë mund të vendosnin se kush do të lindte, ndërsa prindërit mund të rregullonin karakteristikat dhe pamjen e tyre – si ngjyra e flokëve dhe e syve. Ky është padyshim një nga parashikimet më të çuditshme të Vanjas – dhe ushqen frikën për një rënie të nivelit të lindjeve.

Ndjesia e depresionit direkt pas festave: Si të përgatiteni që tani!



Tingëllon e çuditsme se si një periudhë e lumtur dhe festive, fill pas mbarimit të saj, mund të na lërë një ndjenjë boshllëku, mërzie.

Nëse kjo ju ndodh dhe ju, duhet të dini se nuk jeni vetëm dhe e gjithë ndjesia që keni është me e zakonshme sesa mendoni.

Mjekët amerikanë i quajnë "post-holiday blues" dhe fatmirësisht ka disa mekanizma që ta përballoni më mirë këtë periudhë dhe të ndiheni po aq mirë edhe pas datës 1 janar.

Fillimisht, njihuni me disa nga simptomat më tipike të "mërzitjes" pas pushimeve.

Zakonisht, ndjesia që merrni është e ngjashme me atë të zhgënjimit, ndonëse ju nuk e kuptoni se nga vjen ky zhgënjim. Ju mund të:

- Pendoheni për gjërat që keni bërë ose nuk keni thënë/bërë
- Ndjeni zbrazëti për shkak të një

orari të gjatë punë që ju ka lënë të festoni më pak

- Ndjeni vetmi, nëse nuk keni pranë vetes dikë të dashur

- Ndjeni trishtim që pushimet mbaruan ose që nuk ishin ashtu siç mendoni

- Keni probleme me gjumin për shkak të stresit ose emocioneve të vështira

Si të përgatiteni që ta kaloni sa më lehtë këtë periudhë

Mund të mendoni se është ende herët të mendoni për këtë, po do bëni mirë t'i dinit disa gjëra që mund t'ju ndihmojnë në afatgjatë.

Vendosni kufij për festat

Ndjenja e detyrimit për të marrë pjesë në çdo ngjarje me anëtarët e familjes me të cilët keni

probleme ose pjesëmarrja në tradita që nuk ju pëlqejnë mund të çojë në ndjenja zhgënjimi.

Ju gjithashtu mund të shihni postimet e lumtura të miqve të tjerë në rrjetet sociale dhe të ndjeni zili.

Ajo që ju mbetet të bëni është të vendosni kufij. Kufijet mund të nënkuptojnë anashkalimin e disa vizitave familjare apo vendosjen e disa kompromiseve/marrëveshjeje me njerëzit tuaj të dashur.

Ndryshoni mënyrën se si mendoni

Njerëzit mund ta kalojnë sezonin e festave duke pasur frikë për atë që vjen më pas. Kur e gjeni veten të frikësuar dhe pesimist, përpiquini të riformuloni mendimin tuaj. Për shembull, në vend që të thoni: "janari do jetë një muaj i tmerrshëm", mund të

thoni: "edhe pse do më mungojnë pushimet, do përqendrohëm në atë që është e rëndësishme për mua tani dhe do të jem mirënjohës për kohën që kam patur gjatë këtyre festave".

Vendosni një rutinë të vetë-kujdesit

Qëndrimi në një rutinë mund të jetë i vështirë gjatë festave, por është thelbësore që ju të keni një moment gjatë ditës, ku thjesht kujdeseni për veten.

Kjo qëndrueshmëri mund të ndihmojë me "post-holiday blues".

Nuk ka pse të jetë diçka madhështore, mund të jetë një shëtitje, pak minuta meditimi etj.

Mbështetuni te miqtë

Asgjë nuk është më terapeutike se një bisedë e sinqertë me një

mik të mirë. Mund të flisni me dikë dhe t'u tregoni atyre si ndiheni. Do të jetë sikur të jeni duke hequr një peshë nga trupi juaj.

Mirënjohja

Praktikoni mirënjohjen çdo ditë, edhe atëherë kur nuk ju vjen të thoni asgjë të mirë. Mund edhe të shkruani çdo ditë, tre gjëra për të cilat jeni mirënjohës.

Ekspertët e shëndetit mendonin se ndjesia e mërzitjes pas festave është një përgjigje normale ndaj përshtatjes me jetën pas pushimeve dimërore. Ajo shfaqet për arsye të ndryshme në njerëz të ndryshëm.

Nuk ka asgjë për t'u shqetësuar, megjithatë është e rëndësishme të kujdeseni për veten në çdo kohë!

Burimi: Healthline

Besohet se sjell PARA për 2023-shin, çfarë duhet të keni patjetër në tavolinën e natës së Vitit të Ri



Nata e madhe e ndërrimit të viteve në traditën e saj ka një tryezë me një shumëllojshmëri ushqimesh, por vetëm disa prej tyre duhet të konsumohen për të sjellë fat për vitin e ri që pason. Ja një listë për ushqimet fatsjellëse që duhet të konsumojmë:

Konsumoni perime me ngjyrë të gjelbër, kjo për arsyen e thjeshtë se ato janë të ngjashme me paratë, dhe në disa kultura besohet se konsumimi i tyre sjell mbarësi.

Konsumoni 12 kokrra rrush në mesnatën e ndërrimit të viteve. Kjo është një traditë spanjolle dhe portugeze, sipas së cilës, 12 kokrrat e rrushit simbolizojnë 12 muajt e

vitit pasardhës dhe konsumimi i tyre në këtë ditë të veçantë sjellë mbarësi për çdo muaj të vitit që do të vijë.

Konsumoni ushqime në formë unaze në vaktin e mëngjesit, për shembull, petullat e ëmbla apo edhe kekun e pjekur në tavën karakteristike në formë rrethore dhe me hapësirë boshe në mes. Ushqimi në këto forma përfaqëson ciklin e plotë të vitit, pra viti i ardhshëm do të jetë i plotë dhe i mbarë në çdo muaj apo stinë.

Përplasni një kokërr shegë në dysheme – Në Greqi, në natën e Vitit të Ri vendasit plasin një shegë në derën kryesore të shtëpisë, kjo bëhet me qëllim që nga shega të dalin sa më shumë kokrra që të

jetë e mundur, sepse kokrrat e saj simbolizojnë begatinë dhe mirëqenien.

Piqni peshk të pacopëtuar – Peshqit konsiderohen fatsjellës për tri arsye.

- 1- Luspat e tyre ngjasojnë me qindarkat, pra paratë.
- 2- Ata qëndrojnë në grupe, çka simbolizon unitet në familje.
- 3- Ata gjithmonë notojnë përpara, çka simbolizon progres.

Konsumoni makarona të gjata pa i thyer – Kjo është një traditë japoneze, sipas të cilës, makaronat e gjata simbolizojnë jetën e gjatë dhe fatin, por vetëm nëse i

hansi pa i thyer në copa të vogla.

Gatuani thjerrëza – Gjejini me çfarë ngjajnë thjerrëzat? PARATË. Po, këto bishtajore të vogla konsiderohen fatsjellëse në Itali dhe Brazil, dhe thuhet se janë konsideruar të tilla edhe nga romakët.

Gatuani një kek dhe fusni një monedhë në të kur ta piqni – Edhe kjo është një traditë greke e cila kërkon që të gatuhet një kek me shije limoni i quajtur vasilopita dhe kur të jetë gati për t'u pjekur, në të të futet edhe një monedhë. Personi të cilit i qëllon monedha konsiderohet me fat dhe viti i ardhshëm do të jetë i mbarë për të.





Çfarë është syri i keq dhe pse i frikësohemi kaq shumë



Folkloristi Alan Dandes shkruan në librin e tij “Syri i keq: Historia e rasteve më domethënëse”, se “fati, shëndeti i mirë apo pamja e bukur e viktimës, provokojnë një sulm nga dikush nëpërmjet syrit të keq”.

Simptomat e sëmundjes së shkaktuar nga syri i keq përfshijnë humbjen e oreksit, zverdhjen e tepruar të lëkurës, lehmën, të vjellat dhe temperaturën e lartë. Nëse objekti i sulmit është një lopë, qumështi i saj mund të shpërtojë; nëse është një bimë apo pemë frutore, ajo mund të thahet papritmas.

Sipas Armando Favacas, thuhet se syri i keq shkakton gjithashtu një sërë sëmundjesh të tjera përfshirë pagjumësinë, lodhjen, depresionin dhe diarrenë. Në shumë vende, këto simptoma konsiderohen si një çështje magjike dhe mjekësore, dhe arsyeja se përse një person i caktuar preket nga një sëmundjeje, mund t’i atribuohet një mallkimi të rastësishëm apo ekspozimit ndaj një virusi.

Madje sipas studiuesit Robert Elsi, mallkimi mund të prekë objekte dhe ndërtesa. Syri i keq mbi një automjet, mund ta prishë këtë të fundit në një mënyrë të pariparueshme, ndërsa një shtëpi

e mallkuar, mund të nisë të ketë probleme me çatinë që pikon kur bie shi, apo një sulm nga insektet. Gati çdo gjë që shkon keq, mund të shpjegohet me fuqinë e syrit të keq. Ky fenomen është i mirënjohur gjatë gjithë historisë. Ai përmendet në tekstet e lashta greke dhe romake, si dhe në shumë vepra të famshme letrare, duke përfshirë Biblën, Kur’anin, madje edhe në dramën e Shekspir.

Edhe pse besimi tek syri i keq është i përhapur, ai nuk është universal. Një studim ndërkulturor i vitit 1976 nga folkloristi Xhon Roberts, zbuloi se vetëm 36 përqind e kulturave besonin në konceptin e Syrit të Keq. Syri i Keq është një lloj mallkimi nëpërmjet magjisë, dhe i ka rrënjët tek besëtytnitë. Përpara se shkenca të shpjegonte modelet e motit dhe teorinë e mikrobeve, çdo ngjarje e keqe për të cilën nuk kishte një shkak të dukshëm, shpjegohej me një mallkim.

Mallkimet, duke përfshirë edhe syrin e keq, janë një përgjigje ndaj pyetjeve shumë të vjetër, se pse njerëzve të mirë u ndodhin gjëra të këqija. Thuhet se sytë kanë fuqi të veçanta; pasi ato janë “porta e shpirtit” të një njeriu. Lëvizja e shpeshtë e syve, besohet se i

tradhton gënjeshtarët.

Ndërkohë, një vështrim zhbirues mund të jetë tërheqës ose kërcënues në varësi të rrethanave. Kontakti me sy, mund të krijojë një lidhje intensive personale, qoftë midis të dashuruarve apo eprorëve dhe vartësve. Një vështrim ngulazi, mund të përcjellë fuqi dhe autoritet mbi një tjetër.

Aktorët i përdorin sytë e tyre për të përcjellë një gamë të gjerë emocionesh, duke përfshirë dashurinë, urrejtjen, neverinë, mërzinë, përbuzjen, habinë dhe zilinë. Në fakt, është xhelozia ajo që qëndron në themel të lidhjes kulturore të syrit të keq me magjinë.

Besimi tek fuqia e syve është aq i fortë, sa që çdo ndryshim tek sytë nënkupton fatin e keq. Njerëzit që kanë dridhje ose spazma të pakontrollueshme të syve (një gjendje e quajtur blefarospazma), shmangeshin nga të tjerët si provokues të fatit të keq, veçanërisht në mesin e atyre që punonin në profesione të rrezikshme si peshkimi dhe puna në minierë.

Po ashtu besohet se foshnjat e porsalindura dhe fëmijët, janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj dëmeve që mund të sjellë Syri i

Keq. Ndaj në shumë vende, si në Greqi, Rumani dhe Indi, lëvdimi publik i një fëmije konsiderohet ndonjëherë si një tabu, pasi komplimenti do të tërheqë vëmendjen e syrit të keq. Për të shmangur syrin e keq, prindërit e një fëmije, mund t’i kërkojnë personit që ka bërë komplimentin që ta pëshytyjë menjëherë në fytyrë fëmijën.

Sipas Entoni H.Galt “fëmijët mbrohen nga Syri i Keq përmes hajmalive të mbështjellë brenda veshjeve të tyre, të cilat për shembull në Itali përbëhen nga çanta të vogla pëlhere të kuqe (nganjëherë në formë zemre) që duken si jastëkë, dhe që përmbajnë një figurë imazhin e një shenjtorit, një bri të vogël prej ari, kthetrat e gaforres, apo një copë hekuri.

Po kush e ka syrin e keq? Ndoshta ju vetë. Shumë njerëz besojnë se për ta pasur syrin e keq, nuk është i nevojshëm ndonjë qëllim i keq. Ndaj disa njerëz mund të kenë syrin e keq edhe pa e ditur këtë. Nëse një person besohet se ka syrin e keq, edhe anëtarët e tjerë të familjes së tyre shihen shpesh me dyshim. Mënyra më e mirë për t’u përballur me syrin e keq, është ta shmangni atë nëse keni mundësi. Dhe metodat në këtë rast

ndryshojnë sipas kulturës, rajonit gjeografik dhe preferencës personale.

Në Amerikën Latine syri i keq njihet si “Mal de Ojo”, dhe ky besim është veçanërisht i përhapur në zonat rurale. Në Kubë, të sapolindurve u vendoset një hajmali fati e quajtur “azabache”, për t’i mbrojtur ata nga syri i keq. Hajmalitë më të shpeshta përdorin shpesh ngjyrën blu (që simbolizon qiellin ose hyjnoren), dhe një simbol të syrit. Por kundër syrit të keq, mund të përgatiten edhe ilaçe dhe magji. Hudhra përdoret shpesh për të penguar syrin e keq, dhe disa besojnë se vetëm duke thënë fjalën “hudhër” ajo ofron mbrojtje. Shumë shpesh, ata që besojnë se janë dëmtuar nga syri i keq do të kërkojnë ndihmën e shamanëve, shtriganëve, spiritualistëve për të hequr mallkimin.

Është joshëse të shihet syri i keq si një besim i lashtë, që nuk luan asnjë rol në botën tone tani. Por folkloristi Dandes, thotë se nuk duhet harruar se syri i keq, nuk është një besim supersticioz i modës së vjetër, pasi vazhdon të jetë një faktor i fuqishëm që ndikon në sjelljen e miliona njerëzve në të gjithë botën.

Këto 3 shenja të Horoskopit do kenë një fillim viti 'spektakolar'

DASHI

I dashur Dash, viti 2023 do të jetë fenomenal për ju, ndërsa përparoni si profesionalisht ashtu edhe personalisht. Do të fitoni një reputacion profesional dhe do të bëheni më të mirë në punën tuaj. Në planin privat do të keni dashuri dhe rehati në krahët e partnerit. Dashi 'single' do të takojë vazhdimisht një person që mund të jetë një zgjedhje e mirë për një partner. Ju lehtë mund të frymëzoni njerëzit përreth jush me rritjen tuaj. Në fillim të vitit do

të takoni njerëz me ndikim dhe do të zgjeroni rrethin tuaj profesional dhe personal të miqve. Paratë do të rrjedhin. Shtëpia juaj do të jetë e mbushur me energji harmonike. Në marrëdhëniet familjare, ju gjithmonë përpiqeni për harmoni, kështu që ajo do të realizohet.

DEMI

I dashur Dem, disiplina, qëndrueshmëria dhe vendosmëria juaj në fillim të vitit

është thjesht fenomenale. Jeni të fortë dhe jepni shembull për të tjerët. Fillimi i vitit 2023 është i mbarë, sepse ju mund të jeni të respektuar kudo që të shkoni për shkak të virtyteve tuaja. Në rrethet shoqërore, të tjerët do të konsultohen me ju se si ta thjeshtoni jetën tuaj dhe të përmirësoni cilësinë e saj. Do të kontribuoni në suksesin e shumë njerëzve duke hapur sytë ndaj mundësive të mëdha. Biznesi juaj do të zgjerohet dhe puna juaj do të sjellë sukses. Marrëdhëniet

do jenë pozitive dhe të kënaqshme. Do të zhvilloheni në planin e dashurisë, por nuk do bëni përpjekje vetëm, por edhe partneri juaj do të kontribuojë në përmirësimin e marrëdhënies. Fillimi i vitit është i favorshëm për fillimin e një biznesi të ri. Vazhdoni të kujdeseni për shëndetin tuaj.

UJORI

Të dashur Ujorë, pavarësisht se cilën fushë keni zgjedhur dhe në cilën fazë jeni në planin tuaj

profesional, do të arrini sukses të jashtëzakonshëm në gjysmën e parë të vitit. Njerëzit rreth jush do të jenë kureshtarë dhe xhelozë në të njëjtën kohë, se si mund të jeni kaq të suksesshëm në gjithçka. Disa do të përpiqen të mësojnë nga ju, disa do të përpiqen të jenë miq me ju që të jenë më afër jush dhe të mësojnë sekretet e suksesit. Këto mënyra të reja të punës do të përmirësojnë gjithashtu efikasitetin dhe menaxhimin tuaj të kohës. Ju keni cilësi të shkëlqyera si lider.



Kujdes! Këto 4 shenja astrologjike do të kalojnë festa katastrofike



Ah festat e fundvitit! Disa i adhurojnë e të tjerë i urrejnë. Këtë fundvit, këto 4 shenja zodiaku duhet të bëjnë kujdes. Priten goxha probleme.

GAFORRJA

Në përgjithësi personat e kësaj shenje nuk janë fansa të festave të fundvitit. Ata preferojnë të qëndrojnë në strehëzën e tyre vetëm ose me miqtë, më shumë sesa me familjen. Këtë dhjetor do jenë disi më pasivë agresivë dhe kjo gjë do shkaktojë konflikte. Kujdes!

BINJAKËT

Edhe personat e kësaj shenje do kalojnë disa momente jo të mira këtë fundvit dhe gjithçka për faj të tyre. Kohët e fundit ata nuk kanë qenë shumë të ndershëm me personat që i rrethojnë dhe kjo gjë ka rrezik të nderzë

konflikte në familje ose në shoqëri. Epo çfarë të keni mbjellë do të korrni... Një këshillë për ta: "Kërkoni falje dhe niseni me këmbë të mbarë 2023-in."

PESHQIT

Personat e kësaj shenje do fillojnë ta ndiejnë që shpejt stresin dhe ankthin e festave të fundvitit. Duan apo nuk duan ata do jenë të detyruar të qëndrojnë pranë njerëzve që nuk i vlerësojnë. Le të bëjnë si të bëjnë sepse viti i ri do jetë viti i tyre.

SHIGJETARI

Personat e kësaj shenje nuk kanë kaluar një vit të lehtë dhe duket se gjërat jo të mira nuk kanë përfunduar ende. Shigjetarët do bëjnë një përmbledhje të gjithçkaje të kaluar dhe do ndihen keq.

Këto ndryshimet duhet t'i bëni gjatë vitit 2023



Me ardhjen e 2023, të gjithë me siguri jemi të zënë duke planifikuar dekorimet e Vitit të Ri. Por pas festës vjen dita e Vitit të Ri dhe bashkë me të një kohë për të menduar për synimet e reja.

Shkoni përtej rezolutave tipike si të shkoni në palestër dhe merrni në konsideratë më shumë ide jashtë të zakonshmes, si të mësoni se si të investoni paratë tuaja, të kaloni kohën tuaj vullnetare për bamirësi ose të provoni një hobi të ri.

Pavarësisht se cilën rrugë zgjidhni, ka shumë mënyra për të krijuar një jetë më të lumtur dhe më të shëndetshme në vitin e ri.

Një kompliment i vogël mund të bëjë dikë të lumtur. Në fakt, studime kanë treguar se marrja e një komplimenti mund të rrisë

pozitivitetin në marrëdhënie dhe të rrisë lumturinë e përgjithshme. Dhe dhënia e komplimenteve mund të jetë po aq frymëzuese sa edhe marrja e tyre – kështu që do t'ua ndriçoni ditën e tyre dhe tuajën!

Shëndeti duhet të jetë i pari

Këtë vit mundohuni që vërtet të bëni një ndryshim të rëndësishëm për shëndetin tuaj. Për personat që përtojnë apo mendojnë se janë shumë të zënë për të përgatitur mëngjes, drekë dhe darkë në shtëpi dhe preferojnë që të marrin diçka të gatshme, është momenti që të ndryshojnë zakonet e tyre në të mirë të shëndetit.

Duke ngrënë ushqime të gatuar me kujdes në shtëpitë tuaja, ju siguroheni për

produktet e përdorura dhe do të shihni menjëherë ndryshim në trupin tuaj.

Për duhanpirësit, themi që është momenti që të heqin dorë nga zakone të tilla të dëmshme.

Le të biem dakord që pirja e cigares është kaq modë e vjetër. Tanimë ka plot metoda për ta bërë këtë process më të lehtë dhe të përballeshëm. Përmes reduktimit të dëmit, një nga konceptet më premtuese, edhe për duhanpirësit e rritur të cilët zgjedhin të vazhdojnë këtë zakon prej nikotinës, ka mundësi të cilat arrijnë të reduktojnë toksinat e dëmshme të tymit të cigares deri në 95%.

Bëhet fjalë për cigaret elektronike, apo

pajisjet e duhanit me ngrohje, të cilat janë zgjidhje të bazuara në shkencë e të ndërtuara me teknologjinë e fundit.

Shkëputuni pak nga mediat sociale

Bërja e një pushimi nga mediat sociale mund të ndihmojë në uljen e ndjenjave të stresit, ankthit dhe depresionit të shkaktuara nga navigimi i tepërt në internet. Aplikacione si Instagram madje kanë lançuar një opsion të ri "Take a Break" për të inkurajuar përdoruesit e rinj të thyejnë ciklin e lëvizjes dhe të dalin nga aplikacioni pas një kohe të caktuar. Ndaj këtë vit bëni ndryshime në dukje të vogla por që kanë rezultate direkte.

Shkencëtari i njohur bën 3 parashikime për të ardhmen

Michio Kaku është një nga komunikuesit më të mëdhenj të shkencës. Me libra shkencorë popullore që nga vitet 1980 dhe shfaqje të panumërta televizive, ai është i mirënjohur për publikun që kërkon të mësojë më shumë rreth shkencës moderne.


Kaku është gjithashtu akademik i respektuar, pasi ka botuar punime dhe tekste shkollorë mbi tema të fizikës si teoria e fijeve.

Ashtu si njerëz të tjerë që studiojnë shkencën dhe kanë një kuriozitet të lindur, Dr. Kaku është i interesuar për një gamë të gjerë temash dhe është i gatshëm të flasë për një numër prej tyre.

Këto janë tri parashikimet e akademikut amerikan për të ardhmen:

Njerëzit do të bëhen specie ndërplanetare

Duke pasur parasysh paratë, nivelin e angazhimit si nga



burimet qeveritare ashtu edhe nga ato private, dhe vizioni që ekziston pas disa prej ideve të paraqitura Dr. Kaku është optimist se njerëzimi është gati që të kalojë në një "epokë të artë të eksplorimit të hapësirës".

Sigurisht, ai është praktik edhe për problemet me të cilat do të përballëshim nëse do të përpiqeshim të zhvendosim një milion njerëz në Mars.

Për shembull, ai vë në dukje se pak njerëz duket se shpjegojnë

ndonjëherë se si të sigurojnë strehim për një milion njerëz në Mars, ose se si do të përpiqeshin të merrnin mjetet e nevojshme për t'i ndërtuar godinat atje. Ai sugjeron se përgjigja mund të jetë mbështetja në robotët

"vetëpërsëritës", por kjo kërkon shpikjen e tyre së pari.

Ne do të zgjerojmë kapacitetet e trurit

Duke pasur parasysh përparimin e shkencës në prodhimin e çipave kompjuterikë më të lirë, më të vegjël dhe më të shpejtë, të njohur si Ligji i Moores, Dr. Kaku sugjeron se ka të ngjarë të jetë vetëm një çështje kohe përpara se të kemi akses në kompjuterë të lirë kudo gjatë gjithë kohës – duke përfshirë këtu edhe tek ata të integruar tek njerëzit. Ai ofron një imazh të një bote të re të guximshme të teknologjisë së lartë.

Do të mposhtim kancerin

Dr. Kaku argumenton se ne jemi shumë pranë mposhtjes së kancerit njëherë e përgjithmonë dhe të përfshihemi në një epokë të re të zbulimeve shkencore.

Si të shkrepni fotot më të mira këtë sezon festiv

Nëse ka diçka që çdokush bën para dhe pas çdo eventi, është shkrepja e fotove dhe postimi i tyre në rrjetet sociale. Jo vetëm që i bën mediat tona sociale më interesante, por gjithashtu na ndihmon të ruajmë momente të çmuara dhe t'i ngulitim ato në kujtimet tona përgjithmonë.

Teknikat e mëposhtme do t'ju ndihmojnë të bëni foto profesionale edhe nëse jeni fillestar.

Gjeni këndin më të mirë

Rregulli i artë i fotografisë është të zgjidhni një kënd të mirë përpara se të bëni fotot. Rregulli bazë që ndjekin shumë fotografë gjatë kapjes së fotografive me kënd të gjerë është vendosja e subjektit drejt qosheve ekstreme. Kjo i bën fotot tuaja të duken profesionale dhe tërheqëse.

Drita ka rëndësi

Asnjë shkrepje nuk është e përsosur pa dritë të mirë. Pra, nëse është pema e Krishtlindjes ose torta e shijshme ajo që kërkon aftësitë tuaja fotografike, sigurohuni që të rregulloni dritën përpara se të bëni fotografinë tuaj. Mund të merrni ndihmë nga drita natyrale pasi është alternativa më e mirë. Megjithatë, nëse drita natyrale nuk është një opsion i mundur, dritat artificiale



do të funksionojnë po aq mirë. Drita e verdhë është një zgjedhje e mirë, pasi ato janë të këndshme dhe e përmirësojnë subjektin pa e bërë shumë të shndritshëm.

Tripodi mund të jetë një shpëtimtar

Nëse përfundoni duke bërë foto të paqarta për shkak të një dore që dridhet, mund t'ju vijë në ndihmë një Tripod. Kjo do të sjellë qartësi në fotot tuaja dhe do t'ju japë hapësirë për të

eksperimentuar.

Mos i bëni fotografitë të duken të rrëmujshme

Kjo mund të jetë një detyrë për shumë njerëz. Në mënyrë që të shkrepni fotografinë e përsosur, duhet të shmangni rrëmujën nga fotot. Tërhiqni vëmendjen te subjekti kryesor, por sigurohuni që sfondi të duket po aq interesant sa tema. Megjithatë, kjo nuk duhet të shërbejë si shpërqendrim nga tema kryesore.

Pra, vendosni kapelen e fotografit dhe filloni të eksperimentoni me fotot tuaja. Kjo mund të kërkojë pak përpjekje, por pasi të keni filluar gjithçka do të jetë më e lehtë.

Provoni mënyra të ndryshme

Pavarësisht nëse përdorni kamerën e celularit ose një aparat fotografik, kalimi midis modaliteteve ndihmon gjithmonë të klikoni foto më të

mira. Mund të kërkojë pak kohë për të zbuluar se cili modalitet funksionon më mirë për një fotografi të caktuar, pasi ta keni kuptuar këtë, mund ta zbatoni atë rregull kudo. Nëse sapo po filloni, shmangni luajtjen me modalitetet dhe vazhdoni me cilësimet automatike të kamerës suaj. Kjo do t'ju shpëtojë nga telashet dhe mund të klikoni lehtësisht fotografitë e mira. Megjithatë, me kohë, eksperimentoni dhe mësoni të përdorni ato opsione të reja.



Nga Hailey Bieber te Kate Middleton, 10 ikonat e stilit të vitit 2022

Në fund të çdo viti mediat bëjnë gjithnjë një bilanc përfundimtar për filmat, fotot, protagonistët apo personazhet që kanë qenë në krye të titujve apo që kanë lënë gjurmë. Por revista italiane Grazia ka përzgjedhur 10 ikonat e stilit që kanë kaluar në tapetin e kuq për vitin 2022 nga Oscars te MET Gala.

Duke shqyrtuar ngjarjet dhe daljet që kanë shkaktuar më shumë zhurmë janë përzgjedhur 10 personazhet e famshëm që na kanë mbetur në mendje me veshje dhe aksesore që nuk do t'i harrojmë kurrë. Viti 2022 ishte një vit i plotë i rikthimit në ngjarjet sociale,

festivale, shfaqje mode, i të ftuarve dhe premierave të filmave, që riktheu fytyra që nuk ishin parë prej kohësh dhe shenjtëruan emra të rinj. Rihanna i ka dhënë një formë të re stilit të maternitetit, me polemikat e zakonshme në rrjetet sociale; Jessica Chastain ka përqafuar kauzat politike dhe frymëzimin e Alessandro Michele. Krahas tyre shumë emra që janë sinonim i stilit sublim dhe hyrjeve të reja për të cilat do të dëgjojmë gjatë. Nga Hailey Bieber te Kate Middleton dhe Zendaya zbuloni se cilët janë dhjetë të famshmet e veshura më mirë të vitit 2022.



Princesha ka treguar anën e saj të gjithanshme dhe të qëndrueshme



10. Hailey Bieber është renditur në vendin e dhjetë. Në dymbëdhjetë muajt e fundit ajo ka shfaqur disa pamje që kanë pasur sukses të madh.



8. Për Kate Middleton ky ka qenë një vit i shkëlqyer edhe për sa i përket garderobës. E kemi parë të veshur në shumë mënyra dhe në çdo rast ka goditur në shenjë.



9. Simon Ashley. Sezoni i dytë i Bridgerton, ku ajo kishte rolin kryesor, e ndihmoi të bëhej një nga personazhet e famshëm më të pranishëm në tapetet e kuqe ndërkombëtare dhe gjithashtu një nga më të dashurat.



7. Ikonat nuk ikin. Dhe Naomi Campbell, fytyra dhe trupi që bëri historinë e modës, nuk ka dalë kurrë nga moda. Në 12 muajt e fundit, ajo ka shkruar disa nga faqet më prestigjioze të sistemit të modës



Iris Law, modele dhe aktore, ka lënë gjurmë me çdo paraqitje përgjatë këtij viti.



Një nga zbulimet e vitit ishte Sydney Sweeney. Protagoniste e Euphoria dhe The White Lotus.



Pas një periudhe të gjatë larg skenës, Rihanna është rikthyer në momentin që më së paku pritej. Periudha e shtatzënisë ishte e mbushur me ngjarje, lajme dhe kërtime për të.



Jessica Chastain, një bukuri që ngjall kinemanë hollivudiane të shekullit të kaluar, por një modernitet i jashtëzakonshëm i diktuar nga zgjedhja e një partneri marke që di ta përmirësojë dhe ta bëjë atë unike



Pas një kohe larg bliceve, ky ishte padyshim viti i saj. Anne Hathaway është sërish ylli i padiskutueshëm i tapeteve të kuq dhe ngjarjeve kryesore. Dhe këtë e bëri me stil, falë marrëveshjeve me marka si Bulgari dhe Valentino, të cilat e bënë të shkëlqejë si kurrë më parë.



Mbretëresha e vitit 2022 ishte Zendaya. Ylli i Euphoria dhe Dune është një emër i njohur prej kohësh, por asnjëherë si në 12 muajt e fundit nuk e kemi parë kaq të lidhur me imagjinatën e modës bashkëkohore.



Pse të pasurit bëhen më të pasur, edhe gjatë krizave globale?

Vdekja dhe shkatërrimi nuk janë kartat e vetme për të cilat do të mbahet mend COVID-19. Pandemia gjithashtu ka zgjeruar në mënyrë drastike pabarazitë në të gjithë globin gjatë tre viteve të fundit.

Sipas Indeksit të Miliarderëve të Bloomberg, 131 miliarderë më shumë se dyfishuan vlerën e tyre neto gjatë pandemisë.

Personi më i pasur në botë, shefi i Louis Vuitton, Bernard Arnault, kishte një pasuri prej 159 miliardë dollarësh në 27 dhjetor 2022, me rreth 60 miliardë dollarë në krahasim me fillimin e vitit 2020.

Elon Musk, njeriu i dytë më i pasur në planet, mburrej me një pasuri prej 139 miliardë dollarësh, diçka më pak se 50 miliardë dollarë para pandemisë.

Dhe Gautam Adani i Indisë, i treti në indeks, ka parë rritjen e pasurisë së tij më shumë se dhjetëfish në këtë periudhë, nga afërsisht 10 miliardë dollarë në fillim të 2020-s në 110 miliardë dollarë në fund të 2022-t.

Në të njëjtën kohë, afër 97

milionë njerëz – më shumë se popullsia e çdo kombi evropian – u shtynë në varfëri ekstreme vetëm në vitin 2020, duke fituar më pak se 1.90 dollarë në ditë (kufiri i varfërisë i përcaktuar nga Banka Botërore).

Norma globale e varfërisë vlerësohet të jetë rritur nga 7.8 për qind në 9.1 për qind deri në fund të vitit 2021. Tani, rritja e inflacionit në qiell po ndikon në rritjen e pagave reale, duke ngrënë të ardhurat e disponueshme të njerëzve në mbarë botën.

Për të frenuar rritjen e çmimeve, bankat qendrore po reduktojnë fluksin e parave në ekonomi duke rritur normat e interesit dhe duke tërhequr likuiditetin e tepërt.

Por kjo ka goditur sërish punëtorët, me kompanitë – nga firmat e teknologjisë si Amazon, Twitter dhe Meta tek bankat si Goldman Sachs – duke njoftuar pushime nga puna në fund të një 2022-shi tashmë të trazuar.

“Al Jazeera” foli me ekonomistët për të kuptuar pse të pasurit vazhdojnë të pasurohen edhe në mes të krizave dhe nëse kjo



është e pashmangshme sa herë që ka një ngadalësim ekonomik.

Përgjigja e shkurtër: Shumë vende miratojnë politika të tilla si uljet e taksave dhe stimujt

financiarë për bizneset për të nxitur ekonominë në mes të krizave si pandemia.

Bankat qendrore e vërshojnë ekonominë me para për ta bërë më të lehtë huadhënien dhe

shpenzimin.

Kjo i ndihmon të pasurit të rrisin paratë e tyre përmes investimeve të tregut financiar. Por zgjerimi i pabarazisë nuk është i pashmangshëm.

Pandemia ka ndikuar te miopia e adoleshentëve, në 2050 do të jenë shumicë në botë

Miopia, pra vështirësia për të parë nga larg, është një nga problemet shëndetësor e më të përhapura në botë, veçanërisht në dekadat e fundit. Edhe pse faktori gjenetik është shumë i rëndësishëm në përcaktimin e personave miopë, mund të thuhet se ky defekt është përhapur në mënyrë pothuajse paralele me zhvillimin teknologjik të njeriut.

Orë të tëra përballë celulareve dhe monitorëve të ndryshëm, shpesh herë me një distancë të pamjaftueshme, e kanë shndërruar pothuajse në një mungesë të zakonshme. Sipas statistikave amerikane, në vitet '70 miopët në SHBA nuk kalonin 25% të popullsisë, ndërkohë që vetëm pak dekada me vonë kjo shifër ka shkuar në 42%.

Sipas një studimi të Universitetit Emory në Atlanta, tre vitet ku po përjetojmë efektet e pandemisë së COVID-19 kanë qenë një tjetër përshpejtues të miopisë, veçanërisht tek adoleshentët.

Detyrimi për t'u mbyllur në banesa për një periudhë të gjatë ka rritur ndjeshëm konsumin e

mjeteve digjitale, duke ndikuar sipas përllogaritjeve në një variacion – 0.3 të dioptrisë tek të rinjtë.

Syri i njeriut është programuar për të parë nga larg, një horizont që lejon një fokus më të lehtë, sesa kur kemi të bëjmë me objekte afër syrit, diçka që shkakton lodhje.

Jo kudo në planet ndikimi do të jetë i njëjtë, edhe duke u bazuar te trashëgimia gjenetike. Parashikimet tregojnë për një popullsi europiane që në vitin 2050 do të jetë miopë në rreth 30% të popullsisë së saj, por në SHBA do të jenë 40% kurse në vendet aziatike si Kina, Koreja e Jugut, Singapori, kjo shifër shkon në një 80% të frikshëm. Në rang botëror, miopët do të jenë shumicë pikërisht brenda asaj date.

Ndoshta një ngushëllim për ta vjen nga studime të tjera, të filluara qysh nga vitet '50-të që tregojnë, edhe pse ende jo në mënyrë të mirëpërcaktuar, se miopia shpesh herë shoqërohet më një kuocient inteligjence më të lartë se mesatarja.





Gëzuar 2023!

www.epokaere.com

SPORT

Khudoja 'mbulon' Kosovën me medalje, Messi merr edhe Kupën e Botës

EPOKA
ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, DHJETOR, JANAR - Viti 2022 ka qenë i jashtëzakonshëm në rrafshin vendor dhe ndërkombëtar. Sportistët e Kosovës kanë shkëlqyer gjatë këtij viti, kurse sporti i xhudos, në krye me trajnerin Driton Kuka, ka mbledhur medaljet në secilën kampionat e garë që ka marrë pjesë, duke qenë edhe një herë sporti kryesor në Kosovë. Xhudistja Distria Krasniqi ka pasur një vit të suksesshëm, pa harruar edhe xhudistet e tjerë. Ndërsa boksierja Donjeta Sadiku i ka siguruar Kosovës medalje botërore në Kampionatin Botëror të Boksit në Stamboll të Turqisë. Ndërsa skuadra e Ballkanit bëri histori fillimisht në rrafshin vendosur duke fituar titullin, më pas shkroi historinë edhe në arën ndërkombëtare, ku e siguroi pjesëmarrjen në grupet e Ligës së Konferencës. Në sportin ndërkombëtar vlen të ceket se Leo Messi dhe Argjentina kanë fituar titullin e Botës pas një kohe tepër të gjatë. Në këtë mënyrë "Pleshti" rrëmben edhe trofeun që i kishte munguar. Ndërkohë "Topin e Artë" e fitoi Karim Benzama që shkëlqeu me Realin e Madridit duke fituar Ligën e Kampionëve dhe La Ligën. Një sukses që gëzoi të gjithë shqiptarët pa masë ishte fitorja e Zvicrës së Xhakës, Shaqirit dhe Jasharit ndaj Serbisë.



Khudoja e Kosovës shndrit botën

JANAR-DHJETOR - Xhudoja e nisi mirë vitin 2022. Më 5 shkurt kampionia olimpikë Distria Krasniqi fitoi medaljen e argjendtë në Grand

Slamin e Parisit. Para rreth 12 mijë shikuesve, xhudistja Krasniqi u mund në finale nga francezja nënkampione olimpikë, Amandine Buchard, kategoria -52 kg. Në Grand Slamin e Parisit debutoi si trajnere kampionia olimpikë Majlinda Kelmendi. Në fund të marsit xhudoja i solli Kosovës edhe dy medalje. Fatjona Kasapi e fitoi medaljen e artë, ndërsa Erza Muminoviq të bronzit, në Kupën Evropiane U-21 që u mbajt në Greqi.

Edhe muaji prill ishte i bereqetshëm. Kampionia olimpikë, Distria Krasniqi, ka fituar medaljen e bronzit në Kampionatin Evropianin të xhudos në Sofia të Bullgarisë. Ajo për të bronzitën mundi gjermanen Mascha Ballhaus, kategoria -52 kilogramë, ndërsa Laura Fazliu për herë të parë në karrierë është shpallur nënkampione e Evropës. Laura fitoi medaljen e argjendtë në kategorinë -63 të Kampionatit Evropian "Sofia 2022". Distria Krasniqi është krenari e sportit dhe shtetit të Kosovës, pasi më 3 qershor në Tbilisit të Gjeorgjisë fitoi medaljen e artë në Grand Slamin e Xhudos. Krasniqi në finale mundi Reka Pupp të Hungarisë.

Xhudoja në fund të muajit qershor ka lënë gjurmë edhe në Lojërat Mesdhetare "Oran 2022". Distria Krasniqi ka vazhduar me medalje të arta në Lojërat Mesdhetare. Kampionia olimpikë fitoi të artën në Oran, kategoria -52 kg. Ajo në finale mundi Ana Viktorija Puljiz të Kroacisë. Flaka Loxha i solli Kosovës medaljen e dytë. Ajo në luftën për të bronzitën mundi turken Hasret Bozturk, kategoria -57 kg. Edhe dita e pestë në Lojërat e 19-ta Mesdhetare Oran 2022 ka qenë e suksesshme për sportin e Kosovës. Xhudistët fituan edhe dy medalje, nga tre garues që dolën në tatami. Laura Fazliu fitoi medaljen e artë në kategorinë deri në 63 kilogramë. Ajo në finale mundi spanjollen Perez Cabana. Medalje, por të bronzit, e fitoi edhe Akil

Gjakova. Ai triumfoi në luftën për të bronzitën ndaj italianit Manuel Lombardo, kategoria -73 kg. Lorian Kuka është bërë e artë në Lojërat Mesdhetare, duke i sjell Kosovës medaljen e gjashtë, të tretën të artë. Xhudistja Kuka mundi në finale francezen Chloe Buttigieg, kategoria -78 kg. Është kjo medalja e pestë nga sporti i xhudos. Në muajin tetor edhe një herë në skenë ka dalë xhudistja Distria Krasniqi, duke vazhduar me sukseset e saj në arenën ndërkombëtare. Kampionia jonë olimpikë "Tokio 2020" u stolis me medaljen e bronzit në Kampionatin Botëror të Xhudos në Tashkent të Uzbekistanit. Për Krasniqin ishte medalja e dytë e bronzit botërore si seniore. Ajo fitoi edhe një mijë pikë olimpikë për Lojërat Olimpikë Paris 2024. Në cilësinë e trajneres ishte dy herë kampionia e botës, Majlinda Kelmendi. Ekipi i xhudos fitoi edhe dy medalje në Grand Slamin e Xhudos në Abu Dhabi të Emirateve të Bashkuara Arabe. Kampionia olimpikë, Nora Gjakova, fitoi medaljen e argjendtë në kategorinë -57 kg. Nora iu rikthye tatamit, por edhe podiumit, pas 15 muajsh mungesë për shkak të lëndimit. Të bronzitën e fitoi Lorian Kuka në kategorinë -78 kg. Në luftën për të bronzitën mundi francezen Audrey Tcheumeo, nënkampione olimpikë 2016. Në muajin dhjetor dhe të fundit për

vitin 2022 Distria Krasniqi e ka fituar medaljen e artë në Mastersin e xhudos "Jerusalem 2022". Në finale Distria mundi britaniken Chelsie Gilles, kategoria deri në 52 kilogramë.

Akademia Olimpikë e KOK-ut pranohet në IOA

26 JANAR - Akademia Olimpikë e Komitetit Olimpik të Kosovës është bërë anëtare me të drejta të plota në Akademinë Olimpikë Ndërkombëtare (IOA). Qëllimi i Akademisë Olimpikë të Kosovës është t'i promovojë vlerat olimpikë dhe shpirtin olimpik në Kosovë, me fokus të veçantë edukimin e stafit profesional në fushën e sportit.

Mallorca blen kartonin e Muriqit, Rashica shkon në Turqi, Shaqiri në Amerikë

10 SHKURT - Në afatin kalimtar të verës lëvizjen e futbollistëve shqiptarë nuk ishin të pakta. Mallorca e ka blerë kartonin e sulmuesit të Kosovës, Vedat Muriqi për 12 milionë euro nga Lazio, kurse Milot Rashica në formë huazimi iu ka bashkuar Galatasrayt. Në anën tjetër, një tjetër yll shqiptar, Xherdan Shaqiri nga Lyoni kaloi në futbollin amerikan (MLS), Chicago Fire.

Armando Broja u rikthye te skuadra e Chelseat, derisa Adnan Januzaj nga Real Sociedad kaloi te Sevilla. Skuadër ndërroi edhe portieri i Kosovës, Arijanet Muriqi, i cili iu bashkua Burnleyt.



Albin Tahiri arriti rezultat historik në Lojërat Olimpikë Dimërore

10 SHKURT - Albin Tahiri ka zënë vendin e 15-të nga 27 garues në disiplinën e kombinimit alpin, që përbëhet nga lëshimi dhe sllallomi. Në lëshim ishte i 22-ti. Është kjo pozita më e mirë në karrierën e tij në Lojërat Olimpikë Dimërore dhe, po ashtu, rezultati më i mirë për Kosovën. Koha e tij nga dy lëshimet ishte 2 minuta e 48.29 sekonda.



Giresse zëvendëson Challandesin te Kosova

23 SHKURT - Trajneri francez Alain Giresse në muajin shkurt është emëruar përzgjedhësi i Kosovës në futboll. Giresse që e zëvendësoi Bernard Challandesin, me rastin e prezantimit, ka deklaruar se ndihet i nderuar që do të jetë në krye të Përfaqësueses së Kosovës dhe se nuk ka hezituar fare ta pranojë ofertën e FFK-së. Trajneri francez ka drejtuar në disa ndeshje "dardanët", por synimi i tij dhe Kosovës është kualifikimi në Kampionatin Evropian 2024.



Akademinë Olimpikë Ndërkombëtare (IOA)

Ramadani fiton medaljen e argjendtë në Kupën Evropiane dhe në Kampionatin Mesdhetar

13 MARS - Atleti Muhamet Ramadani ka vazhduar shkëlqimin e tij në arenën ndërkombëtare. Ai fitoi medaljen e argjendtë në Kupën Evropiane të Atletikës në hedhje për grupmoshën U-23, që u mbajt në Leiria të Portugalisë. Nga gjashtë hedhjet e tij, rezultati më i mirë ishte 18.60 kilogramë. Për Ramadanin kjo ishte gara e parë e hedhjes së gjyles 7.260 kg. Ramadani fitoi medaljen e argjendtë edhe në Kampionatin e 4-të Mesdhetar U23 që u mbajt në Pescara të Italisë.

Suksesi i Nexhat Sahitit në Kampionatin Evropian të Shenjëtarisë

28 MARS - Shenjëtari Nexhat Sahiti ka vazhduar formën e mirë, duke përmirësuar rezultatet e tij në arenën ndërkombëtare. Bursisti Olimpik për Paris 2024 zuri vendin e 16 nga 65 garues në Kampionatin Evropian në Hamar të Norvegjisë. Nexhati grumbulloi 577 rrathë, në pistoletë ajrore 10 metra, po aq sa kishte edhe vendi i 13. Seria e fundit e tij ishte e pafat, pasi me tri pikë më shumë do të hynte në çerekfinale.

MKRS-ja mbështet KOK-un me 680 mijë euro

1 PRILL - Komiteti Olimpik i Kosovës ka nënshkruar memorandumun e bashkëpunimit me Ministrinë për Kulturë, Rini e Sport për vitin 2022. Memorandumi u nënshkrua nga presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi dhe ministri Hajrullah Çeku. Memorandumi parashihet mbështetje financiare të MKRS-së për KOK-un gjatë vitit 2022, mbështetje kjo që ka shënuar rritje krahas me vitet e kaluara. KOK-u do të mbështetet 680 mijë euro. Shuma e përgjithshme e mbështetjes së MKRS për KOK-un, federatat e sportit dhe Komitetin Paralimpik vetëm përmes memorandumëve vjetore është mbi 3.7 milionë euro. Përveç mbështetjes së federatave, do të ketë edhe mbështetje të sportistëve, trajnerëve dhe shpresave olimpikë në bazë të kategorizimit të KOK-ut.



Presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi dhe ministri Hajrullah Çeku

Jakupi dhe Sylja fitojnë medalje të bronzta në Evropianin e të Rinjve në Boks

21 PRILL - Dy boksierët e rinj, Taulant Jakupi dhe Donat Sylja, pësuan humbje në gjysmëfinale të Kampionatit Evropian U-18 që po mbahet në Sofje të Bullgarisë. Të dy e mbyllën evropianin me medalje të bronzta pas fitoreve të shënuara në çerekfinale. Fitimi i dy medaljeve të bronzta në një garë të nivel të tillë vlerësohet sukses për Federatën e Boksit të Kosovës e cila u përfaqësua me katër boksierë.

Besa Famgas dominon në hendbollin e meshkujve, Istogu te femrat

15 MAJ - Besa Famgas e ka fituar titullin e 16 në Superligën e Kosovës në Hendboll. Këtë sukses skuadra pejana e arriti pas fitores ndaj Prishtinës në kryeqytet. Por, ky titull është i veçantë, pasi Besa e fitoi duke mos lëshuar asnjë pikë gjatë gjithë kampionatit. Në 28 ndeshjet ata arritën 28 fitore. Besa Famgas është shpallur edhe fituese e Kupës për edicionin 2021/2022, pasi në finalen e luajtur në palestrenë "Bill Clinton" në Ferizaj mposhti Kastriotin me rezultat 30:24. KHF Istogu e ka fituar titullin e dytë në histori, pasi e mposhti në palestrenë "Bill Clinton" Ferizajn me rezultatin 26-25. Ishte kjo fitorja e dytë e hendbollistëve të Istogut në serinë finale të plejofit. Ndeshjen e parë të luajtur të shtunën në Istog, skuadra e Faruk Shalës e kishte fituar me rezultatin 32-31. Istogu e ka fituar edhe Kupën në konkurrencë të femrave. Në finale Istogu e mposhti Ferizajn me rezultat 34-29.



Donjeta Sadiku i siguron Kosovës medalje botërore në boks

18 MAJ - Donjeta Sadiku i ka siguruar Kosovës medalje botërore në Kampionatin Botëror të Boksit

në Stamboll të Turqisë. Sadiku është ndalur në gjysmëfinale nga amerikanja Rashida Ellis, kategoria -60 kg. Sadiku ka arritur sukses të jashtëzakonshëm në Botëror, pasi paraprakisht kishte siguruar medaljen e bronzit të botës, suksesi më i madh në histori të boksit kosovar. Ajo shënoi tri fitore, duke triumfuar ndaj Ayska Taguchi të Japonisë, Jocelyne Tshamala nga Kongo dhe Wu Shih-yi të Taipetit Kinez. Donjeta Sadiku ka vazhduar formën e mirë në garat ndërkombëtare. Ajo fitoi medaljen e argjendtë në turneun ndërkombëtar "Balkan" që u mbajt në Sofje të Bullgarisë. Sadiku është stolitur me medaljen e bronzit të Evropës. Ajo pësoi humbje në gjysmëfinale nga kampionia olimpikë "Tokio 2020" Kellie Harrington e Irlandës, kategoria -60 kg e Kampionatit Evropian. Sadiku kishte shënuar dy fitore për të arritur deri në gjysmëfinale. Është kjo medalja e parë evropiane për senior për Federatën e Boksit të Kosovës.



Milani pas 11 vjetësh rikthen titullin, festojnë edhe City, Bayerni, PSG-ja dhe Reali

22 MAJ - Pas 11 vjetësh Milani fiton titullin kampion në Serinë A, i 19-ti në historinë e tij, në një sezon shumë të luftuar dhe me konkurrencë të lartë nga rivali i përjetshëm, Interi. Milani mbylli sezonin 2021-2022 të Serisë A në kuotën e 86 pikëve, teksa Interi e mbylli këtë edicion në vendin e dytë me 84 pikë. Manchester City është shpallur kampion i Premierligës për këtë edicion, pasi ka triumfuar në xhiron e fundit kundër Aston Villës (3-2). City mblodhi 93 pikë në vendin e parë, një më shumë se Liverpooli që u pozicionua në vendin e dytë. Paris Saint-Germain barazoi 1-1 me Lensin në ndeshjen e javës së 34-t në Ligën 1, por ka fituar titullin e 10 në histori të klubit. Klubi nga "Parc des Princes" ka arritur të kthejë titullin në kryeqytet pas një viti, pasi ka fituar edhe matematikisht këtë sezon, katër javë pa u mbyll sezoni. Në Gjermani Bayern Munchen ka vazhduar dominimin dhe arriti ta fitojë titullin kampion në Bundesliga për herë të dhjetë radhazi, ndërsa Real Madridi katër javë nga fundi i kampionatit e siguroi titullin. Ky ishte titulli i 35-të në historinë e Real Madridit, duke qenë skuadra më e titulluar në Spanjë.

Reali, Eintracht Frankfurti dhe Roma dominojnë në Evropë

28 MAJ - Real Madridi i Carlo Ancelottit ka fituar për herë të 14-t trofeun më të rëndësishëm për



Real Madrid fitues i 'Ligës së Kampionëve'

klube në Evropë, Ligën e Kampionëve, derisa në finale e mposhti Liverpoolin me rezultat minimal 1-0. Golin e vetëm në këtë ndeshje që u zhvillua në "Stade de France" të Parisit e shënoi Vinicius Junior. Eintracht Frankfurti, pas plot 40 vjetëve, ka fituar trofe në Evropë, duke fituar Ligën e Evropës, ku mposhti Rangersin në finale. Pas 120 minutave lojë rezultati ishte i barabartë 1-1, derisa në 11 metra gjermanët u treguan më të saktë, duke fituar me rezultat 4-5, me mesfushorin e Rangersit, Aaron Ramsey, që e humbi penalltinë vendimtare. Ndërsa në finalen e Ligës së Konferencës, Roma ka arritur ta mposhtë Feyenoordin në finalen e zhvilluar në Tiranë me rezultat 1-0. Golin e vetëm për skuadrën e Jose Mourinhos e shënoi Nicolo Zaniolo.

Elhami Shabani, medalist i bronzitë i Evropës në karate

28 MAJ - Elhami Shabani ka arritur suksesin më të madh në karrierën e tij pas sakrificës shumëvjeçare në karate. Ai fitoi medaljen e bronzit të Evropës në Kampionatin Evropian të Karatesë "Gaziantep 2022", kategoria -75 kg. Shabani mundi Hamza Turulijan e Bosnjë-Hercegovinës 2:1 në luftën për të bronzitën. Elhamiu, po ashtu, shënoi katër fitore dhe një humbje. Drejt medaljes së bronzitë kishte rrugëtuar përmes repesazhit.

Basketboll: Ylli sërish kampion, Trepça fiton Kupën, Peja triumfon në Ligën Unike

2 QERSHOR - KB Ylli për të dytin vit radhazi është shpallur kampion i Kosovës në basketboll. Suharekasit triumfuan pas katër serive me rezultat 3-1 ndaj Trepçës. Mirëpo në Ligën Unike Ylli ka pësuar humbje nga skuadra e Pejës në finalen e zhvilluar në "Karagaçi" me rezultat 87-72, ndërsa skuadra e Trepçës, pas 10 vjetësh, e ka fituar Kupën e Kosovës. Klubi mitrovicas në finalen e zhvilluar në Pejë e mposhti Bashkimin me rezultat 74-62.

Boksieri Shpejtim Bajoku merr medaljen e bronzitë në Lojërat Mesdhetare

30 QERSHOR - Boksieri Shpejtim Bajoku dëshmoi se ka të ardhme të ndritur pavarësisht se fitorja në

fund i takoi algerianit Jahia Abdelli, që kishte përkrahjen e fuqishme të tifozëve vendas. Meçi i takonte gjysmëfinaleve të kategorisë -63 kilogramë në boks në Lojërat Mesdhetare "Oran 2022". Bajoku kishte siguruar medaljen e bronzitë, të parën për Federatën e Boksit të Kosovës në Lojërat Mesdhetare.

NBA, Golden State fiton



titullin e katërt në shtatë vitet e fundit

17 QERSHOR - Golden State shpallet kampion i NBA-së. Warriorsi fitoi 103-90 në fushën e Boston Celticsit në ndeshjen e gjashtë, duke triumfuar 4-2 në serinë e takimeve finale. Ky është titulli i katërt kampion për Warriorsin në shtatë vjetët e fundit. Basketbollisti Stephen Curry mori trofeun e lojtarit më të mirë të finaleve, duke qenë protagonist në fushë me 34 pikët e tij edhe në ndeshjen e fundit. Për të ky është titulli i katërt në karrierë. Ndryshe nga tre titujt e mëparshëm, këtë trofe skuadra e Golden States e ka fituar me shumë vështirësi.

Universiteti i Prishtinës shpallet kampion bote në hendboll

18 KORRIK - Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" ka fituar titullin e kampionit të botës në hendboll për sportin universitar në Kupën e Botës të organizuar për një javë në Prishtinë. Djemtë tanë mundën në finale Universitetin Kangwon të Koresë së Jugut, 33:30. Medalje, por të bronzitën, e fituan hendbollistët, të cilat, në luftën për vend të tretë, fituan ndaj Universitetit nga Çekia, "Palacky University of Olomouc", 26:24. Vendin e parë të femrat e zuri Universiteti Kombëtar i Koresë së Jugut.

Komiteti Paralimpik i Kosovës anëtarësohet në Komitetin Paralimpik Ndërkombëtar

18 KORRIK - Komiteti Paralimpik i Kosovës (KPK) është bërë anëtar i Komitetit Paralimpik Ndërkombëtar (IPC). Bordi Ekzekutiv i IPC që e ka

pranuar kërkesën e KPK-së për anëtarësim. Komiteti Olimpik i Kosovës përgëzoi Komitetin Paralimpik të Kosovës dhe të gjithë paralimpistët për lajmin historik të anëtarësimit në IPC.



Luiza Gega shpallet kampione e Evropës

21 GUSHT - Atletja shqiptare Luiza Gega është shpallur kampione e Evropës në garën e 3000 metrave me pengesa në eventin që u zhvillua në Muni të Gjermanisë. Ajo shënoi kohën 9'11"31, në një garë që dominoi që nga fillimi e deri në fund. Një rezultat i jashtëzakonshëm për Gegën dhe atletikën shqiptare, e cila ngjitet në majën e Evropës. Gega kurorëzoi kështu me një medalje të artë një sezon të jashtëzakonshëm, ku ka dominuar kudo që ka garuar. Kampione e Evropës, në një garë që ajo nuk e vuri asnjëherë në diskutim fitoren, duke qenë gjithnjë në krye dhe e shkëputur ndjeshëm nga të gjitha rivalët, që duelonin vetëm për podiumin.

Usyk mposhti Joshuan, mbron titullin kampion bote

21 GUSHT - Boksieri ukrainas Oleksandr Usyk ka arritur ta mposhtë anglezin Anthony Joshua pas 12 raundeve duke u rishpallur kampion bote në pesha të rënda. Tri rundet e para i takuan Joshuas, ndërsa Usyk u këndell në raundin e pestë, ku rezultati ishte pothuajse i barabartë. Ndërsa ishte raundi i 10-të ai që Joshua e humbi veten ku për pak sa nuk u nokautua nga Usyk. Kjo është hera e dytë që të dy boksierët përballen.

Kastriot Jupa transferohet në Gjermani

29 GUSHT - Hendbollisti i Përfaqësueses së Kosovës, Kastriot Jupa, është transferuar te skuadra LHC Cottbus. 29-vjeçari tashmë i është bashkuar skuadrës gjermane në fazën përgatitore, ndërsa ka shkëlqyer në ndeshjet kontrolluese. Për dhjetë vjet, Kastriot Jupa ka luajtur për skuadrën e Besa Fungas. Me Besën ka dominuar plotësisht në hendbollin kosovar. Plot gjashtë herë është shpallur lojtari më i mirë i vitit në Kosovë. Ai është shquar me paraqitje të mira edhe në kupa evropiane. Jupa është kapiteni i dytë i Kosovës.

Dardan Cena, medalist i bronzitë i Evropës për junior

16 SHTATOR - Xhudisti Dardan Cena ka shënuar suksesin më të madh në karrierën e tij. Ai fitoi medaljen e bronzitë në Kampionatin Evropian të Juniorëve që u mbajt në Pragë të

Republikës së Çekisë, kategoria -73 kg. Cena shënoi pesë fitore, të gjitha me ippon. Humbjen e vetme e pësoi në gjysmëfinale.

Trajneri Driton Kuka nderohet me çmimin 'Doctor Honoris Causa'

22 SHTATOR - Trajnerit të Përfaqësueses së Kosovës në Xhudo, Driton Kukës, i është dhënë çmimi "Doctor Honoris Causa" nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina". Çmimi iu dha nga rektori i UP-së, Naser Sahiti, në ceremoninë e organizuar në Bibliotekën Qendrore Universitare të Kosovës. "Honoris Causa" është titulli akademik që një universitet i akordon si mënyrë nderimi për kontributet një vizitori të shquar në një fushë të caktuar apo përgjithësisht në shoqëri. Ky çmim Kukës iu dha për kontributin e dhënë në fushën e sportit dhe në njohjen e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Në cilësinë e trajnerit, Kuka ka fituar tri medalje të arta olimpike, gjashtë medalje botërore, 18 evropiane, katër në Lojërat Evropiane dhe nëntë në Lojërat Mesdhetare, të gjitha në nivelin për seniorë.



Pensionohet nga tenisi Roger Federer

24 SHTATOR - Një nga tenistët më të mirë në histori, Roger Federer, i përlotur i tha lamtumirë tenisit profesionist, pasi u bashkua me shokun e tij të madh, Rafael Nadal, në një natë emocionale në Laver Cup. 41-vjeçari mori një ovacion të gjatë derisa po largohej nga fusha për herë të fundit pasi doli në pension si profesionist. Zvicëranë, i cili fitoi 20 tituj Grand Slam, konsiderohet një nga lojtarët më të mirë në historinë e tenisit.

Liga e Kombeve, Kosova dhe Shqipëria qëndrojnë aty ku ishin

27 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës mbeti në Ligën C pasi u radhit e dyta, Shqipëria në anën tjetër vetëm falë Rusisë mbetet edhe për një sezon në Ligën B, pasi ishte treta në grup me dy pikë të grumbulluara. "Dardanët" në



gjashtë takime të zhvilluara arritën tri fitore dhe tri humbje, dy nga të cilat ishin nga liderja, Greqia dhe një humbje e hidhur në minutat e fundit nga Irlanda Veriore. Në katër ndeshjet e zhvilluara, kuqezinjtë pësuan dy humbje dhe morën dy barazime, duke mbetur pas Islandës me katër pikë dhe vendit të parë, Izraelit, me tetë pikë.

Verstappeni fiton titullin e dytë radhazi në Formula 1

9 TETOR - Pas një 'Grand Prix'-i dramatik të Japonisë, Max Verstappeni është shpallur kampion në Formula 1. Verstappeni është bërë kampion bote i vitit 2022 për herë të dytë rresht. Shoku i skuadrës, Sergio Perez, ishte i dyti dhe Charles Leclerc i Ferrarit i treti, kjo e vendos Verstappeni në një epësi që nuk mund të arrihet më nga asnjë pilot. Kjo ishte fitorja e 12 e sezonit për Verstappeni.



Benzema fitoi 'Topin e Artë'

17 TETOR - Karim Benzema ka fituar "Topin e Artë" për edicionin 2021/2022. Benzema ka shkëlqyer në fanellën e Real Madridit. Ai e ka udhëhequr skuadrën spanjolle drejt titullit të kampionit në Ligën e Kampionëve dhe në La Liga. Sulmuesi francez realizoi 44 gola në 46 ndeshje në edicionin e kaluar. Në La Liga kishte 27 gola e 12 asistime në 32 paraqitje. Në 12 paraqitje në Ligën e Kampionëve kishte shënuar 15 gola dhe kishte realizuar dy asistime. Dy gola e një asistim i kishte në dy ndeshje për Superkupën e Spanjës.

Ballkani bën historinë në Kosovë dhe Evropë

3 NENTOR - Skuadra e Ballkanit është shpallur për herë të parë në histori të klubit kampion i Kosovës në futboll. Klubi nga Suhareka është themeluar para 75 vjetësh. Ballkani si kampion i Kosovës fitoi të drejtën për pjesëmarrje në garat e Ligës së Kampionëve, por është eliminuar në rrethin e parë kualifikues të kësaj gare. Në ndeshjen e parë të zhvilluar në Prishtinë, Ballkani



Xherdan Shaqiri dhe Granit Xhaka

luajti baras me Zhalgirisi (1-1), kurse në ndeshjen e kthimit Ballkani u paraqit mirë, por pësoi gol në vazhdimë dhe garat i vazhdoi në rrethin e dytë kualifikues të Ligës së Konferencës. Skuadra e drejtuar nga Ilir Daja bëri histori në këtë garë duke siguruar kualifikimin historik në fazën e grupeve. Në grupe, Ballkani regjistroi një fitore, një barazim dhe katër humbje. Kjo skuadër falë këtyre sukseseve është shpallur edhe skuadra më e mirë e vitit nga Federata e Futbollit e Kosovës. Duhet cekur se skuadra e Llapit për herë të dytë radhazi e ka fituar Kupën e Kosovës.

Norvegjia fiton titullin e nëntë të Evropës

20 NENTOR - Norvegjia ka vazhduar të dominojë në hendbollin evropian. Hendbollistët e Norvegjisë të dielën kanë siguruar titullin e nëntë të Evropës. Në finalen e Euro 2022, të zhvilluar në Lubjanë, Norvegjia ka fituar ndaj Danimarkës me rezultat 27:25. Norvegjia ka mbrojtur titullin dhe është konfirmuar forcë e hendbollit evropian.

Transferime bombastike, Ronaldo largohet nga Unitedi

22 NENTOR - Gjatë vitit 2022 nuk munguan transferimet bombastike, por duhet cekur se një nga lajmet më të mëdha është largimi i Cristiano Ronaldos nga Manchester Unitedi. Klubi anglez njoftoi shkëputjen e bashkëpunimit me Ronaldon dhe e falënderoi për kontributin që ka dhënë gjatë dy periudhave që ishte pjesë e Unitedit, në anën tjetër portugezi e fajësoi klubin që nuk i ka ofruar atë që e meritoi. Një nga transferimet më të mëdha ishte ai Erling Haaland te Manchester City. Klubi anglez pagoi 75 milionë euro

për sulmuesin norvegjez. Transferim i madh ishte edhe ai i Robert Lewandowsit nga Bayern Muncheni te Barcelona dhe Sadio Mane që e la Liverpoolin për Bayernin. Ndërkohë dhe Gabriel Jesus ndërroi skuadër, nga City kaloi të rivali e Premierligës, Arsenal. Ndërsa mesfushori Casemiro u largua nga Real Madridi dhe iu bashku Manchester Unitedit.

Xhaka e Shaqiri edhe një herë gjunjëzojnë Serbinë

2 DHJETOR - Kombëtarja e Zvicrës ka shkëlqyer në ndeshjen e tretë të grupeve, ku e mposhti Serbinë me rezultat 3-2. Në këtë mënyrë futbollistët nga Kosova që e përfaqësojnë Zvicrën, Granit Xhaka dhe Xherdan Shaqiri, edhe një herë kanë dalë triumfues ndaj kombëtares serbe. Në ndeshjen e Botërorit 2022 kontribut të jashtëzakonshëm ka dhënë dyshja shqiptare, Shaqiri dhe Xhaka, i pari ka shënuar gol, i dyti si kapiten i ka udhëhequr zvicëranët drejt fitores, por u bëri ballë edhe disa provokimeve të futbollistëve dhe zyrtarëve në shtabin teknik të Serbisë. Pjesë e Zvicrës ishte edhe shqiptari tjetër Ardon Jashari.

Gjymnastet, të suksesshme në Gjermani

9 DHJETOR - Sporti i gjymnastikës ka qenë mjaft aktiv në vitin 2022. Sukseset e këtij sporti vazhdojnë edhe më tej, pasi gjymnastet e Klubit "Elita" nga Prishtina, në garën "Gymfinity 2022" në Grunstadt të Gjermanisë në gjymnastikën artistike për femra, arritën suksese. Federata e Gjymnastikës e Kosovës u përfaqësua nga gjymnastet Bora Hoti, Vilëza e Lisa Zeqiri, Elena Sefa, Fitore Rudari, Una Kajtazi, Valëza Rama dhe Jora Gërvalla të cilat rrëmbyen tri vende të para



Elhami Shabani, medalist i bronzë të Evropës në karate



Gjymnastet, të suksesshme në Gjermani

dhe një të tretë. Puna e palodhur e trajnerëve Abeliana Bregu dhe Shkumbin Maqastena u kurorëzua me suksese.

Kosova mbetet pa Milaim Krasniqin, Xhevdet Pecin, Behlul Beqajn...

16 DHJETOR - Në moshën 53-vjeçare Milaim Krasniqi ka humbur betejën me sëmundjen e kancerit. Krasniqi ishte një ndër gazetarët më të shquar në Kosovë i cili kontribuoi në zhvillimin e gazetarisë dhe ngritjes së cilësisë në sport. Krasniqi në vitin 2001 u punësua në "Radio Kosova", ku ka vazhduar të punojë deri në ditët e fundit të jetës. Gjatë kësaj periudhe ka komentuar mbi 2 000 ndeshje të futbollit nga vendi i ngjarjes. Vite me radhë ishte redaktor përgjegjës i programit në RTK-Radio Kosovë dhe kryetar i

Shoqatës së Gazetarëve Sportivë të Kosovës.

Në muajin maj papritmas ka ndërruar jetë legjenda e boksit, Xhevdet Peci, i cili nga viti 1975 deri 1983 arriti t'i fitojë pesë tituj në konkurrencën ekipore dhe katër tituj në konkurrencën individuale në ish-Jugosllavi. Peci arriti të fitojë edhe dy kampionate ballkanike. Peci për pesë vjet me radhë ishte boksieri që nuk kishte humbur asnjë meç.

Futbollisti 17-vjeçar i Trepçës '89, Erion Kajtazi, ka ndërruar jetë në fushë të futbollit pas sulmit në zemër. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në Prizren pas një ndeshjeje futbollit për generatat e reja mes A&N dhe Trepçës '89. 17-vjeçari ka rënë pa ndjenja në fushë por, me gjithë ndërhyrjen e mjekëve, nuk ka mundur të jetë. Në këtë vit ndërroi jetë edhe ish-kryetari i FBK-së, Behlul Beqaj dhe disa sportistë të tjerë.

Messi me Argentinën rrëmbejnë Kupën e Botës

18 DHJETOR - Argjentina është shpallur kampione e Botës pasi e mposhti në penallti Francën (4-2). Në 90 minutat e zhvilluar rezultati ishte 2-2 dhe ndeshja shkoi në vazhdimë. Shënues për Argentinën ishin Leo Messi dhe Angel Di Maria, kurse për Francën dy golat i shënoi Mbappe. Në vazhdimë Messi dhe Mbappe shënuan edhe nga një herë për rezultatit 3-3, kurse në penallti më të mirë ishin argjentinasi që u kurorëzuan me titullin e tretë të botës në histori. Messi është shpallur lojtari më i mirë i kampionatit. Mbappe është shpallur golshënuesi më i mirë, kurse Martinez e rrëmbeu epitetin e portierit më të mirë.



Vedat Muriqi shpallet futbollist i vitit, Thaqi lojtari më i mirë në Superligë

24 DHJETOR - Sulmuesi i Kosovës dhe i skuadrës spanjolle, Mallorca, Vedat Muriqi është

shpallur futbollisti më i mirë i vitit 2022. Për Muriqin ky është çmimi i dytë i futbollistit të vitit nga FFK-ja, ngaqë herën e parë e kishte fituar në vitin 2019. Ndërkaq epiteti i futbollistit më të mirë 2022 në Superligë i takoi anëtarit të FC Ballkani, Armend Thaqi.



Milaim Krasniqi



Xhevdet Peci



Behlul Beqaj

Vdes legjenda e futbollit, Pele

29 DHJETOR - Ka ndërruar jetë në moshën 82-vjeçare legjenda braziliane e futbollit, Pele. Ai konsiderohej si njëri prej futbollistëve më të mirë në histori të futbollit, pasi kishte fituar tri herë Kupën e Botës me Brazilin. Për vdekjen e tij ka reaguuar e gjithë bota e futbollit, duke e vlerësuar Pelën si legjendë të sportit më të popullarizuar në glob. Pele ishte trajtuar për kancer të zorrës së trashë, pas operacionit për heqjen e një tumori në shtator 2021 dhe kishte kërkuar trajtim të rregullt mjekësor.





Festë në shtëpinë e Messit, argjentinasi publikon foto të Antonelës duke kërcyer

Lionel Messi i shijoi pushimet që i kishin munguar aq shumë, sidomos pas fitores në Kupën e Botës. Futbollisti argjentinasi ka mbajtur premtimin që do të kthehej në Rosario për ta shijuar diellin dhe vazhdimisht publikoi video e foto nga vila e tij. Por një nga postimet në prag të Krishtlindjeve është pak më i veçantë pasi 400

milionë ndjekësit e tij në "Instagram" nuk panë yllin argjentinasi, por bashkëshorten e tij, Antonelën. Messi publikoi pamjet ku kjo e fundit shfaqej duke pirë teksta kërcenuese në ambientet e vilës së futbollistit duke shijuar momentet intime në shtëpinë e tyre me këto ditë pushimi para se të kthehen përsëri në Evropë.



Lojtari i Kosovës i jep fund beqarisë

Florent Hadërgjonaj i ka dhënë fund beqarisë. Lojtari i përfaqësueses së Kosovës është martuar me Dorina Podrimjen. Modeluesja shqiptare i ka

thënë po propozimit të 27-vjeçarit për të lidhur kurorë së bashku. Lajmin e ka ndarë vetë Hadërgjonaj përmes një postimi në "Instagram".

Kujtojmë se Dorina Podrimja më parë ka qenë në një marrëdhënie me lojtarin e kombëtares shqiptare, Taulant Xhaka.



Ivana Knoll shkëlqen edhe pas Botërorit

Ivana Knoll ishte pa diskutim një prej muzave më seksi në Kupën e Botës në Katar. Modeluesja kroate tërhoqi vëmendjen në shkallët e

stadiumeve me bukurinë dhe linjat e saj të përkryera trupore. Me Botërorin të mbyllur prej disa ditësh, tashmë Ivana shkëlqen në

"Instagram", ku shfaqet në një formë fantastike në këto ditë festash, duke marrë si gjithnjë komplimente nga fansat e shumtë.

Georgina i dhuron Ronaldos makinë për Krishtlindje

Georgina Rodriguez nuk kursehet asnjëherë kur bëhet fjalë për ta surprizuar Cristiano Ronaldon. Sigurisht nuk është e lehtë të befasosh një personazh si CR7, një nga futbollistët më të pasur në botë, por bukuroshja ia ka dalë edhe këtë herë. Duke njohur pasionin e madh të Ronaldos për makinat, Georgina zgjodhi një "Roll Royce" si dhuratë për Krishtlindje. Bëhet fjalë për një makinë jo pak të shtrenjtë, por një model që kushton 345 mijë euro. Ronaldo nuk ka ngurruar të bëjë publike në "Instagram" këtë dhuratë të Georginas shoqëruar me fjalët: "Faleminderit dashuria ime!".



Seksbomba juventine nuk përmbahet në 'Instagram'

Eva Padlok, bukuroshja spanjolle e cila disa vjet më parë shkëlqente si një prej "ombrellinave" më seksi në Moto GP, tashmë dhuron shou në "Instagram". Modeluesja shfaqet më në formë se kurrë në prag të festave të fundvitit teksa ekspozon hiret e saj, duke marrë edhe komplimente të shumta nga fansat. Përveçse pjesë e modelimit në botën e motorëve, Eva Padlok lidhet edhe me futbollin. 38-vjeçarja katalanase njihet si një tifozë e Juventusit, skuadrës më të titulluar të Italisë.





Në bazë të dispozitave të Nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr. 03/L- -087 mbi Ndërmarrjet Publike, respektivisht dispozitat e Nenit 13 të Ligjit Nr: 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësim të Ligjit Nr : 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Statutit të kompanisë, Bordi i Drejtorëve të KRM UNITETI Sh.A. Mitrovicë në mbledhjen e mbajtur me datë 14.12.2022 mori vendim që të rishpall:

KONKURS PUBLIK

Pozita: Këshilltar/e i përgjithshëm/Sekretar/e i Ndërmarrjes
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve
Vendi: Mitrovicë

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale:

- Kandidati duhet të ketë diplomë në fushën e Fakultetit Juridik (Jurist i diplomuar ose Master shkencë Juridike);
- Të posedojë së paku 5 vite përvojë profesionale nga fusha e qeverisjes, korporatave ose të drejtës së shoqërive tregtare;
- Të plotësoj kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 si dhe të plotësoj kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2.pikat (d), (f),(j),(k),(l), të ligjit nr.03/L-087 të ndërmarrjeve publike dhe plotësim të ndryshimit të ligjit për ndërmarrje publike nr.04/L-111 neni 13;
- Të ketë njohuri të mira të punës me kompjuter (Microsoft, Word, Excel etj.);
- Njohja e gjuhës angleze (e preferueshme).

Detvat dhe përgjegjësit:

- Shërben si Sekretar/e i Bordit të Drejtorëve;
- Te siguroj përcjelljen e procedurave nga Bordi ku bëjnë pjesë organizimi i takimeve te Bordit , Komiteteve te Bordit Aksionarve dhe në bashkëpunim me Kryesuesin e Bordit bënë përgatitjen dhe shpërndarjen e rendit të ditës.
- Të mbaj procesverbalin e takimeve dhe ti shpërndaj ato tek Bordi i Drejtorëve.
- Të mbaj procesverbalin e e secilës mbledhje të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga Kryesuesi i tyre) dhe ti regjistroj ato në librin e protokollit.
- Vepron si agjent i ndërmarrjes për pranimin e njoftimeve, të bëj sigurimin e rrjedhës së mirë të informatave brenda Bordit, Komiteteve të tij dhe në mes të Bordit dhe Menaxhereve të lartë të ndërmarrjes.
- Përcjellë ndryshimet ligjore, që kanë të bëjnë me ndërmarrjen duke informuar Bordin dhe Menaxhmentin e ndërmarrjes për ndryshimet si dhe përgatitë udhëzime të nevojshme për Menaxhmentin në ndërmarrje.
- Kryen të gjitha arkivimet, publikimet dhe\ose zbulimet për autoritetet përkatëse, siç mund të kërkohet për ligjin për ndërmarrjet publike ose nga statuti i ndërmarrjes.
- Koordonon me KE-në në përgatitjen e letrave (dokumente) për mbledhjet e Bordit te Drejtorëve.
- Merret me çështje tjera të qeverisjes së ndërmarrjes sipas nevojës.
- Kohëzgjatja e punësimit të drejtat dhe obligimet përcaktohen me kontratë punësimi në kohë të caktuar për tri (3) vite me mundësi vazhdimi.

Procedura e Konkurrimit:

- Aplikacionit duhet bashkëngjitur edhe këto dokumente:
- CV-ja e Aplikantit
- Kopja e letërnjoftimit,
- Referenca si dhe certifikatat tjera profesionale
- Letër motivimi,
- Deklarata nën betim
- Diplomën e fakultetit - kopje,
- Dëshminë për përvojën e Punës (Trusti Pensional)
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë muaj) të lëshuar nga Gjykata kompetente;

Dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës bëhet tek Zyra e Arkivës. Konkursi zgjatë 30 ditë, Dorëzimi i dokumentave fillon nga data 31.12.2022 dhe përfundon në ora 16:00 të datës 29.01.2023. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuar me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Bordit të Drejtorëve. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim, ndërsa NP mban të drejtën e formimit të listës së shkurtër me aplikant.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr.03/L-087 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike Nr.04/L-111 si dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Kooperative, Bordi i Drejtorëve të KRM "Uniteti" SH.A, në mbledhjen e mbajtur me 14.12.2022 vendosi të rishpall këtë:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e pozitës

Pozita: Zyrtar/e Kryesor/e Financiar/e dhe të Thesarit
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve
Vendi: Mitrovicë

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

- Diplomë universitare me së paku 240 kredi ose nivel master nga fusha e shkencave ekonomike, menaxhim të biznesit ose fusha të ngjashme.
- Të jet i/e certifikuar në SCAAK,IKAF,ose shoqatat tjera profesionale
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në financa apo kontabilitet;
- Njohuri të shkëlqyera të financave Publike
- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhimin e financave
- Të ketë njohuri të mira të punës me kompjuter (Microsoft, Word, Excel etj)
- Preferohet njohja e gjuhës Angleze
- Shkathësi të larta organizative dhe aftësi për të punuar nën presion me kualitete të larta organizative.

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Do të menaxhoj nën drejtimin dhe përgjegjësinë e Kryeshefit Ekzekutiv, punët financiare të Kompanisë brenda kufizimeve të krijuara nga Bordi i Drejtorëve. Do të ketë autoritetin për të lidhë Kompaninë në kontrata në të gjitha transaksionet financiare dhe të jetë përgjegjës.
- Te mbajë llogaritë e Kompanisë të azhuruara dhe të sakta.
- Të krijojë dhe të udhëheqë të gjitha kontrollet e brendshme financiare, përfshirë blerjet, faturat e të hollave dhe mjeteve themelore fikse. Të monitoroj llogaritë e pagueshme dhe të koordinoj pagesat e faturave dhe blerjeve të posaçme. Të kontrolloj shpenzimet e punëtorëve për të siguruar përputhshmëri me politikën korporative dhe buxhetin e para pagesës.
- Të përgatisë shënimet e Kompanisë për auditimin e fundvitit.
- Të bëj shqyrtimin, organizoj prokurimin dhe mbajtjen e të gjitha polisave të sigurimit afarist.
- Të koordinoj funksionet tjera të biznesit, si qiratë e ndërtesave, paisjeve dhe blerjet me KSHE-ne dhe Zyrtarin e Prokurimit të Kompanisë.
- Të menaxhoj thesarin e Kompanisë
- Të caktoj dhe të përgatisë buxhetin.
- Për punën dhe detyrat e punës i përgjigjet KE-së së KRM"Uniteti"SH.A dhe Bordit të Drejtorëve.

Procedura e aplikimit:

- Aplikacionit duhet bashkëngjitur edhe këto dokumente;
- CV-ja (Biografia);
- Kopja e letërnjoftimit;
- Letër motivimi;
- Deklarata nën betim;
- Diplomën e fakultetit –kopje;
- Dëshmitë e përvojës paraprake të punës.
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë muaj) të lëshuar nga Gjykata kompetente;

Dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës bëhet tek Zyra e Arkivës. Konkursi zgjatë 30 ditë, dorëzimi i dokumentacionit fillon nga data 31.12.2022 dhe përfundon në ora 16:00 të datës 29.01.2023. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacion përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Bordit të Drejtorëve. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim, ndërsa NP mban të drejtën e formimit të listës së shkurtër me aplikant.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Holcman" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr: 810051590 Prishtinë.

- Ilir Veliu shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme "Gjin Gazulli" Prishtinë.

- Florim Daci shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit AAB drejtimi Menaxhment dhe Informatikë Ferizaj.

- Infermiera e përgjithshme, Rabe Nikçi nga komuna Pejës me numër personal 1003700182, shpalli të humbur Licencën e Punës me numër: KO-3462-05-20, me afat prej 03.01.2018 deri 03.01.2023.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçantë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A-Mitrovicë

Në bazë të dispozitave të nenit 21 të Ligjit nr. 03/L- 087 për Ndërmarrjet Publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 31/15 qershor 2008), respektivisht nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 13/30 maj 2012, Bordi i Drejtorëve të KRM "Uniteti" Sh.A - Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur me 14.12.2022, mori vendim që të rishpall:

KONKURS PUBLIK

Pozita: Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve
Vendi: Mitrovicë

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale:

- Të ketë përgatitje superiore (diplomë universitare) në fushat teknike, ekonomike, juridike apo të tjera të ndërlidhura me aktivitetet, në të cilat vepron ndërmarrja;
- Të ketë së paku 5 vjet përvojë në menaxhim të lartë (pozita të larta drejtuese)
- Të ketë shkathësi organizative, drejtuese dhe aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit;
- Shkathësi të dëshmuara në punë me grupe dhe organizim të ndërmarrjes apo të ngjashme;
- Shkathësi të mira në punën me kompjuter;
- Njohuri në gjuhën angleze e preferuar.

Detvat dhe përgjegjësitë:

Zëvendës Kryeshefi Ekzekutiv, krahas punëve të parapara me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ka edhe këto detyra dhe përgjegjësi, të ndihmoj Kryeshefin Ekzekutiv:

- në planifikimin, organizimin dhe kontrollin e afarizmit të ndërmarrjes;
- Në bashkëpunim me përgjegjësit e Njësi Punuese, koordinon punët e ndërmarrjes me qëllim të implementimit sa më të drejtë të politikave zhvillimore të caktuara nga Bordi i Drejtorëve të KRM "Uniteti" Sh.A
- Përcakton një strategji efektive për KRM "Uniteti" Sh.A
- Bashkëpunon ngushtë me Bordin e Drejtorëve si dhe menaxhon kompaninë dhe para këtij organi raporton për menaxhimin e ndërmarrjes;
- Bën sistemimin dhe organizimin e të punësuarve konform dispozitave pozitive dhe të politikave zhvillimore të ndërmarrjes
- Mbikëqyrë përgatitjen dhe implementimin e Planit të Biznesit me qëllim të përmirësimit të performancës së ndërmarrjes;
- Udhëheqë dhe koordinon punët me udhëheqësit e departamenteve dhe stafit tjetër të ndërmarrjes;
- Të vendosë sisteme dhe procedura për menaxhimin efektiv të KRM "Uniteti" Sh.A
- Përfaqëson ndërmarrjen në raport me palët e treta;
- Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj, akte qeverisëse të ndërmarrjes dhe bënë ekzekutimin e vendimeve dhe rekomandimeve të Bordit të KRM "Uniteti" Sh.A

Procedura e Konkurrimit:

- Aplikacionit duhet bashkëngjitur edhe këto dokumente:
- CV-në e detajuar duke përfshirë datat e sakta të punësimit dhe detaje të përgjegjësi për çdo pozicion duke përfshirë nivelin e vendimmarrjes strategjike, numrin e punonjësve të mbikëqyrur, buxhetin dhe përgjegjësitë;
- Letër motivimin;
- Dëshminë mbi kualifikimin profesional;
- Dëshminë mbi përvojën e punës;
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë muaj) të lëshuar nga Gjykata kompetente;
- Kopjen e letërnjoftimit;

Dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës bëhet tek Zyra e Arkivës. Konkursi zgjatë 30 ditë, Dorëzimi i dokumenteve fillon nga data 31.12.2022 dhe përfundon në ora 16:00 të datës 29.01.2023. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuar me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Bordit të Drejtorëve. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim, ndërsa NP mban të drejtën e formimit të listës së shkurtër me aplikant.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se “STANTERG MINERALS INV-AG” Sh.P.K, ka marrë vendim të shuajë biznesin me NUI: 810139586 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavje se svi klienti da drustvo sa “STANTERG MINERALS INV-AG” d.o.o., donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NUI: 810139586 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that “STANTERG MINERALS INV-AG”. L.L.C, has taken the decision to quit its business with NUI: 810139586, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

Kompania e Sigurimeve “SIGKOS, sh.a. shpall këtë :

KONKURS**Vendi i punës:** Kryeshef Ekzekutiv

Kandidati për këtë vend pune duhet të jetë person me integritet, i cili i plotëson kushtet e kualifikimit, kriteret e pavarësisë, duhet të ketë përvojë të nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar, dhe kushtet tjera të kërkuara me dispozitat e Kompanisë.

Detvrat dhe përgjegjësitë krvesore:

- Organizon dhe udhëheq me afarizmin e kompanisë,
- Përfaqëson dhe prezanton kompaninë,
- Kujdeset për zbatimin e ligjshmërisë në punë e kompanisë dhe përgjigjet për punën e saj në baze të ligjeve të cilat këtë e përcaktojnë,
- Kontrollon operacionet e përditshme të afarizmit të Kompanisë-ofron mbikëqyrjen ekzekutive,
- Përgatitë propozimet e vendime për mbledhjet e bordit të drejtoreshave dhe zbaton vendimet e aprovuara,
- Informon Bordin drejtoreshave si organi më i lartë i kompanisë dhe lidhur me planet dhe politikën e rekomanduara ,
- Vlerëson adekuatitetin e politikave,
- Rekomandon politika para Bordit të drejtoreshave lidhur me zhvillimin e kompanisë dhe lidhur me rreziqet nga marrja në sigurim,
- Rekomandon ndryshime kur vlerëson të arsyeshme duke i arsyetuar ato para Bordit,
- Kujdeset të mirëmbajtjes së ambientit operativ të shëndoshëm dhe të sigurt
- Në mënyrë të efektshme kujdeset menaxhoj të gjitha fushat e rrezikut,
- Deleton dhe mban nëpunësit në mënyrë të përgjithshme për rezultatet operative,

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diplomë universitare në fushën e administrimit të biznesit, juridik, ekonomik, ose në një fushë tjetër që lidhet me veprimtarinë e kompanisë;
- Dhjetë (7) vite përvojë pune në fushën e sigurimeve, përfshirë së paku 5 vite në pozitë drejtuese;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e sigurimeve;
- Shkathtësi të lartë në menaxhim, organizim, caktim të objektivave dhe planifikim;
- Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;
- Shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negociim;
- Fleksibilitet ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës, përfshirë zgjidhjen e problemeve;

Informatë për procedurën e konkurrimit

Kandidatët për Kryeshef Ekzekutiv, duhet t'i dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- Biografinë (CV-në)
- Letër motivim
- Deklaratën nën betim (i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit lidhur me saktësinë e informatave të ofruara)
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës)
- Certifikatën (dëshminë) që dëshmon se nuk është nën hetim
- Kopjen e pasaportës ose të letërnjoftimit.

Aplikacionet së bashku me dokumentacionin e kompletuar dhe deklaratën nën betim dorëzohen në adresën: Kompania e Sigurimeve “SIGKOS”, Prishtinë, Rruga “Magjistrale Prishtine-Shkup”, Kompleksi Riera, Hyrja Z10 , Prishtinë, 10 000.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe email adresën.

Çdo përgënjeshttrim qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur, do të rezultojë me diskualifikimin e menjëhershëm të kandidatit.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

Kompania e Sigurimeve “SIGKOS”, ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe inkurajon të gjitha femrat e meshkujt e të gjitha komuniteteve që i plotësojnë kriteret e konkursit që të aplikojnë.

Konkursi mbetet i hapur nga data 30/12/2022 deri me 09.01.2023.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zolol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales



MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten free



cilësi e garantuar

pa konservues